

Lidhja me Atin

Xhosh Mekdauell



Përkthyes: Valbona Avdullaj
Redaktuan: Aurora Manaj

Titulli i origjinalit: *The Father Connection* nga Josh McDowell

Përkthyer me lejen e botuesit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në ndonjë formë ose në ndonjë mënyrë, elektronike ose mekanike, duke përfshirë fotokopje, regjistrim, ose ndonjë sistem grumbullimi të informacionit pa lejen e shkruar të botuesit.

© 2006 by Josh McDowell.

Originally published in English under the title

The Father Connection by Josh McDowell, Broadman & Holman, Nashville, Tennessee, USA

© 2008 by OM EAST for the Albanian edition.

Translated by permission. All rights reserved.

Falënderim:

Dua të përshëndes një grup të çmuar njerëzish që ndihmuan në bërjen e këtij libri;

Norman Uejkfildi, i cili ka pasur influencë të thellë tek unë si ati im. Aftësitë e tij të mprehta (në një libër të shkruar bashkë, me titull *Ndryshimet atërore*, e mprehën më shumë mendimin tim mbi rolin e Atit qiellor mbi jetën time si baba. Përkushtimi i thellë i Normanit për të jetuar sipas imazhit të Perëndisë është reflektuar në shumë shembuj të jetës së tij, pjesë të së cilës unë i kam përdorur në këtë libër;

Lerri Kifauveri për ndihmën që dha për formimin e bocetit të parë të këtij dorëshkrimi;

Bob Hostetlëri për ndihmën për modelimin e bocetit të parë në formën përfundimtare të tij;

Xhenis Uipli për mbështetjen dhe ekspertizën në drejtimin e projektit gjatë procesit të redaktimit;

Dejv Bellis, partneri im nëntëmbëdhjetë vjeçar, për idenë e skicës, struk turimin krijues të librit dhe lehtësimin e gjithë projektit të mbushur me detaje plotësuese.

Dhe në fund, gruan time, Doti, dhe fëmijët e mi, Shauni, Kelli, Kejtë dhe Hedhër, për durimin, dashurinë dhe përkrahjen që më kanë dhënë në këtë «formim» praktik për t'u bërë baba i mirë.

Khosh Mekdauell

TË JESH BABA NË KOHË TË VËSHITRA

Para më shumë se njëzet vjetësh mbaja në krahë fëmijën tim të parë.

Si sot kujtoj emocionet dhe mendimet që më pushtuan atëherë. Pashë fytyrën e vajzës sime të sapolindur, Kellit. Ajo ishte mbështjellë me një batanije të butë në ngjyrë të verdhë, i numërova gishtërinjtë, duke u mahnitur nga plotësia deri në detaj e trupit të saj vocërrak. Ishte e pambrojtur, e paçmueshme dhe ishte bija ime.

Ndërsa ia ngulja sytë plot dashuri dhe habi, ndjeva një tjetër emocion të më ngrihej në kraharor, emocion që e njoha menjëherë. Ishte tmerr.

«Çfarë po bëj kështu?» – pyeta veten. – «Po unë s'di si të jem baba!»

Si fëmijë, s'e kisha njohur dashurinë atërore. S'e kisha ditur kurrë ç'do të thoshte shembull i mirë atëror. As që mund të kujtoj një rast të vetëm kur im atë të më ketë marrë me vete dhe të kemi kaluar kohë bashkë. S'mbaj mend të kem qenë ndonjëherë krenar për tim atë, apo të kem bërë si ai. Në fakt, e urreja. U rrita në një fermë prej 0 hektarësh në një qytet të vogël jashtë Miçiganit. Të gjithë njiheshin me njëri-tjetrin në atë vend dhe sigurisht, gjithkush e njihnte tim atë dhe problemin e tij me pijen. Bashkëmoshatarët e mi bënin gallatë me të, edhe unë qeshja, duke shpresuar që me të qeshurën do të fshihja dhimbjen time.

E urreja që më turpëroi gjatë jetës, por dhe për mënyrën si e trajtonte time më. Kishte raste kur shkoja në hangar dhe e gjeja nënën të shtrirë mbi pleh pas lopëve, të rrahur aq rëndë sa s'ngrihej dot, raste të tjera kur ai vinte tapë, e tërhiqja zvarrë deri te hangari, e lidhja në grazhd dhe e lija aty të «dergjë». Si adoleshent që isha, e lidhja për këmbësh me një litar që përfundonte përreth qafës së tij, duke shpresuar që do të mbytej ndërsa përpiquej të lirohej nga laku. Kur nëna më vdiq muajin e diplomimit në shkollën e mesme, fajtor bëra atë, tim atë. Edhe pse Perëndia solli bujarisht pajtim midis meje dhe babait tim pasi u bëra i krishterë, madje edhe pse ai lejoi ta drejtoja te Krishti për shpëtimin (katërmëdhjetë muaj para se të vdiste nga një sulm në zemër), pavarësisht këtyre gjërave, unë u bëra baba me një ndjesi therëse se sa i pazoti isha për të qenë i tillë.

Puna më e frikshme në botë

Mund të kesh pasur si fëmijë një marrëdhënie të varfër me babanë tënd dhe këtu mund të bashkohemi për të ndarë idenë që të qenit prind është puna më e frikshme në botë. Më keq akoma, as nuk mund të pajisesh me ndonjë licensë atësie. Dhe duhen vetëm pak kërkesa. Dhe të gjithë ne pa përjashtim, duhet ta mësojmë këtë punë, me inat dhe tmerr, por më shumë me tmerr! Në fakt, dikush ka vënë re që shumica e njerëzve nuk bëhen prindër të mirë derisa fëmijët e tyre bëhen vetë prindër!

Për vite të tëra kam vëzhguar dhe këshilluar pa hesap bashkëvuajtës, prindër në kuptimin e mirë të fjalës që ndiheshin të rraskapitur nga puna për të qenë baballarë të suksesshëm. Shumica pranonin që turfullonin nga vepra mashtruese e martesës, e karrierës dhe të qenit prind. Shumica ndihej e zënë në kurth nga programet tepër të ngjeshura të punës dhe presionet që vinin bashkë me to... shumë prej tyre ndiheshin të kufizuar dhe të pazotë si prindër, nga një martesë e vështirë, ose nga modele jo të shëndetshme që kishin në jetët e tyre.

Veç kësaj, sfidat atërore janë bërë të qarta më shumë në ditët e sotme se kurrë ndonjëherë.

Ne dhe fëmijët tanë jetojmë në një botë që shpesh kërcënon martesat tona, familjet dhe fëmijët tanë. Jetojmë në një kulturë që hedh poshtë të vërtetën e Biblës, që tallet me moralitetin e saj. I thur lavde seksit dhe dhunës dhe qesh me veset e dehjes dhe vrazhdësisë.

Jetojmë në një shoqëri që ka refuzuar nocionet e së vërtetës dhe moralitetit, një shoqëri që deri diku ka humbur aftësinë për të vendosur ç'është e drejtë dhe e vërtetë, një shoqëri ku e vërteta është kthyer në një fakt për t'u provuar dhe moraliteti është zëvendësuar nga preferenca personale.

Ne si prindër përballemi çdo ditë me detyrën e vështirë të të rriturit të fëmijëve në mes të një kulture në krizë. Kërkimet tregojnë mbi një histori të tmerrshme statistikash për atë që ndodh çdo ditë në Amerikë:

- 1000 vajza adoleshente të pamartuara bëhen nëna
- 4219 adoleshentë marrin sëmundje seksualisht të transmetueshme
- 500 adoleshentë marrin drogë
- 1000 adoleshentë nisin të pijnë alkool
- 135000 fëmijë marrin me vete armë në shkollë
- 3610 adoleshentë shkelin ligjin; 80 janë të dhunuar
- 2200 adoleshentë braktisin shkollën e mesme
- 7 fëmijë (mosha 10-19 vjeç) vetëvriten
- 7 të rinj (17-vjeçarë e poshtë) arrestohen për vrasje
- 6 adoleshentë vendosin të vetëvriten

Është pak e habitshme pse shumë njerëz e përballin detyrën e prindit me frikë dhe drithërimë. Por të qenit prind, me gjithë respektin, nuk është vetëm puna më e frikshme në botë, por edhe një ndër punët më të do-mosdoshme dhe të kërkuara në botë.

Puna më e rëndësishme në botë

Detyra atërore është e një rëndësie kritike dhe s'ka qenë ndonjëherë më parë e tillë si sot. Një marrëdhënie baba-fëmijë është faktor vendimtar në shëndetin, zhvillimin dhe lumturinë e një të riu a të reje. Konsiderojini përfundimet vijuese të dokumentuara më së miri:

■ Dr. Loren Moshen, nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Mendor analizon shifrat e regjistrimit të përgjithshëm dhe gjen mungesën e babait si një faktor më të fuqishëm se varfëria për shkeljet e të rinjve.

■ Një grup ekspertësh bihevoristë të Yale studiuin shkeljen në dyzet e tetë kultura në mbarë botën dhe zbuluan që shkalla e krimit ishte më e lartë midis të rriturve, që si fëmijë ishin rritur vetëm nga nënat.

■ Dr. Martin Dojç ka zbuluar se prania dhe biseda me babanë, sidomos gjatë kohës së darkës, e nxit fëmijën të plotësojë më mirë detyrat shkollore.

■ Një studim i 3 doktorëve që janë diplomuar nga Universiteti i Xhons Hopkinsit midis viteve dhe ka zbuluar se mungesa e përkrahjes nga ana e prindërve ishte një nga faktorët e zakonshëm të hipertensionit, të sëmundjeve të zemrës, tumoreve malinjë, sëmundjeve mendore dhe vetëvrasjes.

■ Një studim me tridhjetë e nëntë adoleshente që kishin vuajtur nga çrregullimet e të ngrënies deri në anoreksi tregoi se tridhjetë e gjashtë prej tyre kishin një emërues të përbashkët: mungesën e një marrëdhënieje të ngushtë me baballarët e tyre.

■ Kërkimet nga Universiteti i Xhons Hopkinsit zbuluan se «vajzat ado-leshente të rritura në familje pa baba ishin 0 përqind më të prirura të kryenin marrëdhënie seksuale jashtë martese se vajzat që jetonin me të dy prindërit.»

■ Kërkimi i dr. Armand Nikolit tregon se një mungesë emocionale, ose dhe fizike e babait kontribuon në 1) motiv më të ulët për të pasur sukses; 2) pazotësi për të shtyrë plotësimin e menjëhershëm të dëshirave për hir të shpërblimit të mëpasshëm; 3) vetëvlerësim të ulët dhe) prirje për t'u dhënë pas ndikimit të grupit dhe prirje për kriminalitet të të miturve. Duke u bazuar në bashkëveprimin që kam pasur me qindra nëna, baba llarë dhe fëmijë, i mbështes këto përfundime. Jo vetëm kaq, por rezultatet e këtyre studimeve u përgjigjen shumë kërkimeve të fundit të bëra midis të rinjve në kishat ungjillore të krishtera. Pak kohë më parë kreu një anketë me mbi 0 adoleshentë në kishat ungjillore – anketa më gjithëpërfshirëse e bërë ndonjëherë më parë midis të rinjve të krishterë. Kërkimi, i grumbulluar nga Grupi i Kërkimit, Barna, nënvizoi rëndësinë e lidhjes së babait me fëmijën.

Nga 3 të rinj të anketuar në këtë studim, tetëdhjetë e dy përqind e tyre ndiqnin rregullisht çdo javë një kishë ungjillore dhe tetëdhjetë e gjashtë prej tyre pohuan se kishin marrë vendimin të pranonin Krishtin si shpëtimtarin dhe Zotin e tyre. Ndërkaq, studimi tregoi se pesëdhjetë e katër përqind e adoleshentëve dhe paraadoleshentëve në familje që janë anëtarë të kishës ungjillore treguan që ata rrallë, ose aspak flisnin

me babanë mbi problemet e tyre personale (krahastuar me njëzet e gjashtë përqind e tyre që thanë se rrallë, apo aspak nuk flisnin me nënën e tyre mbi problemet). Një ndër katër të rinjtë e anketuar konstatuan se kurrë nuk kishin patur një bisedë me babanë e tyre. Më shumë se dy në pesë të rinj (dyzet e dy përqind) pohuan që rrallë ose aspak bënin ndonjë gjë të veçantë me babanë e tyre, diçka që t'i përfshinte «të dy». Dhe një ndër pesë thanë se babai rrallë, ose aspak u tregonte dashuri. Nga ana tjetër, studimi tregon se të rinjtë që janë shumë të afërt me prindërit, kanë prirje të jenë:

- më shumë «të kënaqur» me jetën e tyre
- më të përmbytur ndaj marrëdhënies seksuale jashtë martese
- më shumë përkrahës të të vërtetave dhe moralitetit biblik
- më shumë pjesëmarrës në aktivitetet e kishës
- më shumë të qëndrueshëm për ta lexuar Biblën
- më shumë të disiplinuar për t'u lutur çdo ditë

Kërkimi – jo vetëm midis të rinjve të krishterë, por dhe të rinjve të tjerë– tregon fuqishëm se lidhja me babanë është një faktor kritik në shën-detin, zhvillimin dhe lumturinë e fëmijës. Kjo nuk e lë në hije rolin dhe ndikimin e nënës; mirëpo duhet nënvizuar fakti se në shumicën e rasteve, nëna ka qenë aty, duke bërë punën e vet, duke u kujdesur për fëmijët, duke folur me ta dhe duke kaluar kohë me ta. Si pasojë, duket se fëmijët presin që nëna të jetë e tillë; e dashur, e komunikueshme, pranuese dhe e arritshme. Por me atin, ligji i plotësimit dhe i nevojës futet në lojë, në shumicën e rasteve ai është më pak i arritshëm, më pak i përfshirë, ose më pak komunikues. Vetëm pak vëmendje dhe kohë të vijë prej tij, ndërton një atmosferë shumë domethënëse përreth marrëdhënies. Ashtu si të gjithë ne, fëmijët tanë kërkojnë atë që s'e kanë dhe në shumicën e rasteve nuk kanë një marrëdhënie të ngushtë me baballarët e tyre. Ja pse lidhja me Atin është faktori më i rëndësishëm në jetën e fëmijëve tuaj, pavarësisht moshës së tyre. Baballarë, marrëdhënia juaj me bijtë dhe bijat tuaja është tashmë një faktor kritik i verifikuar për rritjen e tyre plot urtësi, me shëndet dhe favor me Zotin dhe njeriun. Ju mund të sillni gjithë ndryshimin në vetëvlerësimin e fëmijëve tuaj, në marrëdhënie me të tjerët dhe ndjesinë e qëllimit që marrin.

Puna më shpërblyese në botë

Edhe pse e fillova përvojën time atërore me më pak se një shembull të përsosur nga im atë, kam qenë i nderuar të njihja dhe mësoja nga një sërë modelesh mentorësh nëpër vite. Në krye të tyre qëndron gruaja ime, Doti, gruaja më fantastike që një burrë mund të ketë pasur, si dhe nënë e dashur dhe e mençur e katër fëmijëve. Kam mësuar gjithashtu shumë prej Dik Deit, i cili është (krahastuar me djalit tim, Shaun) miku më i ngushtë që kam pasur ndonjëherë, dhe prej Norman Uejkfildi, një mik me të cilin kam

bashkëpunuar për shumë libra, i cili ka qenë gjithashtu një shembull i një babai të suksesshëm para syve të mi.

Normani dhe gruaja e tij, Uini, janë prindërit e pesë fëmijëve, të gjithë të rritur tashmë. Një prej momenteve më shpërblyese të jetës së Normanit ndodhi kur biri i tij, Joeli, ishte njëzet e katër vjeç:

«Dasma e Joelit ishte ngjarje e veçantë për mua – thotë Normani, – sepse më kërkoi të isha shoqëruesi i tij i parë. Ndërsa rrija në krah të këtij djaloshi, mendja më hodhi për një çast pas në kohë, para shumë viteve. Kujtoj kur Joeli ishte një parashkollor njomështak, ndërkohë që vetë po punoja në një program doktorature në Luzvil, në Kentaki. Një ditë mbërrita në shtëpi dhe pashë që djali im ishte vlarë rëndë në kokë nga një aksident. U turra me Joelin në spital me urgjencë. Ndërsa grupi mjekësor po vlerësonte gjendjen e tij, mbeta vetëm në dhomë me frikën dhe ndjesinë që s'mund të bëja kurrgjë dhe fillova të dënesja, ndërsa ndjeva thellë sa i çmuar ishte im bir për mua.»

S'kaloi shumë dhe Normani mësoi që dëmtimi i Joelit nuk do të linte pasoja serioze; ai së shpejti do të shërohej plotësisht. «Por atë ditë zbulova – thotë Normani, – sa shumë kuptim kishte im bir për mua».

Gjatë njëzet viteve të mëpasme Normani u përpoq të ishte baba i dashur, i shoqërueshëm dhe i suksesshëm për Joelin dhe katër fëmijët e tjerë të tij, një përpjekje që dukej sikur në njëfarë mënyre arriti kulmin në dasmën e Joelit.

«Ndërsa rrija në krah të djaloshtit njëzet e katër vjeçar, të cilin e doja dhe e respektoja, – thotë ai, – ndjeva të derdhesha nga gëzimi. E dija që ai, ashtu si dhe motrat e tij, kishin vendosur të nderonin dhe t'i shërbenin Krishtit (dhe) e dija që kishte vendosur të ishte një burrë i dashur për Lizën, nusen e tij.»

«I jam me të vërtetë mirënjohës Zotit për besnikërinë e tij. Ai e nderoi vendimin tim dhe të Uinit për të dashur, gëzuar dhe rritur fëmijët tanë. Dhe në këtë proces, ata u bënë miqtë tanë më të ngushtë».

Çfarë shpërblimi i dha Joeli babait të vet! Midis gjithë miqve të tij Joeli mund të kishte zgjedhur si shoqërues të parë – shokë klase, shokë skuadre, shokë fëmijërie, – por ai zgjodhi babanë! Të qenit baba mund të jetë puna më e frikshme në botë, por është edhe puna më e rëndësishme dhe shpërblyese që një njeri mund të marrë! Pavarësisht nga kufizimet dhe të metat tuaja, mund të bëheni një baba i suksesshëm! Mund t'i kaloni të gjitha pengesat! Mund t'i përballni me kurajë të gjitha pengesat që janë rreshtuar kundër jush. Mund të bëheni babai për të cilin fëmijët tuaj kanë nevojë. Dua t'ju sfidoj, inkurajoj dhe motivoj që të hidhni hapin duke u nxitur nga idetë e këtij libri. S'pretendoj të jem ekspert në të qenit baba. Kam pasur një fillim jo të mbarë në këtë fushë. Kam pasur shpesh vështirësi, ndoshta të njëjta me tuajat. Kam dështuar kushedi sa herë, por kam mësuar shumë nga të tjerët se si të jem një baba i mirë dhe shpresoj që këto t'ju ndihmojnë edhe ju, sepse kanë qenë vërtet pasurim për mua në marrëdhënien me fëmijët e mi.

Sigurisht e marr me mend, që s'mund të ndiheni dhe aq rehat ndërsa lexoni, duke e kuptuar që s'keni qenë aq i mirë sa do të donit të ishit. Por kjo është e natyrshme; diku do të përmirësohemi, veçse nuk do të doja të binit në kurthin e fajësisë. Çdo ditë përfjetoj presionet që një baba përball. Kanë qenë disa hapa të thjeshtë që më kanë ndihmuar t'i shmangem kurthit të fajësisë, hapa që mund t'ju ndihmojnë edhe ju:

Së pari, afrojeni atësinë duke e parë pozitivisht, me optimizëm. Shikojeni atësinë si një ndikim pozitiv dhe të dashur që, jo thjesht do të përmirësojë jetën e fëmijëve tuaj, por do të jetë një mjet që Zoti do ta përdorë për t'ju «forcuar» mendërisht, emocionalisht dhe shpirtërisht. Konsiderojeni si një mundësi të rëndësishme që ta investoni jetën tuaj në jetën e një tjetri, duke besuar se kjo kohë do të prodhojë fryte që zgjasin me vite – ndoshta me breza.

Së dyti, shikoni rritjen ndërsa një sërë hapash të vegjël merren gjatë një jete të tërë. Mos e lejoni veten të rraskapiteni nga çfarë s'keni bërë; përkundrazi, fokusohuni në disa hapa të vegjël të rinj që do të donit të merrnit sot (në fund të çdo kapitulli ju sugjeroj ca pyetje dhe pika zbatimi që do t'ju ndihmojnë t'u jepni prioritet ideve tuaja dhe të ecni para). Këto ndryshime të vogla do të bëjnë një ndryshim domethënës në marrëdhënie me fëmijët tuaj. Mbani mend se s'ka rëndësi sa shumë përpiqeni, shumë prej nesh nuk do të ndihen plotësisht të kënaqur me të qenit prind. Ndaj bëni një hap të matur që ta ridrejtoni këtë ndjesinë e pakënaqësisë drejt hapave të rritjes dhe jo ndjesisë së dekurajimit dhe depresionit.

Së treti, përcakto që t'i përkushtohesh nderit dhe përgjegjësisë së të qenit baba. Psalmisti na ka dhënë një perspektivë të shëndetshme mbi këtë sfidë:

Bijtë janë trashëgim nga Zoti; fëmijët janë shpërblim prej tij.

Psalmi 1:3

Vërtet që ka çaste kur disa prej nesh mund të çuditen nëse fëmijët janë shpërblim prej Zotit! Por kur mendon, që Perëndia i plotfuqishëm na ka besuar detyrën e përgatitjes së jetëve të këtyre fëmijëve për një rritje të përgjegjshme dhe të vlefshme, atëherë misioni merr kuptim hyjnor. Atësia është në të vërtetë një nder nga Perëndia! – një mundësi e pakrahasueshme për të investuar jetët tona në ata që duam më shumë në këtë botë.

Ndërsa vazhdojmë këtë rrugë së bashku, ju ftoj të merrni vendimin me mua që, s'ka rëndësi sa e vështirë mund të bëhet, s'ka rëndësi sa të papërgjegjshëm mund të bëhen fëmijet tanë, s'ka rëndësi nga do të anojë rruga jonë në të ardhmen – ne ua përkushtojmë veten nderit dhe përgjegjësisë së të qenit baba i dashur i vetëdijshëm, i përfshirë dhe i komunikueshëm. Në faqet vijuese do të zbuloni dhjetë cilësi që do t'ju ndihmojnë të bëheni ai baba që doni të jeni, ai baba për të cilin fëmijët tuaj kanë nevojë, ai baba që Zoti ju thërret të jeni. Do të zbuloni një burim të tërë energjie në të qenit baba, të tillë që e vë rolin dhe përgjegjësitë tuaja në një mënyrë të re të freskët.

Dhe ndërsa filloni të përjetoni lidhjen e Atit, do të filloni të vilni të mirat e punës më shpërblyese në botë.

Një shënim i veçantë për nënat

Besoj që shumë nëna do ta lexojnë këtë libër fantastik! E di që do të fitoni mprehtësi të vlefshme mbi atësinë e suksesshme, por nuk duhet mjaftuar me kaq. Ju nxis të merrni këtë iniciativë; stimulojeni burrin tuaj ta lexojë këtë libër dhe bëhuni inkurajim për të.

Dua të dini që s'është dëshira, apo qëllimi im që të ul rolin tuaj në jetën e fëmijëve, duke iu drejtuar me këtë libër vetëm baballarëve. Besoj plotësisht se të qenët prind është si të jesh një skuadër: nëna dhe babai duke punuar së bashku për të ngritur familjen e tyre. Për fat të keq, kam parë më shumë baballarë të dështojnë në rolin e tyre si prindër. Shumë meshkuj nuk marrin pjesë aktive në jetën e fëmijëve të tyre, duke ia lënë pjesën më të madhe nënës.

Ndaj e shkrova këtë libër për të ndihmuar baballarët të kuptojnë rolin e dhënë nga Zoti dhe për t'u kthyer në pjesëtarë aktivë të skuadrës pranë bashkëshorteve për të dashur, mësuar, drejtuar dhe rritur fëmijët së bashku.

Nëse jeni nënë pa bashkëshort, mund të jeni edhe e shqetësuar se si mund të ndikojë mungesa e babait te fëmijët tuaj (fizikisht, emocionalisht, apo të dyja bashkë) Nëse është e mundur, lexojeni këtë libër me babanë e fëmijëve tuaj. Duke u fokusuar në mirëqenien e fëmijëve, ndihmoheni ish-in tuaj që të bëhet babai më i mirë i mundshëm. Është për interesin e secilit dhe pa dyshim që fëmijët do t'ju duan për këtë veprim.

Nëse babai i fëmijëve nuk është afër jush, kërkoni një burrë të përshtirshëm në kishën ku shkoni, që do të sigurojë një rol pozitiv model të një burri të krishterë për fëmijët tuaj. Ndoshta një baba tjetër mund t'i përfshijë fëmijët tuaj në ndonjë ekskursion familjar, ose të bëjë përpjekje të veçanta për t'u bërë mik me fëmijët tuaj. Do të kuptoni përmes këtij libri se çfarë ndikimi të pamasë ka figura atërore në jetën e një fëmije. Në familjet ku mungon babai, është e udhës të mbushet ky boshllëk me ndonjë mik që mund të shërbejë si një model pozitiv mash-kullor për fëmijët tuaj. Ndërkaq për të gjitha nënat: ju, më shumë se kushdo tjetër, do të përcaktoni si ta shohë fëmija babanë e tyre. Ju keni një fuqi të pa-shtershme, ose ta mbështesni babanë në shërbesën e tij ndaj fëmijëve, ose ta poshtëroni duke e bërë të duket i paafët para syve të tyre. Nxiteni burrin tuaj në përpjekjet e tij atërore, ai ka nevojë për këtë. Jini mbësh-tetëse me fjalë para tij dhe fëmijëve. Më përzemërsi ai përballon veprimet e tij (ose s'vepron fare!) Nëna, ju jeni të rëndësishme! Do të lutem për ju në përpjekjet për ta ndihmuar babanë të bëhet ai që Perëndia e krijoi të ishte që nga fillimi. A jeni një baba me kohë të plotë për fëmijët e tu kur gjendesh në shtëpi, apo priresh të shqetësohesh nga gjërat e punës?

1. Si e keni kuptuar të jeni «i paplotë» përballë rolit tuaj si baba? Çfarë detyrash të rëndësishme ia keni lënë nënës së tyre, mësuesve të tyre, apo edhe drejtuesve të grupeve rinore, të cilat mund të ishin përgjegjësitë tuaja?

2. A ishin befasuere rezultatet e anketave të cituara në këtë kapitull. Pse dhe pse jo?
3. Çfarë do të thoshte fëmija juaj se cili është burimi kryesor mbi informacionin e vlerave të së vërtetës dhe moralit?
4. A kënaqen fëmijët tuaj me marrëdhënien që keni së bashku, si boshti kryesor i rritjes së shëndetshme të një fëmije? Pse dhe pse jo?
5. Përkushtojuni me gjithë zemër privilegjit dhe përgjegjësisë së atësisë së krishterë. Studiojeni këtë libër me laps në dorë, duke nënvizuar mendimet kyçe dhe pikat e zbatimit. Ju mund të krijoni një grup të vogël me baballarë të përkushtuar për të studiuar dhe diskutuar mbi këto parime së bashku.
6. Gjëja më e rëndësishme që kam mësuar gjatë këtij kapitulli ishte:
7. Duhet të filloj me fëmijën tim

Në fund të çdo kapitulli, kam bërë disa pyetje dhe pika zbatimi për t'ju ndihmuar të kuptoni parimet e kapitullit. Nëse keni kohë të mjaftueshme reflektimi, ose, nëse po e studioni librin në grup me të tjerë burra, rekomandoj që të kaloni kohë të punoni me secilën pyetje. Gjithsesi, nëse ka problem me kohën, punoni vetëm me pyetjet e shënuara me yllth (*)

LIDHJA ME ATIN

Nëse jeni si gjithë burrat e tjerë – përfshi këtu edhe ata që kanë një përvojë të varfër, ose të hidhur me baballarët e tyre, – e keni një ide të përgjithshme për llojin e babait që doni të jeni. Keni një tablo në mendje, ndoshta të skicuar për atë që doni të jeni si baba:

- doni të jeni lloji i babait, që fëmijët tuaj të ndihen të sigurt, të dashur dhe të pranuar,
- të tillë që fëmijët tuaj të mbrohen nga seksi para martesë dhe t'u qëndrojnë besnikë bashkëshortëve të tyre në martesë
- të tillë që fëmijët tuaj të zhvillojnë reputacionin si njerëz punëtorë, të ndershëm dhe me edukatë,
- doni të jeni lloji i babait që fëmija t'ju thotë: «Babi im i mban premtimet»,

■ që fëmijët tuaj t'i rezistojnë presionit të një shoqërie jo të shëndetshme, të krijojnë miqësi të shëndetshme, të fitojnë respektin dhe admirimin e bashkëmoshatarëve të tyre,

■ që fëmijët tuaj t'i thonë jo alkoolit, drogës dhe sjelljeve të rrezikshme,

■ që një ditë bija juaj t'ju shprehë në një kartolinë: «Faleminderit, babi, që më qëndrove pranë kur kisha nevojë!», ai lloj babai, të cilin biri i vet e nderon duke i kërkuar të bëhet shoqëruesi i tij i parë në dasmën e tij,

■ që biri juaj të vijë dhe të ulet pranë jush dhe t'ju thotë: «babi, po kaloj ca vështirësi tani dhe kam nevojë për këshillën tënde»,

■ që fëmijët tuaj të jenë të shpejtë për të pranuar gabimin dhe mëkatin, që janë falës me të tjerët dhe që përjetojnë kuptimin e vërtetë të vetë vlerësimit dhe vetësigurisë,

■ që ndoshta dikur të mund t'i kapë veshi që e bija t'i thotë shokut të vet: «Dua të marthohem me dikë që t'i ngjajë babit tim, me dikë që ta admiroj dhe respektoj».

Pikërisht ky lloj babai duam të gjithë ne të bëhemi. Ky lloj babai doja unë të bëhesha kur isha ende i ri, por s'dija se si.

E dija që babi im as që u afrohej këtyre gjërave dhe ndërsa rritesha, më shumë më s'thohej frika që do t'i ngjaja më shumë atij sesa modelit të babait që doja të bëhesha. Kisha shumë nevojë për një model, një baba që të mund ta imitoja, prej të cilit do të mësoja. Ndaj fillova të kërkoja rreth e rrotull në jetën time burra që ngjasonin me modelin e babait që doja të bëhesha vetë. Dhe i gjeta.

Duke kërkuar një model

Një prej modeleve më të hershme dhe më pozitive ishte Dik Dei, të cilin e përmenda pak më parë. U takova me Dikun në një seminar në vitet '0. Ai ishte disa vjet më i vjetër se unë në moshë dhe ishte i martuar me katër fëmijë. Njësoj si unë, ai kishte qenë produkt i një familjeje të shkatërruar, me një baba të alkoolizuar. Ishte bërë i krishterë pas moshës njëzet vjeç dhe i ishte përgjigjur thirrjes së Zotit për shërbesë duke ndjekur këtë seminar.

U takova me Dikun gjatë regjistrimit të orëve të seminarit dhe menjëherë na «ngjiti» muhabeti. U bëmë shumë shpejt shokë dhe ndërkohë unë u bëra anëtar i virtual i familjes së tij, mik i orëve të rastit, përgjithësisht pas orës : dhe : të paradites, zakonisht për të biseduar për gjëra që s'mund të prisnin. Diku ishte gjithmonë i duruar, i mirë dhe i dashur – cilësi, të cilat i njihja shumë pak gjatë fëmijërisë sime.

Menjëherë më bëri përshtypje mënyra si i trajtonin fëmijët e tyre dhe

njëri-tjetrin Diku dhe Sharlota. Ata kishin një lidhje të veçantë dhe plot cilësi me secilin prej fëmijëve. Shihja me habi gëzimin që ndanin me njëri-tjetrin, ishin shpesh të qeshur dhe të përqafular. (në fakt, do të thosha që vetë mësova të përqafoja prej tyre!) Pashë te Diku llojin e babait që doja të bëhesha një ditë. Pashë modelin e artë dhe konkret të asaj që doja të bëhesha.

Më vonë, kur të dy me Dikun u bashkuam me shërbesën e Institutit Jeta e Re, patëm drejtime të ndryshme për pak kohë. Unë vetë fillova të jepja leksione në konviktet e universiteteve në ShBA dhe Kanada, ku u takova me Dotin. Kur fillova të shoqërohesha me të, më bëri kureshtar lidhja e saj me familjen e vet, sa shumë kuptim kishin për të nëna, babai, motra dhe vëllai i saj. Disa muaj më vonë, gjatë pushimeve të Krishtlindjes, u takova me familjen e Dotit. Është e vështirë të them se çfarë më afroi më shumë gjatë atyre ditëve të para me Dotin – të njihja Dotin, apo babanë e saj? E kuptova pse ajo e admironte aq shumë atë. Ai ishte tipi i njeriut tradicional, i tërhequr (në fakt, pak i ngurtë), por dukej qartë pse ajo e donte dhe e respektonte aq shumë. Që në fillim mësova prej tij ç’do të thotë të jesh burrë i dashur dhe baba i mirë. Pashë një burrë të shoqëruar nga dashuria, besimi dhe respekti i fëmijëve të vet, një burrë, fëmijët e të cilit ishin rritur prej tij aq mirë, sa të dyja palët ndiheshin mirë në shoqërinë e njëri-tjetrit. Për vite të tëra, shembulli i këtyre njerëzve mbushi nevojën time për atë që doja të bëhesha një ditë si baba. Ata treguan cilësitë e babait që kisha kërkuar gjithë jetën, cilësi që me ngutësi doja t’i shfaqja një ditë në familjen time. Mësova shumë nga shembulli i tyre, por disa vjet më vonë mësova më tepër prej një modeli tjetër shumë më të mirë, një mënyrë tjetër shumë më të mirë për babanë që doja të bëhesha.

Modeli i Atit

Norman Uejkfildi, miku dhe bashkautor i që e përmenda në kapitullin e parë, është një prej njerëzve që më ka ndihmuar shumë në plotësimin e kuptimit të rolit dhe burimit për t’u bërë baba i mirë. Edhe pse përvoja e Normanit nga fëmijëria e vet ishte krejt e ndryshme nga imja, ai më tregoi disa prej vështirësive, ndërsa mendohej të krijonte modelin e shëndetshëm të babait. Normani e shpjegon kështu:

Vetëm në gjysmën e dytë të moshës sime të pjekurisë mund të rindërtoja një lidhje të ngrohtë, miqësore me babanë tim.

Jeta profesionale e tij ishte e mbushur me presione dhe zhgënjime. Ai e kishte pasur të vështirë të kënaqej me fëmijët e vet, ndërkohë që ne si fëmijë e patëm të vështirë të afroheshim me të.

Kujtoj se, kur pranova Krishtin isha dymbëdhjetë vjeç, anëtar i parë i familjes sime që bëhesha i krishterë. Ndërkaq fillova të krijoja një imazh mbi dashurinë e Atit qiellor dhe s’mundesha t’ia anashkaloja vetes lidhjen me atin tim tokësor.

Meqenëse babai im s'kishte qenë asnjëherë i kënaqur me mua, fillova të ndihesha njësoj me Zotin. Më dukej sikur Ai më thoshte: «Po pse nuk përmirësohesh, more Norman? Çfarë duhet të bëj me ty? Ose sillu mirë, përndryshe unë...»

Mund ta imagjinoni çfarë ndikimi pati kjo në imazhin e një

adoleshenti, me perceptimin e gabuar të dashurisë së Perëndisë!

Është e zakonshme që një fëmijë të mendojë se Zoti e çmon njësoj si babai i tij. Nëse babai është i dashur, miqësor dhe i kuptueshëm, ai tenton natyrshëm ta mendojë Zotin si të tillë; të dashur, miqësor dhe të kuptueshëm. Por nëse babai është i ftohtë, jo miqësor dhe i zënë më shumë me «gjëra të tjera të rëndësishme», ky fëmijë ka më shumë prirje të mendojë që Zoti s'është i interesuar për të si individ i veçantë. Kam pasur pikërisht këtë imazh të gabuar deri në moshën dyzet vjeçare, kohë kur Ai solli rrethanat në jetën time që e transformuan plotësisht lidhjen me Të. Kuptova çfarë Zoti i dashur, i kujdesshëm dhe plotësisht i interesuar është ai! Ishte pikërisht për shkak të këtyre rrethanave që muret ndarës më në fund u shembën dhe kjo shërbeu edhe për lidhjen me babanë, që të bëheshim më të se më parë. Si pjesë e zbulimit tim të ri mbi natyrën e Zotit, lexova te psalmet me laps në dorë, duke shënuar çdo referim që përmendte Zotin. Ndërsa i studiova këto vargje, kuptova që gati çdo referim qoftë drejtpërdrejt ose jo, jepte përshkrimin e Atit tonë qiellor. Menjëherë mbusha shumë faqe të shënuara me këto cilësi, ku prej tyre u krijua një profil që shumë prej nesh do ta konsideronin si ati «ideal». Përfundimi? Cilësitë themelore të atësisë të para në Zotin tonë janë cilësitë që Ai dëshiron t'u japë trajtë në baballarët e sotëm të krishterë! Zbulova një teologji për atësinë – roli model i Zotit vetë!

Zoti është modeli i atit! Në kërkimet e mia për atësinë, kam qenë me fat që mund të gjeja dy më të mirat. Por Normani më ndihmoi të shihja që kisha neglizhuar modelin më të mirë, më origjinalin, standardin e një atësie të suksesshme – Zotin vetë. Tabloja që kisha në kokë për llojin e babait që doja të bëhesha – të skicuar ndoshta, – ishte në fakt tabloja e Atit qiellor, që është burimi i të gjitha të mirave (Jakobi 1:17) Ai është «Ai, prej të cilit burojnë gjithë të mirat» (1 Korintasve 8:6) Ai ia dha frymën e jetës njeriut të parë dhe Adami u bë i pari «bir i Zotit» (Luka 3:37). Prej atij çasti secili prej nesh u bë në ngjasim me «Atin tënd, Krijuesin tënd, që të krijoi dhe të dha jetë» (Ligji i përtërirë 32:6). Në kuptimin e parë nga «Dita e parë» Zoti jo vetëm dëshiroi një lidhje atë-fëmijë me secilin prej nesh, por gjithashtu Ai modeloi një model atësie të shëndetshëm.

Ai është Atë i butë, që na fton t'i drejtohem me «Abba», e cila përkthehet nga gjuha armaike «babi», ose «baba» (Rom 8:15, Gal 4:6). Ai është një Atë dëgjues që na bën t'i afrohem pa frikë si «Ati ynë në qiell» (Mateu 6:9) Ai është Ati i dashur, që na

shfaqi me vullnet të lirë dhe energjikisht dashurinë e tij atërore në pagëzimin e Birit të Tij, Jezusit, me një zë si gjësim që tha: «Ky është biri që dua; me të cilin jam i kënaqur!» (Mat 13:7). Ai është Ati dhënës, që u jep dhurata të mira fëmijëve të vet (Mat 7:11) Ai është Ati i të gjithëve (Ef. 4:6), përkufizimi i vërtetë i atësisë, themeli i gjithçkaje të mirë, morale, të denjë për t'u ndjekur.

Prandaj, nëse gjithkush që do të bëhet baba i mirë dhe i suksesshëm, modelin, standardin e gjen te Perëndia Atë. Karakteristikat që kam kërkuar dhe më kanë munguar në atin tim tokësor i gjeta në Zotin. Tiparet që i admirova aq shumë te Dik Dei dhe babai i Dotit ishin tepër tërheqëse për mua, sepse reflektonin në të vërtetë atributet e Atit qiellor. Cilësitë që me aq etje doja t'ua shfaqja fëmijëve të mi ishin ato që i përngjanin natyrës së Atit qiellor. Ky kuptim, ky perceptim, më transformoi dhe më dha fuqi. Nuk kisha pse të ndihesha më i gjymtuar nga shembulli i atit tim tokësor. S'kisha pse të vazhdoja të kërkoja modele (dhe pse mund të mësoj ende prej tyre). S'kisha pse të përpiqesha të formoja një skicë në mendjen time për atë që doja të bëhesha si baba. Gjithë nevojat e mia si baba takoheshin në Zotin, modelin e Atit!

Burimi i Atësisë

Gjithsesi nga transformimi që pata, kisha ende për të mësuar. I hyra një udhëtimi emocionues për të zbuluar dhe kuptuar më tej mbi cilësitë e Perëndisë At, duke ditur që një njohuri e tllë nuk do të thellonte thjesht diturinë time për të, por do të më mësonte rreth asaj që doja të dija që të bëhesha babai i fëmijëve të mi. Ndërsa forcoja lidhjen time me Zotin, forcova edhe lidhjen me fëmijët e mi, duke rritur rezultatin në marrëdhënie me ta.

Çelësi i kësaj lidhjeje të dyfishtë atërore ishte të kuptuarit se Zoti At nuk është thjesht modeli i pakrahasueshëm i babait të suksesshëm, por burimi i domosdoshëm për të qenë babai që dëshiron të jesh. Lidhja me Atin nuk është thjesht imitim, apo garë nxitjeje; por bashkëshoqërim. Nuk ka të bëjë me: si ta njohësh, por kë të njohësh! Lidhja me Atin nuk është një sistem i ri me rregulla mbi atësinë; në fakt ka shumë libra që thjesht mund t'u bashkëngjiten listës suaj, duke ju treguar çfarë të bëni për të qenë baba i mirë. Por lidhja me Atin ka të bëjë me marrëdhënien, me rolin tuaj si baba, që mund t'ju transformojë ju, fëmijët tuaj, familjen dhe të ardhmen.

Kam kuptuar se sa më e fortë është lidhja ime me fëmijët, aq më i përballueshëm është presioni që ka shoqëria mbi ta për të marrë vendime të drejta, për të nderuar Atin e tyre dhe për t'iu bindur Atij.

Një lidhje e fortë dhe e vazhdueshme me Atin, duket se i bën ata jo vetëm të gatshëm për të bërë një jetë të shëndetshme dhe të lumtur, por edhe më të zotë për ta jetuar kështu. Siguria, konfidenca dhe kënaqësia që buron nga kjo lidhje e fëmijëve me prindërit e vet i forcon këta përballë kurtheve dhe tundimeve, ndërsa janë në

shkollë ose me shoqë- rinë. Njësoj ndodh në lidhjen time me Zotin, por në një nivel më të thellë. Kur lidhja me të është e fortë dhe e vazhdueshme, nuk jam vetëm i gatshëm për të qenë babai që dua të jem, por kam fuqi për t'u bërë i tillë përmes Frymës së Shenjtë, përmes Pranisë së Tij tek unë dhe në mua. Në këtë mënyrë kritike, Ai s'është vetëm modeli im si baba, por dhe burimi im. Për të perfrazuar Psalmin :: «Ai është mburoja dhe forca ime si baba; kur zemra ime beson tek ai, jam i mbrojtur».

Të bësh lidhjen

Një shoku im më tregoi njëherë historinë e vet kur kishte qenë adoleshent dhe kishte punuar si Dixhej në stacionin radiofonik të shkollës. Ky stacion punonte gjatë kohës së pushimeve verore dhe Bobi duhet të shkonte në : të mëngjesit për të ndezur transmetuesin. (Sinjali i kësaj radioje shpërndahej në një rreze prej tetë deri në pesëdhjetë kilometra!) Pas disa minutash pune me transmetuesin, ai do të ishte gati për punë dhe Bobi do ta ndizte në orën tetë të mëngjesit për katër orë rresht program.

Gjatë atij mëngjesi të veçantë, Bobi u ndje çuditërisht i saktë. Zgjedhja e muzikës ishte e goditur, procesi i vënies së këngëve njëra pas tjetrës në mënyrë harmonike dhe pa ndalesë, u realizua artistikisht bukur. 2 Ngacmimi i tij qëllori të ishte gjetje midis këngëve dhe po ndihej më i sigurt në vete dhe krenar. Kjo gjendje zgjati deri kur ai mori dërrasën për të plotësuar kontrollin e treguesit metrik të transmetuesit.

Transmetuesi ishte jashtë funksionit. Bobi e goditi kontaktorin, tundi fijet e përziera të telave që u hapën dhe dolën nga transmetuesi, pastaj e përplasi në mur. Priza e madhe elektrike u lëkund nga foleja. Siç duket kishte punuar deri tani çuditërisht e përvënë në prizë. Kishte qenë ashtu gjithë mëngjesin! Performanca e mirë dhe e zgjuar e Bobit kishte pasur deri atëherë vetëm një audiencë: atë vetë! Sepse transmetuesi nuk ishte lidhur me burimin elektrik.

Kapitujt vijues theksojnë dhjetë cilësitë e Perëndisë Atë – Burimi i fuqisë për çdo të krishterë që karakterizon bashkëveprimin e tij me fëmijët e tij, duke siguruar kështu një model për rolin dhe detyrat tuaja si baba. Secili kapitull, përveçse do të zbulojë një atribut të veçantë të Atit, do të të ndihmojë që të aplikosh dhe kultivosh këtë cilësi, me ndihmën e Frymës së Shenjtë në jetën dhe familjen tënde.

Bashkohu me mua në vendimin për të modeluar një karakter të Atit tonë qiellor te fëmijët tanë. Besoj se do jetë vendim me vlerë, sepse jo vetëm që do t'u jepni fëmijëve një tablo të bukur të atësisë së Perëndisë, por edhe figurën e një babai, që është i denjë për dashurinë dhe respektin e fëmijëve të tij; një njeri, fëmijët e të cilit besojnë tek ai; një njeri që kënaqet në shoqërinë e fëmijëve të vet, duke u ndjerë krenarë për ta dhe rehat në praninë e tyre.

1. Kalo pak kohë për të medituar mbi llojin e atit që do të jesh. Pastaj, plotëso këtë deklaratë sa herë që të nevojitet, derisa të kesh plotësuar deklaratën e shpresave dhe dëshirave të tua si baba. (nëse të duhet mund të përdorësh një fletë të veçantë)

Dua të jem një baba që ...

2. Cilët kanë qenë shembujt më të mirë të atësisë për ty? Shkruaj emrat e tyre dhe krahas tyre mësimet që ke mësuar prej secilit.

3* Si mund ta përmirësosh lidhjen tënde me Atin qiellor? Shih çfarë të përshtatet.

- ☐ Duke filluar me një kohë të rregullt lutjeje dhe leximi të Biblës
- ☐ Duke rifilluar me një kohë të rregullt lutjeje dhe leximi të Biblës
- ☐ Duke vazhduar me një kohë të rregullt lutjeje dhe leximi të Biblës
- ☐ Duke u takuar rregullisht me të tjerë që e duan Atin, për shoqërim dhe adhurim
- ☐ Duke u bërë pjesë e një grupi lutjeje, ose studimi biblik

4. Nëse s'ke bërë një prej këtyre, zgjidh dy, ose tre baballarë të tjerë, që do të vendosin të jenë në një grup të përkushtuar me ty, studiojeni bashkë këtë libër dhe punoni me pyetjet. Vendosni të luteni dhe të inkurajoni njëri-tjetrin, ndërsa ecni në rrugën e përsosmërisë së atësisë së krishterë.

DASHURIA PA KUSHTE DHE PRANUESE A ATIT

Vite më parë pranova të flisja në një mbledhje të një shkolle të mesme në Feniks të Arizonës. Për shkak të programit të ngjeshur, më duhej t'u flisja gjithë nxënësve brenda një sesi, një numër tepër i madh për t'u nxënë brenda auditorit të shkollës. Ndaj mbledhja u mbajt jashtë dhe m'u desh të rrija mbi një gur të madh për të folur para turmës prej gati 1000 nxënësish, që ishin ulur në barin e oborrit të shkollës. Sa fillova fjalimin tim, një grup rrokerash me flokë të ngjyrosur dhe me vathë e zinxhirë të mëdhenj në qafë u afruan rreth njëzet hapa larg meje. Disa prej mësuesve dhe nxënësve po rrinin në gatishmëri, duke pritur se mos krijohej ndonjë turbullirë nga grupi shumëngjyrësh, por unë vazhdova fjalimin, duke e mbaruar pa as ndërprerjen më të vogël. Kur zbrita nga guri i sajuar si podium, drejtuesi i grupit të rrokerave vrapoi drejt meje dhe ndali më pak se një hap larg meje. Një ngulçim u dëgjua nga turma dhe një mijë palë sy ishin drejtuar tek unë dhe djaloshi. Gjithsesi, shumica e turmës nuk mund të shihte lotët që rridhnin në faqet e këtij rrokeri dhe as që mund të dëgjonin lutjen e tij për ta përqaftuar. Por një valë murmuritjeje u rrokullis nëpër turmë kur përqaftova djaloshin dhe ai vari kokën në supin tim e filloi të qante. Ky përqaftim zgjati rreth një minutë – përqaftim i gjatë për një rroker! Në fund, ai u shkëput prej meje dhe përmes lotëve më tregoi: «Im atë s'më ka përqaftuar kurrë, apo të më thoshte 'të dua'!» Ai djalosh po ulërinte nga mungesa për dashurinë e babait, donte të ndiente dashurinë dhe pranimin që vetëm babai mund t'ia jepte. Pamja e tij e çuditshme dhe sjellja e çmendur ishte si një thirrje për vëmendje – diçka që ai s'e kishte marrë nga i ati.

Nevoja kryesore e fëmijës

Kam dëgjuar, apo kam qenë dëshmitar i historive të tilla me qindra, apo dhe mijëra herë. Kam parë dhimbjen dhe rrënimin që u ndodh të rinjve dhe të rejave, baballarët e të cilëve janë të pazotë, ose jo të gatshëm për t'u komunikuar dashuri dhe pranim. Kam folur para një numri të madh adoleshentësh në Fishner, një festival muzikor dhe konferencë mësimore të mbajtur në një fermë në Virxhinia. Një mëngjes, ndërsa po flisja për rëndësinë dhe vlerën e ruajtjes së seksit deri në martesë, tregova para turmës për mijë njerëz të veçantë me vlera të pakrahasueshme dhe që, nëse një ditë të tjerë do t'i duan në të vërtetë, atëherë do ta kuptojnë këtë vlerë dhe nder, duke pritur deri në martesë para se të kishin marrëdhënie sek suale. Më vonë, po atë mëngjes, vura re një vajzë bionde, rreth vjeç që po më ndiqte. Ndala dhe e pyeta: «Mos doje të më takoje?» Ajo ma ktheu pak me ndrojtje: «Vërtet mendon se jam e veçantë?» «Po!» – iu përgjigja pa menduar gjatë. «Zoti të ka krijuar të veçantë dhe mos e harro këtë!» Me kujdes i hodha dorën në qafë dhe i dhashë një përqaftim të ngrohtë prej ati, befasisht ajo u shkreh në vaj. «As që e merr me mend sa gjatë kam pritur një gjë të tillë!» tha

ajo. «Mami dhe babi im u ndanë pesë vjet me parë dhe im atë s'më ka përqaftuar kurrë, apo të më thoshte që jam e veçantë». Pesë ditë më vonë, kur po nisesha për në aeroport mora një shënim nga roja i sigurimit, i cili më tha se ia kishte dhënë një vajzë e vogël. Letra e palosur imtësisht kishte vetëm pesë fjalë të shkruara me laps të kuq:

Faleminderit për dashurinë tënde... Korina

Asaj vajze po i qante zemra për dashuri dhe pranim, të tillë që vetëm një baba mund ta japë atë që asaj i kishte munguar gjithë jetën.

Kanë qenë shumë herë të tilla, kur më është thyer zemra nga raste si i Korinës, kur këto janë kaq të shumta. Kanë qenë të shumtë të rinjtë që më kanë thënë: «Im atë s'më ka treguar kurrë dashuri» ose im atë më kushton vëmendje vetëm kur bëj ndonjë gabim».

Kam dëgjuar baballarë t'u thonë fëmijëve të tyre: «Budalla», «Idiot», apo dhe më keq.

Kam parë baballarë që u bërtasin keqas fëmijëve në fushën e basketbollit, apo bejzbollit.

Kam ngrënë darkë me baballarë, që s'kishin biseduar kurrë me fëmijët e tyre dhe s'dinin si t'i përfshinin në bisedë gjatë darkës.

Kam njohur baballarë që kalonin vetëm pak kohë me vajzat e tyre, vetëm për t'i qortuar për veshjen, apo për djalën që po shoqëroheshin.

Kam vënë re baballarë, që flasin hapur me të tjerë për gabimet dhe të metat e fëmijëve të tyre edhe në praninë e vetë atyre.

Dhe tragjikisht, kam parë rrënimin emocional që baballarë të tillë shkaktojnë te fëmijët e tyre nga veprimet, apo dhe pasiviteti i tyre. Fëmijët, pavarësisht nga mosha, kanë një nevojë të rrënjësor për t'u ndjerë të rëndësishëm, të pranueshëm dhe të dashur. Zoti ka caktuar që kjo nevojë e shëndetshme dhe normale të plotësohet së pari në familje nga mamaja dhe babai. Nëse të dy prindërit nuk e plotësojnë këtë nevojë për dashuri dhe pranim, të rinjtë do ta kërkojnë këtë mbushje boshllëku emocional te dikush, apo diçka tjetër, rrugë që do t'i çojë në sjellje shka- tërruese për jetën. Një baba që nuk i komunikon dashuri dhe pranim fëmijës së vet shkakton ndikim negativ tek ai.

Nuk është ky lloji i babait që dua të jem. Dua të jem ai baba, fëmijët e të cilëve ndihen të dashur dhe të pranuar, rriten të sigurtë, bëhen burra dhe gra të sigurtë në vete, fëmijët e të cilit janë të zotë të duan të tjerët. Dua të jem ai lloj babai që im Atë është.

Dashuria e parë, kryesore dhe e përjetshme

Bisedoj me shumë njerëz, të rinj dhe të vjetër, që s'e kuptojnë që Zoti i do edhe para se të bëhen të krishterë. Kur ishim në errësirë, atëherë kur ishim ende armiq të Perëndisë, ai na deshi dhe vdiq për ne. (Ef 5:8, Rom 5:8) Ai na deshi i pari (1 Gjoni 4:19) Ai s'priti «që të pastronim veprimet tona». Ai s'priti derisa ne të plotësonim dëshirën e tij, s'priti derisa ta bënim të ndihej krenar, Ai thjesht na deshi.

Dhe jo vetëm kaq, ai e tregoi dashurinë që kishte për ne. Ai nuk është lloji i atit që s'mund ta përqafojë fëmijën e vet, apo t'i thotë: «Të dua». S'është as lloji i atit të tillë, që ka gjëra të tjera më të rëndësishme

për të bërë Dashuria e tij për ne është kryesore (Rom 8:32), ai e tregoi dashurinë me anë të fjalës (Gjoni 1:14) Ai e tregoi dashurinë në kryq, e shkroi këtë dashuri në gjak.

Ati, jo vetëm na deshi i pari dhe së pari, por dhe me një dashuri të përjetshme. (Jer 31:3) Dashuria e Atit është e plotë, e vazhdueshme dhe pa kushte. S'mund ta meritojmë, s'mund t'i shpëtojmë, s'mund ta fshijmë. Ai mund të mërzhitet kur nuk i bindemi, të dëshpërohet kur ikim prej tij, apo të pikëllohet kur mëkatojmë, por ai kurrë, kurrë, kurrë, s'do të ndalë së dashuri. Dashuria pa kushte e atit tonë është si...

As vdekja, as jeta, as engjëjt, as demonët, as e tashmja, as e ardhmja, as fuqitë dhe as lartësitë, apo thellësitë, as dhe ndonjë tjetër krijesë s'do të mund të na ndajë nga dashuria e Zotit që është në Krishtin Jezus, Zotin tonë.

Romakëve 8:38-39

Pikërisht ky lloj babai dua të jem! Dua që fëmijët e mi të dinë që i dua dhe i pranoj. Dua që ata të dinë se i dua edhe pa ma kthyer dashurinë. Dua që të dinë se i kam dashur edhe pse kjo për mua së pari do të thotë pastrim bebelinash, ushqim me shishe qumështi dhe kujdesje për gro mësitje. Dua që ata të dinë se dashuria ime për ta është pa kushte, e pabazuar në gjërat që bëjnë, por në atë që janë. Gjithashtu dua që ata të kuptojnë se dashuria ime për ta është kryesore. Puna, dëshirat, miqtë e mi, statusi im në kishë, apo komunitet nuk ka rëndësi më të madhe para tyre. Dashuria ime për ta është kryesore. Në fund, dua t'u tregoj fëmijëve të mi, se i dua përjetësisht. Dua që ata të dinë se i dua dhe i pranoj dhe s'kanë pse ta meritojnë dashurinë time. Ata s'mund t'i shmangen dashurisë sime dhe as ta fshijnë atë. Ky lloj babai dua të bëhem, por sigurisht, ky lloj ati nuk vjen natyrshëm për shumë burra dhe unë ndoshta jam i fundit midis të gjithëve. Është diçka që më është dashur ta mësoj.

Duke krijuar një ambient pranimi dhe

dashurie pa kushte

S'ka asgjë tjetër më të rëndësishme për një baba se të mësojë të pranojë dashurinë pa kushte. E patë që, nëse fëmija juaj nuk e përjeton dashurinë tuaj të pakushtëzuar dhe pranimin prej jush, do të ndihet i pasigurt. Dhe një fëmijë i tillë zakonisht është (për të mos thënë gjithmonë) mjaft i ndjeshëm. Një fëmijë i pasigurt nuk bëhet i singhtë. Ai s'do të tregojë çiltërsisht çfarë i ndodh në shkollë. As që ka për të treguar si shkon me të dashurin. Sa më shumë t'i shprehni fëmijës suaj dashuri dhe pranim, aq më i hapur dhe i singhtë do të jetë ai me ju për të ndarë shqetësimet, mendimet dhe dyshimet e tij me ju.

Por patjetër që kjo nuk është aq e lehtë. Në fakt për të qenë i singhtë, ndonjëherë duket dhe si e pamundur. Vetëm Zoti mund të pranojë plotësisht pa kushte. Si mëkatarë, ne jemi të kufizuar në aftësinë për të pranuar fëmijët tanë, por dobësitë tona mund të mbushen me fuqinë e Frymës së Shenjtë që na jep aftësi që ne as që kishim menduar se do t'i kishim ndonjëherë.

Pra, si do t'ia bëjmë? Si ta tregojmë pranimin dhe dashurinë pa kushte, ashtu si dashuria e Atit tonë ndaj nesh, ndaj fëmijëve tanë? Sigurisht që fillon me lutje të çiltër dhe siguri e besim të vazhdueshëm në Zotin. Nëse jemi të lidhur me Zotin përmes Frymës së Tij të Shenjtë, atëherë mund të jemi të lidhur me nevojën e fëmijëve tanë dhe të plotë- sojmë me vetëdije dhe me kujdes shtatë vetitë themelore të pranimi dhe dashurisë pa kushte.

Duke treguar dashuri

Një nga mënyrat më themelore për t'i plotësuar nevojën fëmijës për dashuri pa kushte është t'ia tregosh këtë dashuri. Ka fuqi të pafund në një puthje, apo përqafim të thjeshtë, në disa fjalë ledhatuese, ose në një vështrim me dashuri.

Në librin e tij *Njeriu i plotë*, Dan Benson reflekton në vlerën e çaste-ve të tilla në fëmijërinë e vet:

S'kam

për t'i harruar kurrë përqafimet familjare që zinin vend shpesh në kuzhinën tonë. Mamin të mbështjellë në përqafim nga babi, ndërsa çapiteshin përmes derës (një pamje e zakonitë kjo në shtëpinë tonë) dhe kjo më bënte të ndihesha mirë përbrenda vetes. Aq mirë sa s'mundesha t'i rezistojta ndjesisë që të bashkohesha me ta... kështu që do të sulesha mespërmes kuzhinës dhe do t'i mbështillja duart e mia rreth këmbëve të tyre. Mami dhe babi do të më përfshinin gjithmonë dhe mua me kënaqësi. Nëse ndonjë prej vëllezërve të tjerë do të ishte aty, atëherë do të përfshiheshin edhe ata dhe kështu do të bëhej një përqafim edhe më i madh, që rritej e rritej. Mami dhe babi e bënë shtëpinë tonë një strehë të dashur, më shumë me veprimin e tyre se me mësimet

e tyre. Ne ndiheshim të sigurt si fëmijë, sepse babi i jepte shtëpisë atmosferë dashurie dhe gëzimi.

Të kënaqesh në veçantinë e secilit fëmijë

Zoti na krijoi si individë të veçantë. Pa mendo; midis më shumë se pesë miliardë njerëzve që jetojnë sot në tokë, nuk ka një tjetër të ngjashëm me ty dhe s'ka asnjë të ngjashëm me djalin, apo vajzën tënde.

Babai i Dotit, të cilin e përmenda në kapitullin e dytë, kishte një mënyrë të thjeshtë për të njohur çdo fëmijë si individ të veçantë. Ai i thoshte Dotit: «Je vajza ime e madhe e preferuar» dhe pastaj motrës së saj të vogël: «Je vajza ime e vogël e preferuar» dhe vëllait të saj: «Je djali im i preferuar». Mund të duket e thjeshtë, madje dhe si budallallëk, por ja që funksionon, duke i bërë fëmijët e tij të ndihen të veçantë. Është tragjike të dëgjosh një baba t'i thotë fëmijës së vet: «Pse s'mund të jesh si vëllai yt?» ose «Motra jote s'ka pasur asnjëherë prob leme me matematikën!»

Si të kënaqesh më shumë me veçantinë e fëmijës tënd, duke e pranuar si individ me veçori të rralla, talente dhe dhunti? Nëse nis të studiosh fëmijën tënd, do të gjejsh shumë mënyra që do ta dallojnë nga të tjerët; e qeshura ngjitëse, aftësia për të bërë miq, një shpirt i dhembshur, një zë të bukur për të kënduar, një buzëqeshje rrezatuese, dashuri për kafshët. Sigurohu që t'i komunikosh bukurinë dhe mrekullinë e të qenit i veçantë si fëmijë përmes mënyrave pozitive.

Të pohosh vlerën personale të fëmijës

Fëmija ka nevojë të ndihet i vlerësuar personalisht. Një person duhet të fitojë besimin dhe ndjesinë, që është me vlera.

Baballarët mund ta bëjnë këtë me fëmijët në shumë mënyra. Një prej mënyrave është të kalosh kohë me fëmijën tënd, koha tregon rëndësi. Në fakt, e kam thënë shpesh që fëmijët e shqiptojnë dashurinë ndryshe nga prindërit e tyre; ata e shqiptojnë «K—O—H—Ë». Për mua gjithmonë mbetet një sfidë e veçantë, sepse jam shpesh larg shtëpisë. Gjithsesi, më duhet të punoj fort për ta kompensuar, duke i marrë fëmijët me vete sa herë që të mundem, duke telefonuar në shtëpi çdo ditë dhe të shkoj me fëmijët për të ngrënë mëngjes sa herë që kthehem në shtëpi nga udhëtimi.

Një të diel isha ftuar që të flisja në San Diego Çargërs, në kohën e tyre të lutjes para ndeshjes. E mora dhe djalin tim, Shaunin, me vete dhe pas lutjes shkua në stadium ku gjetëm vendet tona. Skuadra na kishte dhënë vendet ballore shumë afër fushës. Pesëdhjetë mijë spektatorë mbushën stadiumin dhe thirrjet u bënë të zjarrrta.

I hodha krahun djalit dhe i thashë: «Shih gjithë këta njerëz, shoku!» Shauni bëri një rrotullim të plotë prej gradësh për t'i parë të gjithë, sidomos ata sipër nesh. Në sytë e një djaloshi dhjetë vjeçar dukej sikur gjithë bota ishte mbledhur aty.

«Ua, babi, – thirri Shauni, – sa shumë njerëz paska!»

«Po, ashtu është. Po e di çfarë? Ti je më i rëndësishëm për mua se gjithë këta njerëz bashkë. Bir, ajo që mendon ti për mua ka më shumë kuptim se mendimi i gjithë këtyre pesëdhjetë mijë njerëzve këtu».

Sytë e Shaunit u shqyen nga habia. I hodhi dhe një vështrim gjithë stadiumit. Dhe pastaj, me një gëzim fëmijëror, thirri: «Vërtet, babi? Më shumë se e gjithë këtyre?» U hodh në prehrin tim, duke u ndjerë më i sigurt dhe i vlerësuar. Në atë çast, Shauni e dinte që mund të mbështetej tek unë.

Të edukosh ndjesinë e të përkriturit

Nëse fëmijët tanë nuk ndihen se i përkasin shtëpisë së tyre, do të kërkojnë diku tjetër për ta plotësuar këtë ndjesi. Disa, si ai djali që takova në Feniks, identifikohen me një grup bashkëmoshatarësh (ndonjëherë të çuditshëm), të tjerë bashkohen me gangsterë rrugësh, pikërisht sepse këtu ndjejnë të plotësojnë ndjesinë e të përkriturit. Ndërkaq të tjerë e mbushin ndjesinë e pranimit duke bërë seks. Suzana, një nxënëse në shkollë të mesme e shpjegonte kështu aktivitetin e vet seksual: «Ndihesha vetëm. Mami dhe babi ishin gjithmonë të zënë për t'u marrë me mua. Kur Tedi u bë shoku im u ndjeva si e dalldisur. Ai më dëgjonte, mund të më përkrahte dhe ngushëllonte. Vërtet më dukej sikur kujdesej për mua».

Miku im, Dik Dei dhe gruaja e tij, Sharlota, për të cilët fola në kapitujt e mëparshëm, adoptuan një fëmijë jetim korean të quajtur Timote. Pasi Timoteu erdhi në Amerikë dhe u bë pjesë e familjes së Dikut, iu desh pak kohë të përshtatej me kulturën dhe familjen e re. Një ditë, kur Timi po vazhdonte me këtë përshtatje Diku e pyeti: «Timi, do të doje të ktheheshe dhe njëherë në Kore?» «Oh, jo, – iu përgjigji Timi. «Pse?» e pyeti Diku. «Se këtu ndihem i veçantë», – ia ktheu Timi.

Ju vetë mund t'i krijoni fëmijës ndjesinë e të përkriturit, ndjenjën se janë pjesë e rëndësishme e familjes. Kjo do t'u japë atyre forcë për të përballuar ndjenjat e pasigurisë, presionet negative të shoqërisë, përfshi këtu dhe presionin për të kryer marrëdhënie seksuale. Dashuria dhe pranimi juaj shpreh: «Ti i përket, ti ke vlerë», duke u dhënë atyre një bazë për të vlerësuar dhe respektuar veten.

Të pranosh vlerën më shumë se rendimentin

Kur im bir, Shauni, ishte dymbëdhjetë vjeç, luante me një skuadër bejzbolli. Një javë para se sezoni të fillonte më erdhi një ide si t'i tregoja atij – dhe shokëve të tij të skuadrës pranimin. Bleva dymbëdhjetë kupona fitues për akulllore dhe ia dhashë trajnerit të tyre.

«Trajner, – i thashë, – këto janë për fëmijët».

«Faleminderit, – buzëqeshi trajneri. – Shumë bukur. Do të doja që dhe baballarë të tjerë të bënin diçka të tillë. Do t'ua jap pas fitores së parë.»

«Jo, trajner, – ia ktheva me të shpejtë, – dua t’ua japësh kur të hum basin.»

Ai më pa me çudi. Vura re se ajo që thashë s’njësohej me konceptin e tij për fitoren dhe humbjen dhe shpërblimit për lojë të mirë. Ndaj ia shpjegova:

«Trajneri, në rritjen e fëmijëve të mi dua që ata ta pranojnë suksesin aq sa përpjekja që bëjnë. Dhe s’dua që ta pranojnë përpjekjen më shumë se fakti që janë të krijuar sipas shëmbëllimit të Perëndisë. Besoj që im bir është krijuar sipas shëmbëllimit të Perëndisë ndaj dhe ka vlera të pafund dinjiteti dhe denjësie, që në fund të fundit s’kanë të bëjnë fare me bejzbollin. Edhe nëse atij s’do t’i binte asnjëherë shansi për të luajtur bejzboll, do ta pranoja dhe doja po aq shumë sa tani».

Trajneri i Shaunit më vëzhgoi për një kohë. Pastaj gjithçka që mund të thoshte ishte: «Epo, ky qenka një lloj i ri».

Trajneri kishte të drejtë. Pas humbjes së parë të skuadrës, ai u ndau kuponat të gjithëve dhe së bashku shkuan për të ngrënë akulllore.

Shauni mund të më ketë falënderuar rreth pesë herë për veprimin tim. Veç kësaj, gjatë dy javëve pasuese ishin dhe tri fëmijë të tjerë të skuadrës që më shprehën mirënjohjen për dhuratën e veçantë, por do theksoja thënien e një djali me emrin Xhesi: «Faleminderit shumë për akulloret, zoti Mekdauell. S’kishte rëndësi për ju nëse fitonim ose humbisnim, – na deshët njësoj». Pikërisht kjo ishte çështja. Doja t’i tregoja Shaunit dhe shokëve të tij se i dua, i pranoj dhe i vlerësoj pavarësisht sa sukses arrijnë. E gjithë kjo e ka filluesin te fakti që secili prej tyre është i krijuar sipas shëmbëllimit të Perëndisë dhe si pasojë e kësaj zotërojnë vlera të pafund.

Të kultivosh ndjesinë e kompetencës

Fëmijët kanë nevojë për një ndjesi në rritje të kompetencës në mënyrë që të ndihen të dashur dhe të pranuar nga familjet e tyre dhe më pas nga shoqëria. Të gjithë fëmijët kanë një dëshirë të natyrshme për të bërë mirë. Si prindër duhet t’i nxisim fëmijët në përpjekjet e tyre, duke i përgëzuar për arritjet. Për fat jo të mirë, ka shumë arsye pse një fëmijë nuk mund ta arrijë aq lehtë ndjesinë e kompetencës.

Të rriturit kanë prirje që ta masin aftësinë e një fëmije me standardet e të rriturve, por s’mund të presim nga një fëmijë të funksionojë në nivelin e kompetencave të një të rrituri. S’mund të pres nga ime bijë të lajë makinën njësoj si unë. Kur im bir ishte më i vogël, s’mund të prisja prej tij që ta rregullonte krevatin aq mirë sa unë. Duhet t’i marr në konsideratë kufizimet e tyre dhe t’i kuptoj.

Gjithashtu, s’mund të presim nga fëmijët tanë të jenë kompetentë pa i mësuar më parë. Sa shumë aftësi përfshihen në rregullimin e krevatit, larjes së makinës dhe kositjen e barit? Përsëri, ka prindër që u japin detyra fëmijëve pa u dhënë udhëzimet e nevojshme: «Je i rritur tani që të pastrosh dhomën tënde. Bëje dhe bëje mirë!»

Kur i drejtojmë fëmijët si ta bëjnë diçka, duhet t’u japim dhe lirinë nëse dështojnë. Mund të dështojnë, kështu që duhet t’i nxisim që ta përfundojnë detyrën duke i

ndihmuar. Lavdëroje për atë që ka arritur dhe motivoje që ta përfundojë detyrën deri në fund. «Sa mirë duket makina nga jashtë! Ke bërë punë të paqme. Por dhe nga brenda ka nevojë për ca pastrim. Si thua të më ndihmosh ta pastrojmë bashkë?»

Ka dhe ndikime të tjera jashtë familjes që luajnë rol në ndjesinë e kompetencës së fëmijës tënd. Ne jetojmë në një shoqëri konkurruese. Vazhdimisht ndiejmë keqardhje për veten, kur ballafaqohemi me të tjerët dhe aftësitë e tyre në punë, në shkollë, apo në sport. Për fat të keq, do të jetë patjetër dikush që do të jetë më i mirë se ne në gjërat që bëjmë. Shumë prej nesh bëhen kompetentë në disa fusha të jetës dhe kështu, kur matemi me të tjerë më superiorë, vetësiguria jonë shkatërrohet.

Të ushqesh ndjesinë e kompetencës të fëmijët është përpjekje që zgjat në kohë dhe që kërkon mendim dhe planifikim. Po ashtu kërkon edhe një përfshirje aktive në jetën e fëmijëve si modele pozitive që para se të gjejnë të metat, pohojnë nivele të reja rritjeje. Duhet t'i ndihmojmë të përqafojnë një vlerë të pikave të tyre të forta dhe të pranojnë kufizimet pa e dënuar veten. Një baba ka mundësi të krijojë një ambient pozitiv në shtëpi; të tillë që nxjerr në pah pikat e forta të fëmijëve të tij, i ushqen dhe i forcon, duke rrënjosur në brendësi të fëmijëve një ndjesi të gjallë për atë që janë dhe pse zotërojnë vlera të pafundme dinjiteti dhe denjësie.

Fëmijë të tillë do të jenë më pak të prirur për të kryer marrëdhënie seksuale para martesë, të krijojnë marrëdhënie jo të shëndetshme në kërkim të dashurisë dhe pranimit dhe të jenë më pak të prirur për t'u bërë rebelë dhe t'i nënshtrohen presionit të shoqërisë.

Po kështu, këta fëmijë do të jenë më shumë të prirur për të pasur standarde të forta seksuale. Më shumë të prirur të krijojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të jenë të suksesshëm në shkollë dhe më vonë në jetë.

Gjëra të tilla janë ëndrrat e një babai, por këto nuk ndodhin rastësisht dhe patjetër, as si rezultat i përpjekjes njerëzore. Këto gjëra ndodhin vetëm atëherë kur ne jemi të lidhur – përmes varësisë me lutje nga Fryma e Shenjtë – me Atin që na do, na pranon dhe na aftëson për të qenë të kujdesshëm me përpjekje të zellshme për t'u bërë ai baba që duam të jemi, ai baba që vetë Ati do që të jemi.

1. Pasi Xhoshi e lidhi historinë e vajzës dymbëdhjetë vjeçare të quajtur Korina, përmendi më pas edhe shumë gjëra negative, apo shkatërruese që kishte parë, ose njohur në baballarë të ndryshëm. Rishiheni listën në faqen , a identifikoheni me ndonjë prej këtyre sjelljeve, apo tendencave? Nëse po, kaloni pak kohë për të konsideruar se si këto sjellje mund të ndikojnë në ndjenjën tuaj të dashurisë dhe pranimit për fëmijën.
2. Pse është fëmija yt i veçantë në sytë e Zotit? Mendo për secilin fëmijë me emër dhe rreshto të paktën pesë arsye specifike pse secili është i veçantë për Zotin dhe për ty. Pastaj sajto mënyra për t'ua komunikuar këto gjëra fëmijëve të tu.

3. Mendo për secilin fëmijë dhe përgjigjiu këtyre pyetjeve. A e di fëmija yt që e do dhe e pranon. Si e di?
4. Mendo për dy gjëra që mund të bësh për secilin prej fëmijëve të tu këtë javë, që do t'u komunikojë atyre dashurinë dhe pranimin tënd, të bazuar në atë që është dhe jo në atë që bën. Kur dhe si do t'i zbatosh këto ide?

PASTËRTIA E ATIT

Kohë më parë mora një letër nga një baba i krishterë, që më kishte dëgjuar në një prej bisedave të mia. Ai thoshte që së bashku me gruan kishin bërë të pamundurën për t'u bërë prindër të mirë. Ishin anëtarë të një kishë dhe gjithmonë kishin qenë krenarë për fëmijët e tyre. Por, vazhdonte ai, kohët e fundit kishte zbuluar diçka lidhur me vajzën e madhe, që ua ktheu botën përmbyës.

Ky baba e përshkruante vajzën e vet adoleshente si një vajzë të bu kur, por që s'kishte pasur shumë djem që t'i vinin vërdallë deri më tani.

Ajo kishte filluar të shoqërohej me një nga djemtë e skuadrës së futbollit dhe ky baba sapo kishte mësuar se gati që në fillim të lidhjes së dy të rinjve ata kishin pasur marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin. Pastaj ajo kishte filluar t'i ndërronte të dashurit midis lojtarëve njëri pas tjetrit. «Dhe jo shumë kohë më parë, – tregonte babai i saj, – ajo kishte fjetur me të gjithë lojtarët e skuadrës.»

«Xhosh, – shkruante babai i torturuar, – ata e kishin kaluar dorë më dorë vogëlushen time si të kishte qenë “femra e skuadrës”».

Ky është ankthi i një babai. Asnjë baba s'do të donte të provonte një përvojë të tillë. Asnjë baba s'do të donte që fëmija i tij të lëndohej sekualisht, të kishte marrëdhënie seksuale para martesë dhe as të kryente tradhti seksuale në martesë.

Po çfarë duhet të bëjmë për të pakësuar një lloj ankthi të tillë që ndodh në jetët tona? Si mund t'i rrisim gjasat që bijtë dhe bijat tona të marrin vendime të drejta lidhur me çështjen seksuale? Çfarë duhet të bëjmë? Nga duhet t'i kthejmë sytë? Si mund të ndihmohemi?

Faktorët atërorë

Baballarët kanë mundësitë më të mëdha për të modeluar sjelljen dhe bindjet seksuale të fëmijët e tyre. Sipas kërkimeve të ndryshme, ndikimi i babait përqendrohet në tre pika:

Prania e atit: Xherri Adleri raporton: «Më shumë se gjysma e fëmijëve amerikanë të lindur midis viteve '0 dhe '0 mendohet ta kalojnë fëmijërinë e tyre vetëm me nënat. Një regjistrim i përgjithshëm zyrtar ka zbuluar se 3 milionë fëmijë amerikanë jetojnë vetëm me nënat e tyre, që në vitin dhe dyzet përqind e tyre nuk i

kanë parë baballarët e tyre të paktën për një vit. Mungesa ose prania e babait në shtëpi është një faktor përcaktues në veprimet dhe zakonet seksuale të një fëmije.» Siç është përmendur dhe në kapitullin e parë, kërkimet nga universiteti i Xhons Hopkins raportojnë se «vajza adoleshente që jetojnë në shtëpi pa baballarët e tyre kanë 0 përqind me shumë gjasa për të kryer marrëdhënie seksuale jashtë martesës në krahasim me ato që jetojnë me të dy prindërit.» Mungesa e baballarëve në familje ndikon edhe në jetën e djemve; hulumtuesi Robert Bilingam nga universiteti i Indianës sugjeron se djemtë që rriten pa praninë e babait «kanë gjasa ta marrin modelin e të qenit burrë më shumë prej stereotipeve kulturore nga televizioni, filmat, apo dashuritë jetëshkurtra».

Vëmendja e atit: në librin e tij *Babai: figurë dhe forcë*, Kristofer Anderseni citon një studim të bërë me 000 vajza që punojnë si striptiste në klubet e natës. Nuk lihet mënjanë faktori ekonomik që sigurisht ka ndikuar në zgjedhjen e tyre, por ndërkohë Anderseni shkruan: «Shumica e këtyre vajzave pranuan që përmes kësaj pune ndoshta kërkonin tërheqjen e vëmendjes mashkullore, e cila u kishte munguar gjatë gjithë fëmijërisë së tyre.» Anderseni bën lidhjen midis mungesës së vëmendjes atërore me sjelljen seksuale të këtyre vajzave.

Afërsia atërore. Dy studime të udhëhequra nga shërbesa e Xhosh Mekdauellit në vitin dhe , treguan fuqishëm se aktiviteti seksual jashtë martesës dhe imoraliteti ishte më pak i prirur të ndodhte midis adoleshentëve të të dyja gjinive, që kishin marrëdhënie të afërt me baballarët e tyre. Këto dy studime, ashtu si dhe shumë të tjera tregojnë se një marrëdhënie e shëndetshme me babanë është faktor vendimtar në angazhimin ose jo të rinjve në aktivitet seksual para martese.

Ndikimi i tretë madhor

Nëse njëri prej këtyre tri faktorëve atërorë mungon, atëherë vetë figura atërore do të jetë në rivalitet me faktorë të tjerë që ndikojnë pa diskutim në standardet seksuale të të rinjve.

Presioni shoqëror, grupi shoqëror patjetër që ka ndikimin e vet të frikshëm në formimin e një të riu. Kultura jonë e të rinjve komunikon mesazhin e vet në lidhje me vlerën personale, seksualitetin, identitetin dhe pranimin. Në librin e vet *Babai miqësor – çunak*, Frank Martini thekson një histori të dëgjuar nga një këshillues i shquar martesash:

Njëherë kishte këshilluar një vajzë gjashtëmbëdhjetë vjeçare dhe aty përshkruante takimin e saj të parë seksual kur ishte vetëm trembëdhjetë vjeç:

«Isha e lodhur së dëgjuari prej shokëve mbi seksin dhe doja ta provoja vetë çfarë ishte, fillon të tregojë ajo, – kështu që shfrytëzoja rastin në një festë me një prej djemve më të këndshëm që gjeta dhe e pyeta nëse donte ta bënte. Të dy shkuan në dhomën e gjumit dhe vetëm në pak çaste, kjo vajzë e re kishte humbur virgjërinë e vet. S'ishte siç e prisja, – i tha ajo këshilluesit, – por të paktën e mora vesh ç'ishte dhe kështu mund të flisja me shokët e mi».

Presioni i shoqërisë është përcakues madhor në aktivitetin seksual të një të riu dhe sidomos nëse këtij të riu i mungon një ose më shumë prej tre faktorëve atërorë të përmendur më sipër. Një studim me mijëra adole shentë tregoi se përqind e tyre do të kryenin marrëdhënie seksuale për të mos u ndjerë jashtë shoqërisë, për t'u ndjerë me përvojë në këtë fushë para të tjerëve. Në shumë komunitete të fëmijëve tanë, në shkolla, grupe shoqërore, presioni i të përfshirit në garën seksuale mund të bëhet i frikshëm.

Mesazhet e medias. Një studim për të rinjtë në që sfidoi me titullin e fushatës «PSE TË PRES?» tregoi se shoqëria është ndikuesi numër një te fëmijët tanë lidhur me sjelljen seksuale. Po ku ndikon shoqëria? Shumica e të rinjve në shoqëri kanë mësuar për seksin jo prej prindërve, as në kishë, apo në shkollë, por prej një rryme të vazhdueshme nga televizioni, filmat, muzika rrok dhe revistat periodike që janë më shumë se kurrë të cekëta në profesionalizëm.

1. *Televizioni*. Media është ndoshta përcaktuesi kryesor në seksualitetin e të rinjve të krishterë. Si e jep media gjithë këtë ndikim mbi të rinjtë; konsideroni këto fakte; mesatarisht parashkollorët kalojnë më shumë kohë para televizorit se një student në klasë, duke studiuar për diplomë. Në një studim zbulohet që një parashkollor sheh televizor orë në javë, ndërkohë që në shkollë shpenzon njëzet e dy orë. Gjumi është aktiviteti i vetëm që udhëheq kohën e tyre. Kur bëhen vjeç ata do të kalojnë më shumë kohë para televizorit në krahasim me gjithçka tjetër, madje dhe shkollës. Një

studim tjetër llogarit që deri në diplomim, mesatarja e të rinjve në shkollën e mesme kanë kaluar mijë orë duke parë televizor, gjë që e kalon dyfish kohën që ata kanë kaluar gjatë gjithë vjetëve në shkollë.

2. *Muzika.* Nga mosha - vjeç, fëmijët dëgjojnë mesatarisht .00 orë muzikë rrok, ndërsa shumica e përgjithshme e orëve që ata kalojnë gjatë vjetëve në shkollë është vetëm 00 orë më shumë se koha duke dëgjuar muzikë rrok.

Adoleshentët ndikohen shumë nga media. Ata kanë më pak bashkë- veprim me bashkëmoshatarët në realitet se asnjëherë tjetër. Ndaj shokët dhe roli model i prezantuar në media kanë një ndikim shumë të madh.

3. *Filmat dhe videot.* Shumica e të rinjve e kanë zhvilluar konceptin e tyre mbi seksualitetin, duke u bazuar më së shumti mbi trillimin me- diatik pa kuptuar që janë zënë në kurth me idealizimin e dashurisë së lirë dhe seksit të rastësishëm. Nëse janë të pazotë të ndreqin bindjet e tyre, pa dyshim që do ta paguajnë shtrenjtë. Një grup e re tregon për këtë gjë:

«Ajo që filmat, apo telenovelat nuk na tregojnë është rrënimi dhe zemrat e thyera që vijnë si rezultat i tradhtive dhe marrëdhënieve seksuale para martesës. Nuk dua të formoj ndonjë pikëpamje mbi rrethanat e përfshirjes së gabuar seksuale. Por pa dyshim, gjëja më e dhimbshme dhe më e rëndë që kam kaluar... më shumë se operacioni më i vështirë, testeve të kancerit, një familjeje të ndarë, apo qoftë dhe refuzimeve të panumërta për punë, është të kesh marrëdhënie seksuale me një burrë të martuar».

Këto fjalë më tronditën, më tmerruan, por më bënë t'i ndihmoj fëmijët e mi t'i llogarisin që më parë efektet e shoqërisë dhe medias mbi jetën e tyre. Këto fjalë më bënë të vendos për t'u bërë dhe për të mbetur i tillë, jo thjesht ndikimi i tretë madhor, por ndikimi më i madh, më i afërt në formimin e pikëpamjes së fëmijëve të mi mbi seksualitetin. Dua të jem ai lloj babai, fëmijët e të cilëve njohin pikëpamjen e Zotit mbi seksin, që fëmijët të kenë një qëndrim të shëndetshëm dhe të dobishëm mbi seksualitetin. Dua të jem babai që flet me fëmijët e tij mbi seksin dhe pastërtinë, që i mbërthen pranë vetes përballë presioneve dhe tundimeve që do të përballin pa diskutim si adoleshentë dhe të rinj. Dua që të jem baba me fat që fëmijët e tij të ruhen seksualisht deri në martesë dhe të qëndrojnë besnikë para grave dhe burrave të tyre. Dua të jem ai lloj babai që Ati im është.

Modeli i pastërtisë

Në gjithë Fjalën e tij Zoti urdhëron pastërti për njerëzit e tij. Zoti ka folur përmes ligjit dhe e ka bërë të qartë standardin e tij, ndotja seksuale (gjë që është çdo aktivitet seksual jashtë martesës) është e gabuar:

*Ji i përmbajtur ndaj imoralitetit seksual
Veprat 15.29*

*Arratisiu imoralitetit seksual
1 Korintasve 6.18*

*S'duhet të kryejmë imoralitet seksual
1 Korintasve 10.8*

*Por midis jush të mos ketë as edhe një gjurmë imoraliteti seksual, sepse kjo është e pahijshme për njerëzit e shenjtë të Zotit.
Efesianëve 5.3*

*Prandaj bëj të vdesë gjithçka që i përket natyrës sate mishtore: imoralitetin seksual dhe ndotësinë...
Kolosianëve 3.5*

*Është vullneti i Zotit, që ju duhet t'i largoheni imoralitetit seksual
1 Selanikasve 4:3*

Është e vështirë të humbësh konceptin e Zotit mbi pastërtinë. Është fakt që një koncept i tillë nuk zbulon vetëm urdhërimet e Zotit, por dhe vlerat e tij. Zoti e vlerëson pastërtinë. Ai është përpjekur gjithmonë t'jua komunikojë këtë vlerë njerëzve të tij; ai kërkoi përdorimin e arit të pastër për ndërtimin e Tendës së shenjtë; porositi temjan të pastër për adhurimin; kërkoi kafshë të pastra për sakrificim; urdhëron për zemra të pastra (Mat :) besim të pastër (Jakobi 1 :) dhe lidhje të pastra (1 Tim :2). Por më shumë se kaq, kjo këshillë, ky rregull zbulon diçka mbi vetë Zotin; se vetë modeli At është i pastër «Gjithkush që ka këtë shpresë (të lavdishme) në Të mbahet i pastër ashtu si ai (Zoti) është i pastër» (1 Gjoni 3:3). Tomas Trevethan e përshkruan pastërtinë e Zotit të shpre-hur qartë:

«Zoti

i vërtetë është i dallueshëm, i veçuar nga gjithçka e keqe. Përsosmëria e tij morale është absolute. Karakteri i tij i shprehur në vullnetin e tij formon standardin absolut të përsosmërisë morale. Zoti është i shenjtë, pika absolute e referimit për

gjithë ekzistencën dhe kjo është e mirë. Nga ana tjetër ai bën kontrast me krijesën e tij. Zemra e tij është qendra kulmore e bardhësisë për pastërtinë absolute».

Ngaqë Zoti është i pastër, ndotja seksuale është fyerje ndaj tij. Mbreti David, që mëkatoi me Bathshebën, më vonë u pendua, iu rrëfye Zotit. «Kundër teje, vetëm kundër teje, kam mëkatuar dhe kam bërë çfarë është e keqe në sytë e tu». (Ps 1:) A po e injoronte Davidi faktin që mëkati i tij kishte ndikuar te njerëzit e tjerë, me vdekjen e burrit të Bathshebës, Uriahut dhe të djalit të tij të lindur prej saj? Jo, por ai po pranonte që përmes mëkatit të tij me Bathshebën ai kishte mëkatuar ndaj ligjvënësit. Veprimi i tij ishte i gabuar, sepse kishte fyer pastërtinë e Zotit.

Me fjalë të tjera modeli i Atit komunikon në kontrast me kulturën, presionin shoqëror dhe mesazhit të medias se pastërtia është e mirë. Modeli i Atit urdhëron pastërtinë, sepse pikërisht kjo është diçka që ai e vlerëson dhe e vlerëson sepse vetë Ai është i pastër.

Ky lloj Ati dua të bëhem që fëmijët e mi ta kuptojnë, që pastërtia është e mirë dhe aspak diçka për të cilën t'ju vijë turp. Dua që vetë ata

ta refuzojnë magjepsjen e imoralitetit që vetë kultura, shoqëria dhe media i bëjnë reklamë. Dua që ata të dinë se e vlerësoj patërtinë si Ati, të cilin i shërbej dhe kërkoj t'i ngjaj. Dua që ata të shohin të mirat e pastërtisë dhe një standard të përpjeshëm mbi pastërtinë seksuale me anë të jetës sime.

Patjetër që është më e lehtë ta thuash se ta bësh në realitet, por në të kundërt nuk do ta konsideroja si prioritet. Kërkon lutje me besim nëpërmjet Frymës së Shenjtë, që mund të punojë në mua dhe përmes përpjekjeve të mia ndërsa përdor disa mënyra si këto.

Duke treguar vëmendje dhe dashuri

Njëherë kam bërë një konferencë njëjavore në një prej kishave ungjillore më të mëdha dhe të suksesshme në ShBA. Kam pasur takime këshillimi me dyzet e dy nxënës të viteve të para dhe të fundit të shkollës së mesme. Pyetja e tyre e parë ishte: «Xhosh, çfarë mund të bëj për babanë tim?» Kur i pyeta se ku e kishin fjalën, më thanë: «Sepse asnjëherë nuk gjen kohë për mua» ose «Asnjëherë nuk kam qenë diku me të», «Asnjëherë nuk kemi biseduar bashkë», ose «Asnjëherë nuk ka bërë diçka bashkë me mua». Dhe kështu i pyeta të dyzet e dy fëmijët: «A mund t'ua tregoni këto baballarëve tuaj?» Dhe vetëm njëri prej tyre tha po.

Këta të rinj, ashtu si shumë të tjerë sot, ishin të uritur për vëmendje dhe dashuri. Kjo lloj dashurie e etur do të ndikonte në të dyja palët, qoftë prindër, apo fëmijë, duke krijuar një rreth vicioz të përhershëm të prindërit e etur për dashuri që rrisin fëmijë, që janë më të etur për dashuri. Rezultati do të ishte rrënues. Fëmija juaj ka nevojë për vëmendjen tuaj. Ka raste kur i marr vetë fëmijët nga shkolla dhe shkoj të ha

drekë me ta. Një kohë vetëm prej gjysmë ore duke shëtitur në lagje, ose për një udhëtim të shkurtër për të blerë akullore mund t'ju japë mundësi që t'u kushtoni vëmendje fëmijëve tuaj, duke u komunikuar atyre që i konsideroni të rëndësishëm. Miku im, Norman Uejkfild, tregon për njëren prej përvojave të tij kur fëmijët e tij ishin ende të vegjël:

Njëherë kur po hanim drekë një të diel pas shërbesës së kishës u thashë fëmijëve: «Do t'ju jap secilit nga një dhuratë sot» Sytë e tyre ndritën nga padurimi dhe kureshtja. «Do ju jap secilit tridhjetë minuta. Do të bëj çfarë të doni ju gjatë gjithë kësaj kohe». Përgjigjja e tyre ishte një klithmë gëzimi më e fortë se sikur të ishin duke çmbështjellë një dhuratë të madhe.

Pyeta në fillim Emin çfarë donte të bënte. «Dua të bëj një shëtitje me ty, babi» Kështu shëtitëm bashkë dorë për dorë nëpër lagje dhe hëgrëm në fund një akullore. Kur u kthyem në shtëpi Joeli më tha se donte të bënte mundje në lëndinën përballë shtëpisë, kështu që u kacafytëm bashkë për tridhjetë minuta.

Pastaj pyeta Xhillin, që do të shkonte së shpejti në kopsht se çfarë të bëja për të: «Dua të ulem në prehrin tënd në verandë dhe të më lexosh një libër. Dhe kështu bëra për të.

Atë pasdite kuptova në të vërtetë sa domethënëse ishte dhurata e kohës për fëmijët tanë. Kur jepet në mënyrë të etshme dhe me bollëk, ka rezultat.

Fëmijët tuaj, pavarësisht nga mosha, kanë nevojë për dashuri. Besoj vërtet se përqaftimet midis baballarëve dhe fëmijëve të tyre adoleshentë mund të bëjnë më shumë se çdo faktor tjetër i vetëm për të nxitur zhvillimin e pastërtisë së tyre seksuale. Ju s'mund t'i përqaftoni mjaftueshëm fëmijët tuaj, thjesht nuk mundeni. S'ka rëndësi sa të mëdhenj në moshë, apo në trup janë; askush nuk ngopet nga nevoja për dashuri. Ka një fuqi madhështore vetëm në një gjë kaq të thjeshtë si përqaftimi, një shkelje syri, apo një pëshpëritje «të dua».

Të jesh i hapur për temat e seksualitetit

Procesi i komunikimit tuaj si baballarë përballë fëmijëve tuaj është thelbësor, nëse ata duan të mësojnë prej jush në udhëtimin e gjatë të sjelljes dhe qëndrimit të tyre për seksin.

Të dy prindërit kanë një mundësi të shkëlqyer për t'i udhëzuar fëmijët mbi plotësinë personale. Nëse krijohen dhe mbahen kanale të hapur dhe pozitive komunikimi, pasuria e mbrojtjes suaj do t'ju japë ngjyra marrëdhënies. Biri juaj do të kuptojë se çfarë do të thotë të jesh burrë dhe si ta trajtosh një femër. Ai do të ndihet rehat me veten, sepse ka pasur një prej shembujve më të mirë. Vajza juaj do

të fitojë vetërespektin dhe do të kënaqet me feminitetin e saj, ndërsa ka qenë duke dëgjuar prej jush si baba kënaqësinë dhe admirimin në të. Dhe ndërsa rritet, ajo do të ketë një model me të cilin të masë meshkujt e tjerë, që do të vijnë në jetën e saj. Do të jetë më pak e dhënë ndaj shpërthimeve mashkullore për shkak të autoritetit tuaj në jetën e saj dhe dashuria do të ketë krijuar tashmë një mbrojtje. Ajo do të dijë si të lidhet me ata të seksit të kundërt.

Aftësia juaj për të folur mbi aspektin seksual në jetë është element jetësor në marrëdhëniet fëmijë-prindër. Mund të mësojmë një mësim, duke diskutuar mbi pastërtinë personale dhe moralitetin seksual duke u bazuar në Bibël. Nga Proverbat 3 deri në 5, fëmijët udhëzohen të dëgjojnë prindërit e tyre mbi çështjen seksuale. Ndërsa prindërit nuk janë këshilluar, apo urdhëruar ndonjëherë të flasin mbi seksin. Sepse është e mirëqenë që prindërit duhet ta bëjnë një gjë të tillë. A jeni bindur për këtë pjesë kaq të rëndësishme të jetës së fëmijëve tuaj?

Ka disa burime shumë të mira dhe ndihmuese për ne si prindër për këtë fushë. Një libër që do ta rekomandoja me gjithë zemër është *Si të flasësh me fëmijët e tu për dashurinë, seksualitetin dhe takimet e dashurisë* nga Berri dhe Karol St. Kler, të cilët japin udhëzues hap pas hapi për të dy prindërit për t'i diskutuar tema të tilla në nivelin e fëmijëve të tyre të moshës. Një dokumentim tjetër është një prej librave dhuratë të setit tresh që kam redaktuar për adoleshentët: *Takimet e dashurisë; Të zgjedhësh (dhe të jesh) partnerin më të mirë, Seksualiteti, të dëshirosh më të mirën dhe Dashuria*: ta bësh të përjetshme, të shkruara prej auto rit veteran për të rinjtë, Berri St Kler dhe Bill Xhons. Një dokumentim tjetër është një videokasetë. *Të flasim për dashurinë dhe seksualitetin*, e cila shoqërohet me një libër pasi shikohet prej të dyja palëve së bashku, fëmijë dhe prindër. Libri *Me dashuri, babi*, është një përmbledhje letrash të drejtuara birit dhe bijës sime sesi ta përballin presionin shoqëror dhe tundimin mbi seksin.

Rëndësia e komunikimit në fushën e seksualitetit ngre një çështje me të cilat baballarët herët a vonë do të përballen. Nëse ne nuk jemi të sigurtë, ose nuk ndihemi rehat me këtë përvojë tonën, kemi për t'ua transmetuar edhe fëmijëve tanë. Nëse një fëmijë mashkull rritet në një ambient, ku i ulen vlerat gruas, ndoshta ai ka për t'u komunikuar në të ardhmen vajzave të veta qëndrime dhe ndjenja që do të ndikonin tek ato karshi meshkujve të tjerë. Nëse jemi mësuar që meshkujt janë të fortë, të heshtur, të ashpër dhe të pandjeshëm, bijtë tuaj mund të fitojnë disa nga këto tendenca vetëm duke ju parë ju.

Por kujtoni që s' duhet të biem në kurthin e modeleve negative dhe shkatërruese të komunikimit. Nëpërmjet Frymës së Shenjtë ne mund të krijojmë qëndrime dhe ndjenja të reja, të lira nga të mëparshmet, që do t'u komunikojnë fëmijëve tanë një mënyrë të gëzueshme dhe të dashur të jetës.

Të modelosh standarde të përshpirtshme për pastërtinë

Do të jetë më e lehtë për fëmijët tuaj të krijojnë standarde të përshpirtshme të pastërtisë pasi t'i kenë parë këto më parë tek ju. Një baba që e trajton gjithmonë gruan e tij me butësi, duke pohuar feminitetin e saj, duke e treguar qartë se e ka partnere të jetës, formon kështu një themel të qëndrueshëm emocional për fëmijët e vet. Një baba që e mban veten larg nga vlerat e botës mbi seksin – në mënyrën se si vepron, çfarë sheh dhe dëgjon – modelon kështu pastërtinë e përshpirtshme për fëmijët e vet.

Një prej mënyrave më të suksesshme për të ndërtuar standarde të pastërtisë te fëmijët tanë është t'i lëmë ata të shohin si duket një imazh i shëndetshëm i seksit. Shumë prindër janë të ndrojtur ose të rezervuar për seksin, duke u dhënë kështu fëmijëve idenë se seksi edhe atëherë kur bëhet fjalë për brenda martesës është i ulët, ose të paktën, «diçka për të cilën nuk flitet», por duke i lënë fëmijët të shohin që seksi është pjesë e marrëdhënies së pastër dhe të bukur që shijon me gruan tënde, kjo inkurajon qëndrime të drejta mbi seksin tamam sipas qëllimit të Zotit. Në librin *Si të bëhesh hero për fëmijët e tu*, Dik Dei dhe unë treguam këtë histori:

Diku kujton kohën kur Sharlota u kthye nga një konferencë për gratë në Lindjen e Mesme në kolegjin Uiton. Ajo kishte qenë e larguar për gati një javë dhe po vinte në San Diego me fluturimin e orës gjashtë. Ndërsa ai po përgatitej të udhëtonte nga Xhulian në San Diego – rreth njëqind kilometra – u tha Timit dhe Xhonatanit, atëherë në moshën e hershme adoleshente: «Djema, e keni problem ta kaloni natën vetëm sonte? E keni vëllanë tjetër shumë afër që këtë dhe nëse ka ndonjë problem veç bëjini një telefonatë. Po shkoj të marr mamin në aeroport dhe do të flemë në hotel sonte në San Diego».

Timi pa nga i ati dhe nënqeshi, pasi e goditi lehtë në brinjë me sytë që i ndrisnin i tha: «Ashtu vazhdo, babi, ashtu vazhdo!»

Bijtë e Dikut panë në marrëdhënien e prindërve të tyre një imazh seksual që forconte pastërtinë dhe bukurinë e seksit ashtu si Zoti e kishte krijuar brenda martesës.

Të mësosh standardet e përsëpirtshme të pastërtisë

Kur vajza ime, Kelli, mbushi vjeç, bëra diçka që mezi e prisja prej kohësh. E çova në një seri takimesh. E pyeta për të dalë bashkë dhe pasi u veshja dola nga shtëpia duke pretenduar sikur po dilja me të. I hapa dhe mbylla derën e makinës, e çova në një restorant të mirë, i tërhoqa karrigen dhe fillova vetë bisedën mbi interesat e saj. Pas darkës shkuam bashkë në një vend argëtimi që ajo e zgjodhi vetë.

Në fund të çdo takimi, kalova pak çaste për t'i shpjeguar Kellit, që kjo është mënyra si një mashkull duhej ta trajtonte atë nëse në të vërtetë e donte dhe e respektonte. Që prej asaj kohe, e kam bërë këtë dhe me dy vajzat e tjera. Gruaja e bëri këtë me djalin tone, Shaunin; e mësova ndërkohë djalin se çfarë të bënte, si ta trajtonte dhe ta nderonte gjatë gjithë mbrëmjes t'ëmën.

Të tilla takime përbëjnë vetëm një lloj teknike të asaj që unë vetë kam përdorur për t'u mësuar standardet e përsëpirtshme fëmijëve të mi. Kam shfrytëzuar edhe mundësi të prezantuara në televizion, filma, punë, apo qoftë dhe në raste të ndryshme me miqtë, në dasma për të diskutuar mbi standardet e Perëndisë mbi pastërtinë seksuale. Madje kam mbajtur mbishkrime mbi përpjekjet e mia, duke përdorur një lloj fjale -gërmëshe të vizatuar me bojë në mur për t'u shpjeguar fëmijëve pse ajo fjalë, që degradoi diçka që Zoti donte të ishte e bukur, është kaq e papëlqyeshme, duke marrë shtysë prej kësaj për t'u mësuar pastërtinë dhe shenjtërinë e seksit në kontekstin e një marrëdhënieje martesore.

Të ndash të mirat e pastërtisë

Një prej mënyrave më të forta për të nxitur zhvillimin e standardeve personale të pastërtisë te fëmijët e tu, që do të pasqyrojë pastërtinë e vetë Zotit tek ata, është të ndash në çdo rast të mirat e pastërtisë (dhe pasojat e imoralitetit).

Unë përpiqem me çdo rast që të më jepet, t'u bëj të njohur fëmijëve të mi që standardet e pastërtisë janë shtegu më i sigurt i kënaqësisë dhe plotësimit dhe se imoraliteti është shtegu më i sigurt për t'u ndjerë fajtor, i zhgënjyer dhe bosh. U kujtoj shpesh që standardet e Zotit për pastërtinë i mbrojnë ata nga shtatzënitë e padëshiruara, nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, duke siguruar dhe paqen mendore. Përpiqem t'ua ngulis që pastërtia seksuale i mbron nga pasiguria sek suale duke siguruar një ambient besimi midis të dy partnerëve, burrë dhe grua. Sesi pastërtia para dhe gjatë martesës siguron një intimitet të

vërtetë midis gruas dhe burrit, duke i mbrojtur ata nga pasojat e imoralitetit: dyshimi, zhgënjimi, stresi, boshllëku, hidhërimi dhe shumë emocione të tjera shkatërruese. Jo shumë kohë më parë, Keji më tha gjakftohtë:

«Babi, faleminderit që më do!»

«Ç'do të thuash me këtë?» – e pyeta.

«Që më ke treguar gjithmonë të vërtetën», – tha ajo pa hezituar. – «Më ke treguar për seksualitetin dhe pasojat dhe njoh shume shokë që marrin vendime të gabuara, duke mos i kuptuar fare pasojat.» Ajo iku duke thënë se do të donte që shokët e saj të kishin një baba që u flet hapur mbi të mirat e pastërtisë dhe pasojat e saj.

Si baballarë, ju dhe unë kemi një punë të shenjtë dhe shumë të rëndësishme për të bërë, që t'u ushqejmë fëmijëve tanë ndërgjegjësimin, respektin dhe reflektimin e standardeve të Perëndisë mbi pastërtinë. Është një punë që fillon së pari me punën e Frymës së Shenjtë në jetët tona, që u jep fuqi përpjekjeve tona për t'u treguar vëmendje dhe dashuri fëmijëve, për t'u treguar të sinqertë me ta lidhur me temën e seksit, për të krijuar tek ata standarde të përsëritshme të pastërtisë, për t'ua mësuar vazhdimisht këto standarde dhe duke u treguar të mirat e pastërtisë çdo rast. Ndërsa bëjmë kështu, me ndihmën e Zotit, fëmijët tanë do të kenë mundësi t'i rezistojnë presionit prej shokëve, shoqërisë, hormoneve të tyre për të mos qenë aktivë seksualisht para martesës. Ata do të bëhen më të përgatitur për të zhvilluar dhe pasur një pikëpamje të drejtë dhe të përsëritshme mbi seksin, do të jenë më pak të prirur të ndeshen me dhimbjen dhe tragjedinë, që sjellin vendime të gabuara në fushën e seksualitetit. Dhe kështu do të jenë të përgatitur më mirë për më vonë, për t'u qëndruar besnikë bashkëshortëve të tyre në martesë.

Dhe në si prindër do të kemi një lidhje të tillë me fëmijët tanë, që do të na bëjë të jemi ata lloj baballarësh që kemi dashur të jemi, ashtu si na do Ati ynë qiellor.

1. Çfarë lloj ndikimi kanë bashkëmoshatarët në qëndrimin e fëmijëve të tu ndaj seksit? Po media? Po Ju? Jini specifikë.
2. Rishihni pesë veprimet për të ushqyer standarde të përsëritshme të pastërtisë, që përmenden në këtë kapitull. Vendos një X në secilën prej vijave, duke treguar vlerësimin tuaj mbi suksesin e fundit në këto pesë fusha:

U jap vëmendje dhe dashuri fëmijëve të mi

gjithmonë ndonjëherë asnjëherë

Tregohem i hapur me fëmijët mbi temën e seksit

gjithmonë ndonjëherë asnjëherë

Krijoj standarde të përsëritshme të pastërtisë

gjithmonë ndonjëherë asnjëherë

Mësoj standarde të përshpirtshme të pastërtisë

gjithmonë ndonjëherë asnjëherë

Tregoj të mirat e pastërtisë dhe pasojat e papastërtisë

gjithmonë ndonjëherë asnjëherë

3. Identifikoni dy prej fushave të mësipërme, ku doni të përmirësoheni dhe çfarë do të bëni konkretisht. Ka ide që mund t'i merrni nga sugjerimet dhe ilustrimet në këtë kapitull? Nëse po, nënvizojini këto ide dhe bëni plane për t'i përdorur sa më parë.

* Organizoni të paktën «dy takime me babin» me secilin prej fëmijëve në gjashtë javët e ardhshme. Planifikoni mbi diçka që duan ata dhe përkushtojuni me gjithë kohën dhe vëmendjen tuaj gjatë takimit. Bëjeni sa më zbavitëse për të dy.

Çfarë mendonni të bëni në takimin e parë?

Kur po e planifikoni?

Po në takimin e dytë?

Kur po e planifikoni?

E VËRTETA E ATIT

Kur vajza ime, Kelli, ishte në klasën e pestë, shokët e klasës së saj goditën fort një objekt të tavolinës së mësueses, ndërkohë që ajo ishte jashtë. Këta fëmijë thjesht donin të luanin, por objekti u thye dhe ata e kthyen menjëherë në vendin e mëparshëm.

Kur mësuesja u kthye dhe dalloj çfarë ishte bërë, pyeti një prej shokëve të Kellit që t'i tregonte ç'ndodhi. Vajza, e nënshtruar ndaj presionit të grupit, gënjeu. Pastaj mësuesja ishte kthyer nga Kelli, e cila iu përgjigj me ndershmëri dhe drejtësi pavarësisht presionit të shokëve.

Ditën tjetër e çova Kellin në një prej restoranteve tona më të preferuara dhe i tregova sa krenar isha për të që kishte bërë gjënë e drejtë, pavarësisht presionit, apo dhe lëndimit që mund të merrte prej shokëve të klasës.

Jam kënaqur dhe ndjerë krenar shumë herë nga fëmijët e mi për shkak të ndershmërisë dhe drejtësisë që kanë treguar dhe sidomos kur kam kuptuar sa të rralla janë këto veçori te njerëzit. Një anketim i kohëve të fundit ka treguar se mashtrimi është një gjë shumë e përhapur midis nxënësve të shkollave të mesme. Një anketim midis nxënësve të viteve të para dhe të fundit në shkollën e mesme me një mesatare nëntë dhe dhjetë, 0% e tyre pranuan që kishin kopjuar nga detyrat e shokëve, ose testi në provim. Një anketim tjetër në shkollë vendi me adoleshentë dhe -vjeçarë tregon se afërsisht gjysma (%) besojnë se «të gënjeshtë është diçka e nevojshme». Dhe vjedhjet në dyqan (apo të tjera forma vjedhjeje) midis adoleshentëve janë diçka e modës në disa shkolla dhe komunitete.

Këto lloj qëndrimesh dhe sjelljesh nuk mundet as të kufizohen si «probleme fëmijërore», veprime të tilla trondisin fëmijët e krishterë, ata që shkojnë në kishë dhe vijnë nga familje të krishtera. Studimi i dalë nga fushata «Si të dallosh të mirën nga e keqja» zbuloi në nivel shqetësues pandershmërinë midis të rinjve të krishterë. Anketimi midis 3 të rinjve adoleshentë në kishat e krishtera ungjillore tregoi se dy nga çdo tre (%) thanë se kishin gënjer prindërit, mësuesit, ose dhe ndonjë person tjetër të moshuar pikërisht vetëm tre muajt e fundit. Vetëm shumë pak, gjashtë në dhjetë (%) thanë se kishin gënjer ndonjë shok gjatë kësaj kohe. Më shumë se një në tre (3%) pranuan se kishin mashtruar në provim, duke kopjuar gjatë periudhës 3-mujore dhe gati një në gjashtë (%) treguan se kishin vjedhur para ose diçka tjetër në shtëpi.

Kërkimi tregon se të rinjtë tanë e shohin mashtrimin si rrugën «më të lehtë» për të ecur para. E shohin pandershmërinë si diçka që do t'u bëjë përshtypje shokëve dhe një mënyrë miratimi para prindërve.

Ata as që janë të bindur se kjo është e gabuar, duke parë zakonisht më parë pasojat negative të mashtrimit se rezultatet pozitive të ndershmërisë.

Por unë dua që fëmijët e mi të njohin diçka më shumë. Dua që djali dhe vajzat e mia të bëhen njerëz të ndershëm. S'dua të bëhen mashtrues, të gënjejnë, qoftë mua, apo ndonjë tjetër. S'dua që ata të marrin gjëra që s'u përkasin, qoftë nëse është një cd muzikore, apo kohën e punëtorit në dyqan. Dua që ata të thonë të vërtetën, që të bëjnë jetë të nderhme, pa trazira, duke punuar në punët e tyre dhe në një mënyrë të tillë, që çdo ditë do të fitonin respektin e të tjerëve. Dua të jem ai lloj babai që mëson, formon dhe modelon këtë lloj jete.

Dua të bëhem i tillë, që fëmijët të më mbajnë mend për ndershmërinë dhe drejtësinë. Dua të më respektojnë të bëhem babai në ngjasim të Atit qiellor.

Imazhi i Atit

Mijëra vjet më parë Zoti iu shfaq Moisiut në një mal të vetmuar në Sinai dhe i dha dhjetë urdhërimet:

*Mos vidh! Mos jep dëshmi të falsifikuar për komshiun tënd
Ligji i Përtërirë 20:15-16*

Në rrugën e zbulesës para Moisiut, Zoti ia përsëriti duke ia plotësuar këto urdhërime morale:

Mos vidh

Mos gënje

Mos mashtroni njëri-tjetrin

Mos bëni be të rreme

Mos e mashtro, apo robëro komshiun tënd (të afërmin)

Levitiku 19:11-13

Me anë të urdhërimeve Zoti u përpoq t'ua bënte njerëzve të tij sa më të qartë se mashtrimi, gënjeshtria dhe vjedhja ishin të gabuara. Por këto urdhërime zbulojnë dhe një parim të çmuar të Zotit; ndershmërinë, cilësinë e të qenit i singertë, transparent dhe i besueshëm. Zoti e çmon ndershmërinë: «Zoti i urren buzët gënjeshtare». Solomoni shkroi: «Ai kënaqet me njerëzit që janë të singertë.» (Proverbat :)

Ndershmëria nuk ka vlerë të brendshme; është në vetvete një virtut që rrjedh nga natyra dhe karakteri i Zotit. A e mbani mend atë që tregova në fillim të këtij kapitulli kur e nxora vajzën për të ngrënë bashkë për ta përgëzuar për ndershmërinë e saj në një situatë të vështirë? Doja të arrija më shumë se kaq.

– Pasi i kisha treguar sa krenar ndihesha për veprimin e saj, – i thashë, – zemër, pse mendon se të gënjeshtër është gabim?

- Sepse e thuhet në Bibël, – pohoi ajo e sigurt.
- Por, – këmbëngula unë, – pse mendon se në Bibël konsiderohet kështu?
- Sepse Zoti e ka urdhëruar, – u përgjigj ajo.
- Po pse e urdhëroi Zoti?

Ajo më hodhi një shikim sikur t'ia kisha bërë pyetjen në një gjuhë të panjohur. Në fund tha: – S'e di.

Mora dorën e saj në timen dhe e pashë në sy. Doja të isha i sigurt 2 që ajo do ta mbante mend atë që do t'i thosha tani. – Sepse Zoti është i vërtetë, Kelli. E vërteta vjen nga natyra e tij dhe çfarëdolloj gjëje që është në kundërshtim me natyrën e tij është mëkat».

Ndershmëria është e drejtë, (dhe pandershmëria e gabuar) sepse Zoti është i vërtetë. E vërteta s'është diçka që Zoti bën, apo e ka, por është pjesë e asaj që është ai; në shkretëtirën e Horabit, Moisiu këndoi: «Ai është shkëmbi, krijimi i tij është i përsosur..., një Zot i vërtetë dhe pa ligësi, thjesht i drejtë ai është». (Ligji i përtërirë 32:4)

Ai është «Zoti që nuk gënjen» (Tit 1:2). Kur Zoti jep një premtim, – thotë Pali, – duhet të besoni në të, sepse është e pamundur për Zotin që të gënjejë» (Hebr. 6:18). Edhe pse ndershmëria nuk vlerësohet ashtu si duhet sot në botë, ashtu si Juvenali ka thënë, është standard i përgjeshëm, universal, i së vërtetës që nuk do të luhatet, apo të ndryshojë: «Zoti duhet të jetë i vërtetë,» – thuhet në Bibël, «megjithëse vërtetohet se njeriu është gënjeshtar.» (Rom 3:4)

Ngaqë Zoti është i vërtetë, gënjeshtria është fyese për natyrën e tij, ngaqë Zoti është i vërtetë, mashtrimi njësoj e fyen atë. Po ashtu edhe vjedhja. Zoti është i vërtetë dhe nuk ka asgjë të rreme në të. Është natyra e tij që përkufizon ndershmërinë si morale dhe pandershmërinë si gabim dhe vjedhjen si ligësi.

Dua që fëmijët e mi të kuptojnë se Zoti është i vërtetë dhe çfarëdo që të ndodhë, ai është i mirë dhe gjithçka që s'është si ai është e keqe. Dua që vetë si baba të reflektoj shëmbëllimin e së vërtetës në Zotin dhe dua që edhe fëmijët e mi ta pasqyrojnë këtë në ndershmërinë dhe drejtësinë e tyre. Dua që ata të kuptojnë se ndershmëria është veprimi më i mençur, sepse e kënaq Zotin, sepse pasqyron natyrën e tij dhe tregon shëmbëllimin e tij te të tjerët.

E përsëris, çelësi për të arritur gjithë këtë është lidhja me Atin, për të cilën kam qenë duke folur deri tani. Dhe kjo më kërkon mua të jem i bindur dhe i përkushtuar përmes lutjes personale çdo ditë. Pastaj mund të filloj të bëj lidhjen me Atin me fëmijët e mi, ndërsa po u tregoj shëmbëllimin e Tij në mënyra konkrete si:

Duke modeluar një jetë të ndershme

Zoti i dha Izraelit një model për t'u mësuar të vërtetën fëmijëve tanë edhe sot, kur ai thotë:

Dëgjo, o Izrael, Zoti, Perëndia ynë është një i vetëm. Ti do ta duash Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me gjithë forcën tënde. Dhe këto fjalë që sot po t'i urdhëroj, do të mbeten në zemrën tënde; do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh. (Ligji i përtërirë 6:4-7)

Zoti e tregon qartë se, nëse duam t'ua kalojmë vlerat biblike mbi ndershmërinë fëmijëve tanë, duhet më së pari t'i modelojmë në jetët tona. Fjala e tij duhet të qëndrojë në zemrat tona para se t'ua ngulisim atë fëmijëve tanë.

Në librin e tij, *Të shkëlësh barërat e këqij, të mbjellësh fare*, Denis Rejni thotë për të atin:

Si një djalosh që më bënte përshtypje gjithçka, radari im kapi nga jeta e tim ati më shumë se ai vetë mund ta mendonte. Gjatë viteve të trazuara të adoleshencës ai ishte modeli dhe heroi që kisha nevojë dhe ende është i tillë. Ai më mësoi rëndësinë e të punuarit fort dhe të çuarit të detyrës deri në fund. Mësova prej tij për vendimin që zgjat gjithë jetën, asnjëherë s'e kam pasur frikën se mos më ndaheshin prindërit. Im atë ishte krejtësisht i përkushtuar ndaj nënës sime dhe ndihesha i sigurt e i mbrojtur.

Por kryesorja, ai më mësoi mbi karakterin. Ai bëri çfarë ishte e drejtë edhe atëherë kur askush s'e shihte. Asnjëherë s'e kam dëgjuar të fliste për mashtrim taksash, ai i paguante ato pa ankesa. Ndershmëria e tij ishte e patëmetë. Asnjëherë s'e kam dëgjuar të gënjejë dhe sytë e tij kërkonin të njëjtën gjë si shpërblim. Imazhi mendor i karakterit tim vazhdon të më japë energji dhe të më nxisë edhe sot.

Pikërisht këtë dua dhe unë. Dua që fëmijët e mi të shohin shëmbëllimin e Atit tek unë. Që do të thotë se, nëse dua që vajza ime të mos vjedhë, duhet të sigurohem që të jem korrekt me pagesat edhe atëherë kur ka ulje çmimi. Që do të thotë se, nëse dua që im bir të mos mashtrojë, duhet që të mos përfitoj idenë e ndonjë bashkëpunëtori tim në zyrë duke e bërë timen. Që do të thotë se, nëse dua që fëmijët e mi të mos gënjejnë, duhet që vetë të tregoj gjithmonë të vërtetën, edhe kur është e vështirë, kur duket jo e përshtatshme për ta bërë, ose edhe nëse kjo bën që të tjerët të më shohin shtrembër. Duhet t'i bëj gjërat në praninë ose jo të fëmijëve që, pavarësisht sa i vetëdijshëm jam për praninë e tyre, ata do më vënë re më shumë dhe më nga afër se ç'mund ta mendoj.

Të forcosh dobësitë dhe çiltërsinë

Miku im, Norman Uejkfildi, më tregoi njëherë kur i biri, Joeli, po kalonte një kohë të vështirë për shkak të një vendimi jo të drejtë që kishte marrë. Një ditë, ndërsa po shëtisnin bashkë, Joeli i tregoi për problemin. Ndërsa ecnin dhe bisedonin, Normani i tregoi për një incident të ndodhur kohë më parë, që i kishte shkaktuar gati të njëjtën situatë dhe për të cilën i ishte dashur të përballonte pasojat. Duke treguar këtë ngjarje, Normani e ndihmoi Joelin të kuptonte që, edhe pse ai nuk ishte dakord me veprimin e tij, nuk kishte marrë pozicionin e gjykatësit. Sinqeriteti dhe çiltërsia e Normanit e ndihmoi Joelin të shihte që i ati po përpiqej të ishte shok dhe jo gjykatës. Pikërisht kjo e nxitë që ai të hapej plotësisht, duke i dhënë dorë Normanit të kuptonte më shumë për ta ndihmuar.

Në fakt, të zhvillosh ndershmërinë te fëmijët tanë kërkon të jesh së pari i ndershëm me ta. Anketimi me fëmijët që shkojnë në kishë, që e citova pak më sipër, tregon se 3% më shumë se një në tre, thonë se zakonisht, ose asnjëherë s'i kanë dëgjuar prindërit e tyre të pranojnë gabimin. Nuk pi ujë të folurit për ndershmërinë nëse në të vërtetë ne nuk tregojmë ndershmëri me ta. Më besoni, e di sa e vështirë është të pranosh gabimin, por është e nevojshme nëse duam të rrisim fëmijë që e çmojnë ndershmërinë.

Jo shumë kohë më parë, familja ime u shpërngul nga Kalifornia në Teksas dhe vajza -vjeçare e pati të vështirë këtë shpërngulje edhe kohë pasi u rehatuam. Një mbrëmje Kejt bëri një koment që shprehu problemin e saj dhe unë u mërzhita dhe iu ktheva pak si ashpër. Ajo shkoi në dhomën e saj dhe unë u shtriva në shtrat. Pas një çerek ore, grua ja erdhi dhe më zgjoi. – Duhet të shkosh dhe t'i kërkoj falje Kejtit, sepse është tepër e lënduar nga ato që i the, – tha ajo.

Ashtu përgjumësh (dhe me krenarinë time) i thashë: Jo tani, nesër në mëngjes.

– Jo, – këmbënguli Doti, – tani!

U çova dhe pasi u vësht, shkova në dhomën e vajzës dhe i kërkoj falje. E pranova para saj gabimin në mënyrën e komunikimit tim duke i treguar se më vinte vërtetë keq. Besoj se këto çaste të dhimbshme ndershmërie me vajzën kanë ndërtuar më shumë mbi marrëdhënien tonë dhe të kuptuarit e saj mbi ndershmërinë se çdo gjë tjetër që mund të kisha bërë.

Kur e prishim, duhet ndershmërisht t'ia rrëfejme Zotit dhe fëmijëve tanë, duke e rregulluar situatën nëse është e mundur dhe të vazhdojmë. Fëmijët e respektojnë një gjë të tillë. Ata do ta mbajnë mend, madje dhe do ta imitojnë.

Të mësosh ndershmërinë

Gjatë udhëtimit tim nëpër Amerikë, duke folur nëpër kisha të ndryshme si pjesë e fushatës «Si të dallosh të mirën nga e keqja», u kam bërë thirrje me qindra nxënësve të shkollës së mesme që të bashkoheshin me mua në shesh. Para të gjithë dëgjuesve, do t'i pyesja «A jeni të krishterë?» Shumica e të rinjve do ta pohonin. Pastaj do të pyesja «Po prindërit tuaj?»

Dhe sërish përgjigjja do të ishte pohuese. Do të vazhdoja: «Le të supozojmë një situatë ku duhet të gënjeni, që t'u shpëtoni disa situatave të dhimbshme. A do ta bënit?»

S'e mbaj mend herën e fundit, kur dikush ka thënë para kishës se nuk ka gënjer. Shkova në një kolegji të madh biblik në Kanada dhe mendova se konkluzioni do të ishte i ndryshëm, por përballë tre mijë njerëzve një djalosh pohoi: «Po, ndoshta do të gënjeja.» (Të paktën ai ishte i ndershëm me pandershmërinë e tij!)

Pasi ky i ri bëri këtë pohim, pyeta; «A ju kanë mësuar prindërit se të gënjeshtër është e gabuar?»

Dhe përgjigjja ishte po.

– Mirë, – vazhdoj unë, – si ju kanë mësuar se gënjeshtër është gabim?

Pa ndryshime përgjigjja vjen: S'duhet të gënjej, sepse në Bibël thuhet kështu. – S'duhet të gënjeshtër!

Pastaj unë bëj pyetjen më të rëndësishme të të gjithë bisedës: Pse thuhet në Bibël se s'duhet të gënjeshtër? Në ditët e sotme s'kam dëgjuar dikë që t'i përgjigjet kësaj pyetjeje.

E shihni ç'ndodh? Fëmijët tanë e njohin rregullin që s'duhet të gënjeshtër, por vetëm kaq! Ata s'e dinë gjithë të vërtetën, nuk mund ta shohin personin më të rëndësishëm pas këtij urdhri.

Ja pse unë besoj se duhet të përfitojmë nga çdo mundësi që na jepet për t'u ngulitur fëmijëve tanë vlerën e ndershmërisë dhe faktin që nder shmëria është e drejtë, sepse Zoti është i vërtetë.

Për shembull, mund të përdorni rastin e një folësi në televizion, ose një alarm makine që pushon në lagje për të diskutuar se si do të ishte bota nëse të gjithë do të ishin të ndershëm dhe të vërtetë si Zoti (s'do të na duhej t'i mbyllnim gjërat me çelës, apo të instalonim alarme) kohë të tilla do të forconin të kuptuarit se Zoti është një Zot i vërtetë, plotësisht i tillë dhe kur ne jemi të ndershëm e nderojmë atë.

Ndoshta mund të shfrytëzoni edhe rastet kur shkoni për pazar për të forcuar standardet e tij të ndershmërisë. Lëri fëmijët të paguanjnë vetë

tek arkëtari dhe kaloni një moment vetëm për t'u treguar pse ndershmëria është veprimi më i mençur. Udhëhiqi fëmijët më të mëdhenj në një diskutim se si bëhet zhduçimi nga vjedhjet, duke rritur çmimet dhe si e prish kjo idealin e Zotit.

Të nxisësh ndershmërinë

Kur fëmijët e mi ishin ende të vegjël, unë dhe gruaja ime kuptuam që me përgjigjet tona në situata të ndryshme mundet t'u kishim nxitur më shumë pandershmërinë se të kundërtën.

Për shembull, nëse do të shihnim një prej fëmijëve dhe një llambë të thyer pa dyshim do ta pyesnim: «A e theve ti llambën?» ose nëse do të vraponim tek një prej fëmijëve që qante dhe tjetri që i fliste ndërsa ai qante, do t'i bërtisnim fëmijës tjetër me një vështrim të zemëruar: «Mos e qëllove motrën?»

Një ditë ne kuptuam se të përballurit në atë mënyrë me fëmijët e bënte më të vështirë për mendjen e tyre që të përgjigjeshin sinqerisht.

Ne mund t'i dallonim kthesat e mendjes fëminore: e di përgjigjen dhe përgjigja e drejtë do të më hapë probleme, ndaj do të përpiqem të gënjej dhe të shoh nëse funksionon.

Neve na u duk sikur duke formuluar pyetjet në atë mënyrë po i shtynim fëmijët tanë drejt sjelljes së pandershme. Ata u ndjenë si të zënë në kurth nga gënjeshtria. Ndaj vendosëm t'u jepnim një mundësi më të mirë që të përgjigjeshin sinqerisht. Ndaj filluam t'u bënim pyetjet (me një ton serioz, por aspak të zemëruar): «E theve ti llambën, apo jo?» Ose «Pse e qëllove motrën?» Taktika e parë ndihmonte pandershmërinë, ndërsa mënyra e re nxiste ndershmërinë.

Ndërkohë ne zbuluam mënyra të reja si të nxisnim ndershmërinë te fëmijët tanë. Mësuam se të moralizonim, kritikonim, apo argumentonim nuk ishin mënyrat më të suksesshme. Duhet të vetëpërmbahemi kur tundohemi t'u afrohem fëmijëve me një listë të gjatë rregullash. Herë pas here fëmijët e provojnë zemërimin tonë pas mosbindjes së tyre të vazhdueshme, por këto momente duhet të jenë të rralla dhe të ekuilibruara me fjalë pozitive që nxjerrin në pah cilësitë dhe anët e forta të fëmijëve.

Të shpërblesh ndershmërinë

Kohët e para si baba nuk kanë qenë më të mirat. E marr si të vërtetë që puna kryesore e një babai është t'i mbajë fëmijët e vet larg mëkatit. I thashë vetes se, nëse ua kursej shuplakën dhe i dëmtoj, kjo s'do ta kënaqte Zotin. S'kam qenë kurrë abuziv me ta, por në kohët e hershme si baba, duhet të kem qenë ai që fëmijët e mi e quajnë një «person vërtetë të mërziqshëm». Nuk përtoja t'u hidhesha sa herë bënin ndonjë gabim, por nga ana tjetër asnjëherë nuk i kisha lavdëruar kur bënin një gjë të mirë.

Për shembull, kur isha ulur në studion time, duke shkruar me frymëzim një libër dhe Doti hynte brenda dhe më thoshte: «Zemër, sapo erdhi Shauni me dëftesën e mbushur me dhjeta!» «Sa mirë!» – do t'ia ktheja «Jam në mes të diçkaje të rëndësishme. Do të bisedoj me të gjatë darkës».

Gjatë darkës mund të mbaja mend të bisedoja me të, ose edhe jo. Por nëse Doti do të vinte të më tregonte se «Shauni e qëllloi motrën se hyri në dhomën e tij», do të kërceja përpjetë dhe menjëherë do të shkoja tek ata për të zgjidhur problemin. Dhe kështu, ajo që po shkruaja nuk do të ishte kaq e rëndësishme. Ajo çështje nuk mund të priste deri në darkë, duhej zgjidhur menjëherë.

Sot, kur flas me të rinjtë në mbarë vendin, vë re që nga prej tyre tregojnë të njëjtën situatë që ndodh në shtëpitë e tyre. Ata marrin vëmendjen e prindërve vetëm kur bëjnë ndonjë gabim. Arrita të kuptoja ç'po bëja vetëm pasi vajza e madhe mbushi vjеч.

Kam lexuar një libër me titull *Administratori i një minute*, ku autori nxit gjithë administratorët të sillen vërdallë duke parë gjithë punonjësit në punë dhe «t'i kapin duke bërë diçka të mirë» në mënyrë që t'i nxisin dhe vlerësojnë për përpjekjet e tyre. Kjo më solli në vete dhe kështu adoptova një «moto atërore», e cila ishte: «Përpiku të kapësh diçka të mirë te fëmijët e tu». Kur shihja Shaunin që shkonte të derdhte plehrat i thosha: «Faleminderit që kujtohesh ta bësh këtë, Shaun!» Kur kapja Kellin duke bërë detyrat e shtëpisë i thosha: «Zemër, e vlerësoj që po studion» dhe kur shihja Kejtin që rregullonte lodrat në dhomë i thosha: «Kejti, më pëlqen si i mirëmban lodrat». Kjo lloj teknike për t'i kapur fëmijët e mi duke bërë diçka të mirë, ndikoi fuqishëm në qëndrimin tim karshi fëmijëve dhe mendoj se përforcoi sjelljen pozitive tek ata.

Jam përpjekur ta praktikoj këtë gjë, sidomos në lidhje me sjelljet dhe qëndrimin ndaj ndershmërisë. Përpiqesha t'i kapja fëmijët kur tregoheshin të ndershëm për t'i shpërblyer. Dhe s'ka nevojë për veprime heroike; mund të kërkojë thjesht t'i paguash arkëtarit shumë e duhur, të pranosh që s'është bërë diçka që duhej bërë, ose të ripaguash borxhin me korrektësi. Atëherë i vlerësoja pa kursim dhe ndonjëherë me shpërblime si; të flinin më vonë se orari i përditshëm, t'u jepja «bonusin» shpërblyes pasi kishin thënë një javë «e çmoj ndershmërinë tënde».

Të tregosh të mirat e ndershmërisë

Gjithashtu kap çdo mundësi, që t'u ngulis fëmijëve se si ndershmëria dhe drejtësia na mbron dhe siguron. Përpiqem t'u tregoj sesi standardet e Zotit për ndershmërinë, shumë larg lëndimeve, apo të mbajturit peng të botës, në fakt prodhon të mira reale. U kujtoj që ai njeri që i vë vësh në vesh standardet e Zotit mbi ndershmërinë do të jetë i mbrojtur nga barra e fajësisë; kur je i ndershëm nuk të duhet të shohësh gjithë kohën pas vetes.

Dua që ata të ngulisin faktin që të rinjtë e krishterë që «thonë të vërtetën» do të korrin shpërblimin «e duarve dhe zemrës së pastër» ndaj Zotit.

Përpiqem t'i ndihmoj të shohin që virtyti i ndershmërisë e mbron një person nga turpi dhe ndrojtja që vjen si pasojë e daljes në dritë të gënjeshtërs.

Shpërblimi i mashtrimit është një jetë e shkurtër dhe pa kuptim, ndërkohë që ndjesia e plotësisë që vjen me ndershmërinë është e kënaq- shme dhe zgjat në kohë. Përpiqem t'u tregoj fëmijëve sesi standardi i Zotit për ndershmërinë

siguron një reputacion të mirë për drejtësi. «Një emër i mirë është më i dëshirueshëm se pasuritë e mëdha». Në Bibël thuhet: «Të jesh i çmuar vlen më shumë se ari dhe argjendi».

Dua që ata të kuptojnë se si ky standard i Zotit për ndershmërinë mbron dhe pasuron marrëdhëniet e tyre. Një marrëdhënie e mirë ndër- tohet në besim dhe besimi s'mund të jetojë në një atmosferë mashtrimi. Besimi është i domosdoshëm në ndërtimin e marrëdhënieve të suksesshme që zgjasin, shkon përtej betimeve martesore dhe kontratave të biznesit, thjesht me një element bindës dhe të fuqishëm. Një themel i fuqishëm besimi rrit dhe pasuron cilësinë e marrëdhënieve, duke siguruar diçka që as paratë nuk mund ta blejnë dhe pandershmëria s'mund ta arrijë.

Të ndihmosh fëmijët të zbulojnë standardet e Zotit për ndershmërinë

Të ndihmosh fëmijët të zbulojnë standardet e Zotit për ndershmërinë është prioriteti i çdo babai që kërkon të pasqyrojë shëmbëllimin e Zotit si Atë. Fëmijët tanë mund të shohin vlera të përshtirshme në jetët tona dhe të na dëgjojnë të flasim me bindje, por derisa t'i zbulojnë vetë këto vlera, do të jenë ende të dobët për të bërë kompromise.

Fëmijët tanë mund të kenë përgjigje të drejta, por qëndrime të gabuara. Qëllimi im është t'u ushqej motivime të brendshme, që do t'i drejtojnë fëmijët e mi të nderojnë Jezun Krishtin, të jetojnë me përgjegjësi dhe me sukses, dhe kjo buron nga një marrëdhënie me Të dhe të kenë si praktikë të jetës së tyre bindjen, pasojë e një marrëdhënieje të tillë (Gjoni 14:21-24)

Të zbulosh vlerat është proces. Fillon me informacionin. Unë kaloj goxha kohë me fëmijët për t'u dhënë informacion mbi ndershmërinë, të mirat e saj dhe në vazhdim, por nuk përfundon këtu.

Bashkëveprimi me të vërtetën është hapi vijues i procesit. I nxis fëmijët e mi të testojnë faktet për të parë nëse janë të vlefshëm dhe të këqyrin si zbatohen në situata të ndryshme. Pikërisht këtu, çdo baba mund ta gjejë veten plotësisht të përfshirë; duke biseduar me mirësjellje, me durim dhe me kujdes me fëmijën e vet. Pyeti fëmijët dhe nxitë që dhe ata të pyesin, kërko pikëpamje të reja, fakte të reja,

të vërtetë të re. S'e bën këtë thjesht për fëmijën tënd, por me fëmijën tënd, duke e drejtuar atë të formojë bindje me themele të forta.

Hapi i tretë, pasi u ke dhënë informacion dhe i ke nxitur në bashkë veprimin me të vërtetën, përfshin zbatimin e rezultateve (e të dyjave bashkë) në mënyrën e jetesës së tyre. Kështu, i ndihmoj fëmijët e mi të ndjekin deri në fund çfarë kanë mësuar dhe çfarë kanë zbuluar vetë

përmes përvojës dhe testimit të fakteve. Përpiqem t'i ndihmoj që të shpikin mënyra të reja praktike për të ndjekur në vazhdim të vërtetën që

kanë mësuar, duke e përjetuar përmes veprimeve dhe duke bërë pyetje si: «Si do të duket kjo në sjelljen e përditshme?» dhe «A do të ndikojë kjo në mënyrën si e ngas makinën, ose si e bëj punën, apo si u përgjigjem mësuesve?» Ky proces zbulimi përfshin: 1) informacionin. 2) bashkë veprimin me të vërtetën përmes hetimit. 3) zbatimin sipas së vërtetës në disa mënyra praktike. Ky proces është i gjatë. Përpunimi i vlerave nuk fillon derisa një fëmijë të arrijë moshën e adoleshencës. Fëmijët më të vegjël thjesht nuk mund të kuptojnë procesin për shkak të papjekurisë mendore. Nëse babai është duke mësuar standardet e Zotit për ndershmërinë në fazë më të hershme se kjo, fëmijët thjesht do t'i rezervojnë këto burime për më vonë. Kur ata mbushin moshën dhjetë vjeç dhe më tej, atëherë bëhen me bashkëveprues në këtë proces.

Është dhe një parim tjetër mbi zbulimin e ndershmërisë së përshpirtshme: sistemi i vlerave të fëmijëve tanë s'është e thënë që të jetë 2 i njëjtë me tonin. S'jemi në biznesin për të bërë klonin e vetes. Çdo fëmijë është unik dhe i veçantë. Ata mund të kenë ide të ndryshme mbi tema të ndryshme, të jenë më kokëfortë në disa gjëra dhe ndoshta mund të na kundërshtojnë kohë pas kohe, ndërkohë që ndjekin udhëzimet

biblike për t'u mbështetur në vlerat. Nëse marrëdhënia e tyre me Zotin është e fortë dhe për aq kohë sa nuk shkojnë kundër standardeve biblike, jepuni lirinë e nevojshme që të mendojnë ndryshe nga ju. Një fëmijë është i lumtur kur vlerat e tij, ose të paktën e drejta e tij për t'i pasur këto vlera, respektohen nga prindërit.

Këto shtatë mënyra; të modelosh ndershmërinë, të forcosh dobësinë dhe çiltërsinë, të mësosh ndershmërinë, ta nxisësh, ta shpërblesh, të tregosh të mirat e saj dhe të ndihmosh fëmijët të zbulojnë standardet e Zotit për ndershmërinë, mund të kërkojë goxha kohë, por me ndihmën e Zotit do t'ju japë mundësi të bëheni ai lloj babai që doni të bëheni. Këto mënyra do t'ju ndihmojnë të rrisni fëmijë që një ditë do të bëhen njerëz të ndershëm, të dallueshëm për drejtësi, duke fituar respektin dhe vëmendjen e të tjerëve. Do t'ju ndihmojnë të rrisni fëmijë, që mësojnë vlerën e suksesit të ndershmërisë dhe pasojën shkatërruese të pandershmërisë; fëmijë që do t'u shmangen pasojave të pandershmërisë dhe do të kënaqen në shpërblimin e

ndershmërisë. Do t'ju ndihmojnë të rrisni fëmijë të besueshëm, të cilët do të reflektojnë shëmbëllimin e babait të tyre dhe Atit të babait të tyre.

1. do t'i përgjigjej fëmija yt pyetjes që Xhoshi i drejtoi Kellit, vajzës së tij në faqen ? Kalo pak kohë këtë javë për t'u bërë fëmijëve këto pyetje dhe përdori ato si ndihmesë për t'i udhëzuar ata në të kuptuarit se Zoti është burimi i së vërtetës.
2. Çfarë po bëni personalisht për të modeluar një jetë të ndershme për fëmijët tuaj? A ka fusha ku jeni treguar më pak se të ndershëm? (Jini të ndershëm!) Si do të ndryshonit? Jini konkret!
- 3* Përzgjidhni të paktën një sugjerim nga seksioni «Të mësosh ndershmërinë», që ta zbatoni këtë javë si një përpjekje për t'ua ngulitur fëmijëve faktin që ndershmëria është vepri më i mençur.
- * Përpikuni të kapni secilin prej fëmijëve, duke bërë diçka të ndershme këtë javë dhe shfrytëzoheni si mundësi për t'u shprehur vlerësimin tuaj për ndershmërinë e tyre, duke i shpërblyer për këtë qëndrim.

Plotësoni këto fjali:

Njëherë e pagova çmimin e pandershmërisë kur
Njëherë i korra të mirat e ndershmërisë kur

Jini të gatshëm nëse ju jepet rasti të tregoni me ndershmëri dhe sinqeritet përvojat që rreshtuat si më sipër para fëmijëve tuaj si ilustrime të pasojave të pandershmërisë dhe të mirave të ndershmërisë.

Në filmin e Stivën Spielbergut «Gremçi» – (Hook), një histori e Piter Panit të ditëve të sotme, është edhe një skenë që shenjon një pjesë të ndjeshme të zemrës dhe mendjes së fëmijëve. Piter Bening, një prej personazheve të luajtur nga Robin Uilliams, është biznesmen i suksesshëm i zënë me shumë përgjegjësi. Piterit i telefonon dikush një natë para se e gjithë familja e tij të nisej për në Angli; të nesërmen në mëngjes ai duhej të ishte në një takim shumë të rëndësishëm, që i binte të ishte në të njëjtën kohë me ndeshjen finale të bejzbollit për atë sezon ku lojtar ishte dhe i biri. Djali i tij, Xheku, e kujton për ndeshjen.

«Do të vij,» – i thotë i ati, duke këmbëngulur se takimi s'do të zgjaste shumë. «Të jap fjalën e burrit!» Ditën tjetër në mëngjes, ndërkohë që takimi filloi me vonesë,

ai dër-goi njërin prej punonjësve të vet të shihte dhe të filmonte me kamera pjesën e ndeshjes që do të humbiste. Punojësi mbërriti pikërisht në kohën kur Xheku po përgatitej të bënte gjuajtjen në plate. Djaloshi u kthye nga stadiumi për të parë të atin, kur në vend të tij sheh një burrë që po filmonte me kamera, pranë nënës së tij. Ai u vrenjt në fytyrë nga zhgënjimi, u kthye nga partneri i lojës dhe gjuajti. Piteri mbërriti me vonesë dhe, pasi e ndaloj makinën që fishkëlleu nga frenimi i fortë, vrapoi drejt pjesës së ngritur për të parë mbi fushën e bejzbollit. Fusha ishte bosh. Të gjithë kishin shkuar tashmë në shtëpi. Po atë ditë, më vonë, ndërsa gjithë familja ishte në avion, e bija i tregoi të atit një vizatim «Shiko çfarë ka vizatuar Xheku», – i tha ajo. Aty ishte vizatuar një aeroplan i konsumuar, duke iu drejtuar oqeanit.

Katër njerëz ishin pranë avionit duke fluturuar jashtë tij, por vetëm tre kishin parashutë.

Piteri shkoi te ndenjësjja e të birit, i cili po luante me një top bejzbolli.

– Po unë, pse s’e kisha parashutën, Xhek? – e pyeti ai.

– Gjeje! – ia ktheu i biri.

Pasi kaluan disa çaste në heshtje, Piteri i tha: – Xheki, sezonin tjetër të premtoj që do të vij në të gjashtë ndeshjet.

– Sigurohu që të blesh videokaseta për të gjitha ndeshjet, – iu përgjigj hidhur djali.

– Të premtoj, – i tha Piteri. Të jap fjalën e burrit.

– Po, po, – ia ktheu Xheku, – fjalë burrecash.

Këto skena janë therëse, sepse janë të njohura për të gjithë ne si baballarë e fëmijë. Shumë baballarë që i duan fëmijët, përfundojnë duke i thyer premtimet e tyre. Shumë baballarë i zhgënjajnë, i dëshpërojnë dhe pezmatojnë fëmijët, duke mos i mbajtur premtimet. Dhe shumë fëmijë i njohin shpresat e zjarra dhe më pas thyerjen e zemrës të shkaktuar nga mosmbajtja e premtimit nga baballarët.

Unë nuk dua të jem ky lloj babai, dua t’i mbaj premtimet e mia, që ata të më besojnë kur them diçka. Dua të më shohin si baba që i mban premtimet, një burrë që e mban fjalën, një burrë që e bën atë që thotë. Dua të bëhem si Ati im që është në qiell.

Ati i besueshëm

Zoti është i besueshëm për mbajtjen e premtimeve. Mund të të duket e thjeshtë, por themelore për një koncept të shëndoshë lidhur me figurën e Zotit dhe me atë të atësisë. Ati ynë është mbajtësi përfundimtar i premtimeve. Besnikëria buron nga natyra e tij:

Për shkak të dashurisë së madhe të Zotit nuk u shuam, sepse dhembshuria e tij nuk resht kurrë. Do të ketë mëgjese të reja; besnikëria jote është e madhe
Vajtimet 3:23-24

S'ka rëndësi sa premtime ka mbajtur Zoti, të gjitha pohojnë Krishtin. Dhe përmes tij «Amen» është thënë prej nesh për lavdi të Perëndisë
2 Korintasve 1:20

Duke qenë të sigurtë se ai (Zoti), që filloi një punë të mirë në ju, do të kujdeset për ta përfunduar në ju deri në ditën e Jezu Krishtit
Filipianëve 1:6

Zoti i përmbush të gjitha premtimet. Marrëdhënia që ne kemi me Atin qëndron te besimi. Mbreti David, që pjesën më të madhe të jetës së vet e shpenzoi duke luftuar dhe përballur me armiqtë, e dinte ku ta vinte besimin e vet. «Disa besojnë te qerret», – ka shkruar ai, «dhe disa te kuajt, por ne besojmë në emrin e Zotit, Perëndisë tonë». (Ps :) Davidi e dinte që Ati i tij ishte i besueshëm, i sigurt. Ai e dinte se do të bënte çdo gjë që do thoshte Ati i tij.

Edhe ne, ashtu si Davidi mund t'i besojmë Zotit, sepse ai është gjithmonë i besueshëm dhe besnik. Edhe atëherë kur jemi në qetësi të thyejmë premtimet tona para tij, ai vazhdon të na dojë duke i mbajtur premtimet e veta. «Edhe nëse jemi të pabesë, ai do të jetë besnik, sepse ai nuk mund të dalë kundër vetes.» (2 Tim 2:)

Me fjalë të tjera, besueshmëria dhe besnikëria janë pjesë e natyrës së tij, ai nuk mund të jetë ndryshe, sepse kjo do të binte ndesh me atë që është në të vërtetë, do të ishte sikur të mohonte veten.

Ky lloj ati dua të bëhem, i tillë që mban premtimet, që fiton besimin te fëmijët e tij dhe që di ta shpërblejë këtë besim. Dua të jem ai atë që bën çfarë thotë, fëmijët e të cilit fitojnë siguri dhe besim për shkak të influencës sime.

E di që kjo do të thotë shumë dhe që vetë s'mund ta realizoj detyrën, por Ati në qiell mundet dhe sa më shumë që të mbështetem në të duke ecur ditë pas dite krahas tij, aq më shumë do t'i ngajaj duke ndjekur këto hapa:

Të premtosh seriozisht

Shumë prej nesh si baballarë bëjmë premtime dhe i thyejmë, sepse nuk arrijmë të kuptojmë sa serioze janë për fëmijët tanë. S'ë kuptojmë plotësisht sa të rëndësishme janë këto premtime – implicite dhe eksplicite – për bijtë dhe bijat tona. S'ë shohim efektin që krijon thyerja e premtimeve (dhe mbajtja e tyre) mbi fëmijët tanë.

Dr. Xhejms I. Shallër në librin e tij *Në kërkim të atësisë së humbur* tregon për një burrë që e kaloi gjithë ditën duke peshkuar me të birin. Atë natë babai – një burrë i rëndësishëm dhe me influencë në shtet – shkroi në ditarin e vet: «Sot shkova për të peshkuar me tim bir. Një ditë e humbur kot». Ndërsa i biri në ditarin e vet shkruan për atë që i kishte ndodhur atë ditë. Shënimi i tij ndryshonte kryekëput më atë të të atit: «Shkuam për të peshkuar sot me babin; dita më e bukur e jetës sime». Duket qartë që ky baba as që e ka idenë e fuqisë në duart e tij, sepse nuk mund t'i shohë gjërat nga këndvështrimi i të birit.

Kam mësuar që, ndërsa shoh me sytë e fëmijëve të mi, filloj të kuptoj dhe rëndësinë e premtimeve të mia dhe si duken premtimet e thyera në sytë e tyre. Është sikur: «Babi ka shumë gjëra të tjera për t'u shqetësuar;

Babi nuk është i interesuar për atë që bëj», «Unë s'jam aq i rëndësishëm për të», ose «Unë s'jam aq i mirë». Nga ky këndvështrim është më e lehtë për të parë sa të rëndësishme janë premtimet dhe sa seriozisht duhet t'i marr.

Të mbajmë premtimet para fëmijëve

Është e lehtë të thuash që duhet t'i mbajmë premtimet para fëmijëve, sepse të gjithë e duam këtë gjë dhe e dimë që kështu duhet, por në të vërtetë gjërat ndryshojnë disi. Shumë kohë më parë, ndërsa po këqyrja jetën time, e gjykova veten mbi bazën e disa qëllimeve, por kjo nuk do të thotë punë e kryer. Dihet që rruga drejt një vendi të vështirë dhe jo shumë të këndshëm është e shtruar me qëllime të mira. Gjithsesi fëmijët e mi nuk më gjykojnë për qëllimet, por për veprimet. Për ta s'do të thotë gjë nëse unë dua të kaloj kohë me ta, nëse këtë qëllim nuk e bëj realitet. Fakti që dua t'i mbaj premtimet s'ka kuptim për ta, derisa ata ta shohin të realizuar.

Një prej fushave që më ka ndihmuar shumë të mbaj premtimet para fëmijëve është të kuptuarit e dy lloj premtimeve: të nënkuptuara dhe të shprehura qartë. Të dyja janë shumë të rëndësishme dhe sa më shumë 2 premtime të nënkuptuara të marr, duke i shprehur ato qartë, aq më shumë e ndihmoj veten dhe fëmijët e mi.

Për shembull, disa prej premtimeve të nënkuptuara si baba është të duash fëmijët, t'i mbrosh nga e keqja, të sigurosh për nevojat e tyre dhe

t'i pajisësh me njohjen dhe drejtimin për të cilin kanë nevojë gjatë rritjes së tyre. Në shumë familje këto premtime përfshihen si të vërteta në jetën e tyre.

Jam përpjekur t'i marr këto premtime të nënkuptuara dhe t'i shpreh qartë; U kam treguar fëmijëve që do t'i realizoj këto gjëra për ta, duke u shtuar dhe disa premtime të tjera të shprehura qartë si «Ju premtoj që ju do jeni të parët para çdo pune.» Dhe «Ju premtoj që do t'ju dëgjoj në çdo kohë kur të keni nevojë». Por në përpjekjen për të realizuar gjithë këtë proces të nënkuptuar në të shprehur qartë kam kuptuar shumë mbi pritjet e fëmijëve të mi lidhur me premtimet. Për shembull, premtimi që do t'i mbroj nga e keqja përfshin edhe të mos flas gjëra të paqena, ose t'u ankohem të tjerëve për ta, dhe kjo është e drejtë, nga ana e tyre dhe ana ime për t'u mbajtur. Kam pasur edhe mundësinë t'i qartësoj premtimet e mia; për shembull, u kam shpjeguar se premtimi për t'u plotësuar nevojat fizike s'ka të bëjë me ndryshimet e shpeshta të modës dhe konsumit me garderobat e bashkëmoshatarëve të tyre.

Një baba që u qartëson premtimet e veta fëmijëve dhe e përkushton veten që t'i mbajë vazhdimisht këto premtime, u jep atyre një dhuratë të paçmuar – veten e vet si baba të besueshëm, besnik dhe të sigurt.

Të mbash premtimet para Zotit

Fëmijët do të mësojnë dy gjëra (midis shumë të tjerave) duke parë marrëdhënien e babait të tyre me Zotin; t'i besojnë Zotit dhe babait të tyre.

Nëse fëmijët e mi shohin që e kam lënë besimin tim mbi një numër llogarie bankare, apo në një punë të mirë shpërblyese dhe çdo gjë tjetër përveç një Zoti të besueshëm që mban premtimet, atëherë ata do arrijnë në përfundimin e mosbesimit në Zotin. Dhe anasjelltas, nëse ata shohin që unë e vë veten dhe familjen nën kujdesin e Zotit, duke u mbështetur në forcën e tij, duke besuar në premtimet e tij, ata do të jenë më të prirur të njohin një Zot besnik. Ndërkohë fëmijët mund të kuptojnë nga marrëdhënia ime me Zotin, nëse unë jam i besueshëm. Nëse ata shohin që edhe në marrëdhënie me Zotin unë i marr lehtë premtimet duke i thyer ato, atëherë ata do të dyshojnë në besueshmërinë time. Nëse unë e bëj vazhdimisht këtë, atëherë edhe fëmijët nuk kanë çfarë të presin në marrëdhënien time me ta. Dhe rezultati s'do të jetë gjë tjetër veç një shkatërrim i marrëdhënies sime me ta. Por sigurisht që unë nuk dua këtë dhe besoj që s'është as ajo që secili prej jush do që të ndodhë. Dua që fëmijët e mi të shohin, që i mbaj premtimet e mia për shkak të fuqisë dhe hirit të Zotit:

Si mund t'ia shpërblej Zotit për gjithë të mirat e tij...Do të plotësoj premtimet e mia në praninë e gjithë popullit të tij

Ps. 1:.

Dua t'i plotësoj premtimet e mia në Zotin në praninë e të gjithë njerëzve të tij, duke përfshirë këtu fëmijët e mi.

Të mbash premtimet ndaj të tjerëve

Një miku im njëherë më tregoi për një ndodhi me djalin e vet, Jordanin, që ishte në klasën e pestë. Kjo më kujtoi rëndësinë e mbajtjes së premtimeve ndaj të tjerëve para fëmijëve të mi. Dy prej shokëve të Jor danit po kalonin një kohë të vështirë për shkak të divorcit të prindërve të tyre.

Një mbrëmje, pasi ai shkoi në shtrat, prindërit e tij filluan të diskutojnë tonin në mënyrë të zjarhtë. Ata ishin treguar të matur për vite me radhë që të mos e tregonin zemërimin ndaj njëri-tjetrit përballë fëmijëve, por ndërkohë ishin të pavetëdijshëm që Jordani ishte ende zgjuar dhe mund të dëgjonte gjithçka. Në mes të debatit, gruaja u kthye dhe vuri re djalin të ulur pa zhurmë në derën e dhomës së tyre të gjumit, me lotët që i rridhnin faqet.

Menjëherë ata e ndalën debatin, i ati e mori djalin dhe e pyeti: – Jordan, mos pëndonjë ëndërr të keqe?

Jordani dënesi dhe në rënkim e sipër mundi të thoshte:

– Babi, kur do të ndaheni ti dhe mami?

– Çfarë të bën të mendosh që do të ndahemi? – e pyeti i ati.

– Xhoni dhe Xhejmsi më kanë treguar që prindërit e tyre zihen shumë, – tha djali me frikën që i lexohej në sy, – dhe tani edhe ti me mamin po ziheshit.

Në atë çast të dy prindërit erdhën në vete dhe menjëherë zemërimi u shua. Ata e përdorën këtë «çast mësimi» për t'i treguar sa e rëndësishme ishte martesja e tyre. I treguan që ata e donin shumë njëri-tjetrin dhe se kur u martuan i kishin premtuar njëri-tjetrit që do t'i mbanin këto premtime.

Një baba që i thyen premtimet e veta ndaj gruas, miqve, apo kolegëve 2 të punës do ta ketë të vështirë të ndërtojë ura besimi me fëmijët e vet, por një baba që i mban premtimet e tij ndaj të tjerëve, nxit dhe pasuron një shpirt besimi edhe me fëmijët e vet.

Të jesh i përgjegjshëm

Shumë herë shoh prindër të habitur, pasi i kam këshilluar të jenë të përgjegjshëm me fëmijët e tyre.

Shumë prindër e shohin këtë sugjerim pak si radikal, ndoshta dhe jo pozitiv. Ata më shohin njësoj sikur t'i kisha përqeshur me gjuhën përjashta dhe veshët e ngrehur. Në fund të fundit, mendohet që fëmijët të jenë të përgjegjshëm dhe jo e anasjellta. Por sinqerisht, mendoj se të jesh i përgjegjshëm para fëmijëve të tu është një nga mënyrat më të suksesshme për të mbajtur premtimet dhe për të ndërtuar besimin në

marrëdhënien baba-fëmijë. S'po them që fëmijët ua kanë për borxh këtë. Ka të bëjë me të qenit i përlurur dhe i bindur mjaftueshëm që kur të thyni një premtim, fëmija të kuptojë që

«kishit arsye».

Kur Kelli mbushi shtatë vjeç i shkrova këto fjalë në kartolinën e urimit:

E dashur Kelli, të dua shumë dhe kam kënaqësi të jem babai yt, por këtë vit do të kem nevojë për ty. Asnjëherë s'kam qenë babai i një vajze -vjeçare ndaj dua të jem babai më i mirë për ty. Dhe nëse do të ndihesh që s'po veproj mirë, apo drejt, të lutem më thuaj.

Të

njëjtën gjë kam bërë dhe me tre fëmijët e tjerë, sepse doja të isha i përgjegjshëm me të katërt. E kam marrë në konsideratë pjesëmarrjen e tyre për të më ndihmuar të mbaj premtimet ndaj tyre, ndërkohë që ata u bënë katër nga këshilluesit e mi më të vlefshëm.

E di që të jesh i përgjegjshëm me fëmijët, s'është dhe aq e lehtë. Për shembull, njëherë kur ime bijë, Kejt, ishte dhjetë vjeç, m'u hodh me këmbët e para sa u ktheva nga një shërbim. – Babi, nuk je treguar i drejtë me mua! Epo, një prej gjërave që u kam premtuar është të jem i drejtë me ta. Ndaj e pyeta?

– Pse, moj zemër?

- Sepse kur vjen nga shërbimi, ti del vetëm me dy motrat dhe vëllanë, por jo me mua.

– Vërtet? – Kjo më befasoi.

– Po, – vazhdoi ajo pa u zbrapsur nga e saja. Pastaj u zbut dhe tha: – A do të dalim për drekë sot bashkë?

Pa dyshim që këtë bërë. Gatishmëria për të qenë i përgjegjshëm ndaj sime bije më bëri të kuptoja gabimin që po bëja.

Kjo është përgjegjshmëria. Të mbash premtimet ndaj fëmijëve të tu është punë e vështirë; nëse do të ishte ndryshe, të gjithë ne do ta bënim, apo jo? Është një punë që kërkon pa dyshim ndihmën e Zotit dhe të fëmijëve tanë. Besomëni, nëse ua jepni mundësinë, ata kanë për t'ju ndihmuar!

Idetë e dhëna më sipër nuk do t'ju ndihmojnë vetëm për të qenë baba i besueshëm për fëmijët dhe që bën çfarë thotë, por edhe një baba i fëmijëve të besueshëm dhe besnikë pikërisht për shkak të ndikimit tuaj.

Përmes besimit në Zotin me anë të Frymës së Shenjtë dhe përmbushjes me besnikëri të këtyre detyrave atërore, vetë fëmijët tuaj do të bëhen mbajtës premtimesh, burra dhe gra që e mbajnë fjalën dhe të besueshëm për këtë.

1. Kur ka qenë hera e fundit që ke thyer një premtim ndaj fëmijëve të tu? (nëse s'të kujtohet, pyet fëmijët!) Çfarë mendon se u komunikon fëmijëve ky premtim i thyer? (Nëse s'e di, pyet fëmijët!)
2. Përdore këtë pjesë, ose qoftë dhe në një letër tjetër për të shkruar premtimet e pambajtura ndaj fëmijëve:

Cilën prej këtyre premtimeve duhet ta shprehësh më qartë? Rrethoje.

- * Përdore këtë pjesë, ose dhe një letër tjetër për të shënuar premtimet që ke mbajtur ndaj fëmijëve.
- * Bëj plane për t'u treguar i përgjegjshëm ndaj fëmijëve të tu këtë javë. Si do ta bësh (bisedo veç e veç me fëmijët dhe pastaj në grup, mbaj shënime dhe kërko ndihmë për t'i mbajtur premtimet).

Një baba ngushëllues dhe përkrahës

Ejmi, katërmbëdhjetë vjeçare e ka para syve të gjallë kur ndodhi për herë të parë. Ajo ishte vetëm pesë vjeç.

U zgjua në mes të natës nga një shtrëngatë jashtë shtëpisë. E frikë suar nga errësira dhe nga shkreptëtimat e bubullimat jashtë, ajo u hodh nga krevati dhe vrapoi duke qarë në dhomën e prindërve.

U avit nga krevati i prindërve duke kërkuar me lot të ëmën. Para se të përgjigjej e ëma, u përmend i ati.

– Ç'bën jashtë krevatit tënd ti? – i tha ai i zemëruar që e kishte zgjuar. – Kthehu shpejt në dhomën tënde!

– Por kam frikë, babi, – iu përgjigj ajo duke dënesur.

– S'dua të dëgjoj nga këto. Tani je vajzë e rritur dhe duhet të sillesh si e tillë.» Ejmi hodhi një vështrim lutës nga e ëma, që ishte ngritur tashmë, por ajo ia kishte ngulur sytë dyshemesë.

– Më dëgjove? – bërtiti i ati duke e hedhur përpjetë të bijën. Të thashë të kthehesh në krevatin tënd dhe mos na bezdis më!

Ejmi iku nga dhoma e prindërve dhe shkoi në banjë. Ndezi dritën, mbylli derën me çelës pas vetes dhe e kaloi gjithë natën e shtrirë në vaskë, duke qarë dhe u dridhur nga çdo shkreptëtimë rrufeje dhe kërcitme bubullime. Kjo skenë u përsërit edhe shumë herë të tjera derisa Ejmi kuptoi të mos priste ngushëllim dhe përkrahje nga i ati. Deri në moshën dhjetë vjeçare, ajo i kaloi netët me stuhi në banjë me dritën ndezur dhe derën e mbyllur me çelës, duke qarë në vaskë.

Gjëja më e keqe e kësaj historie është se gjithçka është e vërtetë. Që atëherë ajo ka mundur ta mposhtë frikën e stuhive, por vazhdon të vuajë mungesën e ngushëllimit dhe përkrahjes nga i ati dhe rezultate të tilla mund të jenë shkatërruese. Sipas dr. David Ferguson dhe dr. Mëkmin nga qendra për Intimitet Martesor dhe Familjar, një person që i ka munguar ngushëllimi dhe mbështetja nga babai, ka gjasa të rritet i shkurajuar, i vetmuar, me zbrazëti dhe i ndrojtur. Një person i tillë është më i prirur për imoralitet, frikë nga dështimet, i mërzitur nga jeta dhe me gjasa maniakizmi.

Një i ri që s'ka gjetur mbështetje dhe ngushëllim tek i ati ndihet më i pasigurt dhe i pafuqishëm për të përballuar presionin shoqëror, prob- lemet në krijimin e shoqërive të shëndetshme, më i prirur t'i dorëzohet presionit për të pasur shfryrje seksuale në përpjekje për të mbushur nevojat e munguara emocionale.

Ndërsa në të kundërt, me një të ri që ka pasur përkrahjen dhe ngu- shëllimin nga i ati, ndihet i dashur, mirënjohës, plot shpresë, i ndjeshëm, me shpirtin bujar, i dhembshur dhe i vetësigurt.

Sa më shumë ndiej keqardhje për sjelljen e babait të Ejmit, aq më shumë pranues bëhem për rastet kur unë vetë ua kam mohuar ngushëllimin dhe mbështetjen fëmijëve të mi si baba kur ata kanë pasur nevojë. Por ky nuk është lloji i babait që dua të jem. Dua të jem ai lloj babai që është aty kur fëmijët e tij kanë nevojë për përkrahje dhe ngushëllim, që është i ndjeshëm ndaj frikërave dhe dhimbjeve të fëmijëve të vet. Dua të jem i tillë që ngushëllimi dhe përkrahja e të cilit i pajis fëmijët t'u qëndrojnë presioneve të shoqërisë, betejave të ndjenjave të pasigurisë, të krijojnë shoqëri të shëndetshme, duke fituar kështu respektin dhe admirimin e bashkëmoshatarëve të tyre. Dua të jem ai baba që i ngjan Atit të vet.

Figura e Atit

Natyra dhe karakteri i Atit tonë qiellor na tregon se një baba i për- shpirtshëm është ai që ngushëllon dhe mbështet fëmijët e vet në kohë të vështira. Bibla na thotë se «Zoti dëgjon britmën e të drejtit, ai e çliron nga telashtet». Zoti është me zemërthyerit dhe shpëton ata që e kanë frymën të dërrmuar». (Ps 34:17-18)

Ai është «Ati i dhembshur dhe Zoti i ngushëllimit të plotë, që na qetëson në çdo telash në mënyrë që edhe ne të ngushëllojmë në të njëjtën mënyrë ata që janë në telashe». (2 Kor 1:3-4)

Modeli ynë është Ati i dhembshur dhe Zoti i ngushëllimit. Ai ndodhet pranë nesh në kohë krize dhe fatkeqësish, jo me padurim dhe zemërim, por me ngushëllim dhe mbështetje. Ai e di më së miri që ndihma më e madhe në vështirësi është të mbështetemi diku, të dikush ku mund të marrim forcë dhe këshillë të urtë.

Ngushëllimi i Zotit është aq i gjerë dhe i madh sa i mbulon gjithë telashet tona. Ai na ngushëllon dhe përkrah në kohë të vështira per-sekutimi për shkak të emrit të tij, apo në rrethana – pasojë të sjelljes sonë të pamend. Ai na ngushëllon edhe atëherë kur s’e meritojmë.

Ngushëllimi i tij arrin në mes të rrëmujës që ne vetë kemi krijuar, ai na përkrah kur jemi të dobët dhe kur dështojmë.

Ai do të kullosë kopenë e tij si një bari, do t’i mbledhë qengjat me krahun e tij, do t’i mbajë në gjë të tij dhe do të udhëheqë me ëmbëlsi dhe kujdes delet që kanë të vegjëlit e tyre.

Isaia 40:11

Ngushëllimi dhe mbështetja e Atit nuk mungon edhe atëherë kur atij i duhet të na dispijnojë. Psalmisti David shkroi: «Shkopi yt dhe thupra jote janë ato që më ngushëllojnë.» (Ps :b) Simboli i bariut është përdorur si një instrument për të treguar ngushëllimin dhe mbështetjen, që mbledh rreth vetes qengjat e sapolindur dhe i drejton delet përmes rrugëve të vështira dhe të rrezikshme. Nga krahu tjetër, shkopi përdoret si simbol i disiplinës dhe mbrojtjes; përdoret për t’u mbrojtur nga armiqtë që sulmojnë dhe për të spastruar rrugën, apo ndaj deleve të pabindura. Të dyja instrumentet, shkopi dhe thupra, ishin burim ngushëllimi për psalmistin, sepse që të dyja ishin në dorën e bariut ngushëllues dhe të dhembshur.

Pikërisht ky lloj babai dua të jem. Dua të psqyroj natyrën e Atit tim me anë të fuqisë së mbinatyrshme të Frymës së Shenjtë, që jeton në mua dhe punon nëpërmjet meje. Dua t’i ngushëlloj dhe mbështes fëmijët e mi gjatë gjithë kohërave të vështira. E di që është e lehtë të ngushëlloj time bijë ndërsa kthehet nga shkolla e mërziur se ka marrë nëntë në vend të dhjetës, apo qoftë të mbështes tim bir kur i ka mbetur vetëm një ndeshje nga loja e skuadrës së tij të futbollit. Është e lehtë të ngushëllosh fëmijën kur ka rënë nga biçikleta, apo sapo ka pësuar një dështim.

Por s’është dhe aq e lehtë t’i ngushëllosh dhe përkrahësh kur kanë shkatërruar makinën thjesht për një trill adoleshent, kur kanë dështuar në provim se s’kishin mësuar sa duhet, kur kujtohen në minutën e fundit të plotësojnë angazhimin e tyre dhe për pasojë e bëjnë më keq. Këto lloj telashesh, të cilat ata ia bëjnë vetë vetes, e bëjnë më të vështirë situatën që t’u përgjigjesh në mënyrë të përshpirtshme. Por pikërisht në kohë të tilla fëmijët tanë kanë nevojë më shumë të ndihen të mbështetur dhe ngushëlluar prej nesh. Vazhdoj të kem prirje për të qenë i ashpër me fëmijët e mi; duke qenë më shpejtë për t’u bërtitur, qortuar dhe mbajtur «leksion», por dhe vetë jam në mësim e sipër. Po mësoj si t’u tregoj shëmbëllimin e Atit qiellor, duke i ngushëlluar dhe përkrahur. Po mësoj mënyra të reja për t’u bërë njësh me shëmbëllimin e Tij; teknika të reja për t’u njësuar me shëmbëllimin e Atit në procesin e atësisë, të tilla si:

Të pranosh kufizimet e tua

Bobi, një baba i ri, më tregoi njëherë për përpjekjet e tij për t'i mësuar biçikletën vajzës së vet gjashtë vjeçare. Bobi vraponte krahas biçikletës së Hedhërit për ta ndihmuar të mbante ekuilibrin, ndërkohë që ajo mësonte të bënte disa gjëra njëkohësisht: të drejtonte timonin, të pedalonte, të balancohej dhe të ndalonte. Aksidentalisht Bobi e lëshoi për një çast biçikletën, e cila u përplas duke e rrëzuar Hedhërin në një pirg me hekurishte.

Ndërsa rrëfente mbi incidentin, Bobi shprehu edhe frikën e vet se kishte qenë ai shkaktari i «dështimit» të vajzës. Ai donte që Hedhëri të dorëzohej tek ai duke besuar që do ta përkrahte, jo vetëm në këtë rast, por gjithmonë.

Por Bobi s' ishte i përsosur dhe asnjë prej nesh nuk është i tillë.

Një prej çelësave për të qenë baballarë ngushëllues dhe mbështetës është të njohim kufizimet tona. Ne s'mund të parandalojmë kur ata vriten; por mund të jemi pranë tyre për t'i ngritur dhe puthur plagën; s'mund t'i ndalojmë të bëjnë gabime, por mund të jemi pranë tyre që të ndreqen, s'mund t'i mbrojmë dot gjithmonë nga e keqja dhe zhgënjimet, por mund të jemi me ta, duke qarë dhe u ndjerë si ata. Ne s'mund të rregullojmë gjithçka që nuk ecën në rregull me jetët e tyre; por mund t'i përgëzojmë kur arrijnë suksesin dhe t'i nxisim kur dështojnë.

Ne s'mund të bëjmë gjithçka për fëmijët tanë, por nëse me ndihmën e Zotit mund të bëjmë sa mundemi, kjo do të ishte e mjaftueshme.

Të kalosh kohë

Një prej njerëzve që reagoi ndaj anketës sonë «Pse të pres» shkroi një ese mbi përvojën e parë seksuale. Në një pjesë thuhet:

Pata një ditë të keqe në shkollë dhe gjithçka që doja ishte vetëm pak kohë me prindërit. Thjesht një përqaftim, por ata ishin shumë të zënë, kështu që shkova me këto probleme tek i dashuri. Një gjë i la vendin një gjëje tjetër dhe ja, kështu unë u përfshiva në marrëdhënie seksuale. Mami, babi, do të kisha dashur të ishit aty kur kisha nevojë.

Kjo vajzë e re kishte nevojë për ngushëllim pas një dite të keqe në shkollë dhe këtë e kërkoi së pari nga prindërit, por kur ata ishin tepër të zënë, i hodhi sytë diku gjatë.

Fëmijët nuk e shqiptojnë fjalën dashuri si të rriturit; për ta është K-O-H-Ë. Një baba që do me të vërtetë të pasqyrojë shëmbëllimin e Atit të dhembshur dhe ngushëllues, duhet të kalojë kohë.

Unë s'kam qenë gjithmonë model në këtë fushë, por kam bërë goxha rrugë nga ku kam qenë. Njëherë gjatë pushimeve tona në Meksikë, ndërsa po shkruaja një libër, Kelli erdhi dhe më tha: »Babi, a do të më çosh te parukierja?»

U gjenda në një turlu mendimesh, ku i pari ishte: «Më mirë jo». E dyta; «Xhosh, është koha të praktikosh atë që predikon dhe men dimi i tretë erdhi si lutje: Zot, me jep qëndrimin e duhur për këtë gjë».

Lashë punën që po bëja duke shpresuar që do ta kisha sërish «muzën» që më kishte pushtuar gjatë të shkruarit dhe e çova vajzën te parukierja. Lumturisht (gruaja ime do ta quante befasisht) nuk bëhej thjesht fjalë për ta shoqëruar Kellin me makinë, por ajo që ime bijë donte ishte pikërisht koha ime dhe ashtu siç doli më pas, ne kaluam një kohë të bukur bashkë duke biseduar gjatë kthimit për në shtëpi. Në fakt, Kellit iu desh kohë deri në fund të udhëtimit të dilte aty ku donte, në një temë delikate, por unë isha i kënaqur që ia dhashë atë kohë.

Kelli mund të më ketë falënderuar tre a katër herë që e kisha shoqëruar te parukierja... Dhe besoj se kjo ishte jo për faktin që kaloja kohë me të dhe i komunikojta interesin tim për të, por sepse i kisha treguar mbështetjen dhe ngushëllimin tim në një situatë të veçantë.

Të njehsosh nevojat e tyre

Miku im, Norman Uejkfildi, tregon për një rast kur njëra prej vajzave të tij po përgatitej për diplomimin në shkollën e mesme; kohë kjo ku çdo prind pret ta shohë fëmijën të lumtur dhe mbushur me shpresa. Përkundrazi, Normani vuri re që e bija dukej e ndrydhur dhe e heshtur.

Dhe pas një bisede me të, ai kuptoi që ajo ishte e zhgënjyer, sepse shumica e shokëve të saj të klasës do të merrnin shpërblime të veçanta dhe bursa pas diplomimit, ndërkohë që ajo vetë nuk priste të merrte gjë.

Normani do të kishte bërë shumë gjëra atë moment. Mund ta kishte bërë që ta hiqte mendjen, mund t'i thoshte që të mos bëhej budallaqe, apo edhe të arsyetonte me të, por kuptoi që asnjë gjë nga këto nuk do të ishte afër nevojës së saj në ato momente. «S'dija ç'të thosha» – shprehet ai tani, por thjesht i hodha dorën në qafë dhe e shtrëngova pas vetes duke i thënë: «Në librin tim, ti je njëshi!» Përmes buzëqeshjes dhe përqafimit të së bijës ai kuptoi që s'ishte dhe aq i keq si baba se s'kishte ç'të thoshte. Vlerësimi i tij për të bijën ishte i saktë. Ajo kishte nevojë për ngushëllim, kishte nevojë të dëgjonte se, pavarësisht nga shpërblimet, apo bursës, ishte dikush që e vlerësonte në maksimum.

Një baba që dëshiron t'u ofrojë ngushëllimin dhe përkrahjen e vet fëmijëve duhet së pari të jetë i ndjeshëm me nevojat e tyre. Dëgjoni me kujdes atë që ata thonë dhe vini re çfarë bëjnë, por mos ngelni me kaq; përpiquni të njehsoni çfarë

ndjenjash dhe nevojash reflektojnë veprimet e tyre? Një fëmijë që thotë: «Ti asnjëherë s'ke bërë gjë për mua» mund të shprehë nevojën për vëmendjen e babait. Një fëmijë që shikon nga shkallët e stadiumit para se të gjuajë ka nevojë për mbështetje. Një fëmijë që shpërthen nga zemërimi në një çast dështimi ndoshta thërret për ngushëllim.

Nuk po flas këtu për të justifikuar sjellje të papërshtatshme. Po them që ne vëmë re, madje mund ta parashikojmë nevojën e fëmijëve tanë, jo vetëm përmes fjalëve dhe veprimeve të tyre, por edhe nevojës që i nxit ata.

Të mësosh gjuhën e ngushëllimit dhe mbështetjes

Midis shumë gjërave të tjera që po mësoj është edhe fakti që një fëmijë nuk ka nevojë vetëm kur ka frikë, kur është i zhgënjyer, apo i lënduar. Meqenëse si person u afrohem problemeve pas një njohjeje të përgjithshme, instinkti im i parë ndaj dikujt që është i lënduar është racional («E di se gabimi yt ishte...»)Ti e kupton pse ndodhi e gjithë kjo, apo jo?» Megjithatë po mësoj që zakonisht njerëzit e lënduar s'kanë nevojë për korrigjim («të të bëhet mësim») dhe as udhëzime («Kjo do të të ndërtojë në karakter, nëse e lejon të ndodhë»), këshillë («nëse do të isha në vendin tënd,,»), apo sugjerim («Gëzohu se mund të ishte më keq se kaq!»)

Në vend që të ndjek instinktet e mia, kam mësuar se shumicën e rasteve fëmijët e mi kanë nevojë që të jem pranë tyre, t'i përqafoj, të qaj me ta, t'u rrok duart, të ndiej të njëjtën dhimbje me ta dhe t'u tregoj se kujdesem për ta. Ashtu si ka raste kur ata kanë nevojë për këshillën, apo korrigjimin tim. Megjithatë, s'kanë nevojë për predikime, por për një sup ku të mbështeten. Kanë nevojë për mbështetje dhe ngushëllim. Dhe këto janë shprehjet më të mira përmes gjuhës së ngushëllimit dhe përkrahjes «Më vjen keq, zemër, apo «E di që të dhemb», apo «Jam këtu me ty», «Të dua» dhe gjuhës së përkrahjes: « Besoj tek ti», apo «Do ta kalojmë bashkë», «Do jem pranë teje gjithë kohën».

Ka raste kur duhet disiplina dhe ndreqja kur një i ri po vuan për shkak të sjelljes së vet të keqe, por disiplina do të ketë efektin e vet pozitiv, pasi një baba ka ofruar së pari ngushëllimin dhe mbështetjen.

Të mbash gojën

Në librin e vet «Njeriu i plotë», Dan Benson tregon se si një anketim prindërisht zbuloi që nënat dhe baballarët u bëjnë përgjithësisht dhjetë komente negative fëmijëve përballë një pozitiv. Bensoni vazhdon: «Ekspertët në psikologjinë e fëmijës besojnë se duhen vetëm më pak se katër vërejtje pozitive për të kompensuar dëmin e vetëvlerësimit që në fakt, shkakton vetëm një koment negativ».

Babai që do të ngushëllojë dhe përkrahë fëmijët e vet duhet të ketë kujdes, sepse fjalët kanë fuqi të ndihmojnë ose të lëndojnë. Nëse ai vazhdimisht është sarkastik, dënues dhe kritikues me fjalët e veta, asnjë lloj ngushëllimi, apo mbështetjeje s'do të kishte rezultat. Nëse gjuha e tij verbale ose joverbale nënkupton:

- Largohu prej meje.
- Mos më mërzit.
- Preferoj më mirë shoqërinë e të rriturve.
- S'kam kohë për ty.
- Ti je budalla.
- S'je i pëlqyer për sytë e mi.
- Je i bezdisshëm.
- S'i marr në konsideratë mendimet, apo ndjenjat e tua.

Ai do të vetëbëhet armik me fëmijët e vet, duke i shtyrë që ta kërkojnë diku gjetkë ngushëllimin dhe mbështetjen për të cilat kanë nevojë.

Të hysh në botën e tyre

Nëse doni që fëmijët tuaj të ndiejnë ngushëllimin dhe mbështetjen tuaj, futuni në botën e tyre. Bëjeni qëllimin tuaj për të zbuluar se çfarë u intereson atyre, çfarë është e mirë për ta, çfarë u pëlqen, me çfarë lloj miqsh po shoqërohen. Shumë prej nesh si baballarë presim që fëmijët të na komunikojnë në nivelin tonë; presim që ata të bëjnë gjëra që neve na interesojnë; ndërkohë që rrallë ose kurrë nuk mundohemi të kuptojmë interesat e tyre dhe të komunikojmë në nivelin e tyre.

Disa vjet më parë, Kelli mori një shoqe për darkë te ne dhe të dyja filluan të më bezdisnin me idenë e tyre për flokët e mi.

- Oh, në fakt nuk janë flokët e mi ato që ju interesojnë, – këmbëngula unë.
- Eja, pra, babi, – u lut Kelli.

Në fakt s'kisha aspak dëshirë të isha si kavje në duart e këtyre dy vajzave, por një çast e mendova si mundësi për të hyrë në botën e tyre.

- Mirë, – pranova në fund. – Mund të bëni ç'të doni me flokët e mi,

përveçse t'i prisni, apo t'i ngjyrosni dhe me kusht që pas kësaj të dalim bashkë për të ngrënë darkë.

– Mirë! – bërtitën ato njëzëri dhe për më shumë se një orë ma shkumosën, ma thanë me tharëse flokësh dhe disa gjëra të tjera që s'i mora vesh ç'ishin. Kur mbaruan, flokët e mi kishin marrë pamjen e një personi që sapo e kishte zënë korrenti (të paktën nëpër karikatura!). Ngjaja sikur kisha zbritur nga një planet tjetër. Ndërsa ia ngula sytë pasqyrës, u mendova dy herë për marrëveshjen që kishim bërë më parë. Me të vërtetë që do të dilja ashtu për darkë? Vetëm duke menduar që askush s'do të më njihte.

Në hyrje të picerisë (patjetër me syze dielli!) vajzat qëndruan disa hapa larg meje sikur nuk ishin me mua. Kishte vështirime të habitura nga njerëzit, madje një grua i zgurdulloi sytë, por të paktën askush nuk lajmëroi policinë.

Nuk e besoj që ai moment ishte ngushëllues dhe mbështetës për time bijë, Kellin, por më mësoi krahas takimeve të tjera, festave me tullum- bace, apo me kokoshka, edhe shumë gjëra lidhur me fëmijët e mi që më bëjnë të di më mirë si t'i ngushëlloj dhe mbështes kur kanë nevojë. Duke hyrë në botën e tyre herë pas here, kam mësuar si t'i kuptoj gjendjet e tyre shpirtërore, ndjenjat e tyre dhe të përparoj me vështirësitë, gjë që s'do të mund ta kisha bërë dot në një mënyrë tjetër.

Gatishmëria për të qenë afër duke i ngushëlluar dhe mbështetur s'është si televizori që e nder kur të duash. Po më shumë ngjan me kopshtin: duhet një kujdesje e vazhdueshme, që kur të vijë koha – mo- mente të paparashikueshme – fryti i punës sate të vilet.

Të ofrosh ngushëllim dhe mbështetje është proces i gjatë nga të dyja palët. Por ju si baballarë do të mund të shihni si e përballin ata një shoqëri jo të shëndetshme, të sigurt që kanë për të gjetur mbështetje dhe ngushëllim të plotë kur të jetë e nevojshme, pikërisht në shtëpitë e tyre. Do të jeni dëshmitarë të shoqërive të tyre të mira, ku jo vetëm marrin, por dhe japin, se si ata rriten duke marrë me vete respektin dhe admirimin e bashkëmoshatarëve të tyre (madje dhe të prindërve të tyre), ndërkohë që bëhen njerëz të zotë dhe të sigurtë, të cilët e dinë se, pavarësisht çfarë mund të ndodhë në shkollë, në punë, apo në kishë, ata do të gjejnë ngushëllim dhe mbështetje te babai i tyre.

1. Rishiheni këtë listë dhe konsideroni nëse fëmija juaj pasqyron ndonjërin prej këtyre tipareve. Shënoni atë që mendoni se

- ☐ i ka shkurajuar
- ☐ frikësuar nga dështimi
- ☐ vetmuar
- ☐ të zbrazët
- ☐ ndrojtur
- ☐ të ndihen mërzhitur nga jeta
- ☐ të pasigurt
- ☐ të dobët ndaj presionit shoqëror
- ☐ shthurur
- ☐ të dobët ndaj presionit seksual
- ☐ i ka bërë maniakë
- ☐ i ka bërë të krijojnë shoqëri të keqe

2. Ndërsa mendoni mbi këto tipare, a ka ndonjë që vjen si rezultat i mungesës së ngushëllimit dhe mbështetjes nga ju? Nëse po, cila?

3. A mund të mbani mend kohët kur keni dështuar për t'u ofruar mbështetje dhe ngushëllim fëmijëve atëherë kur kishin nevojë? A është e mundur të ndreqet? A duhet t'i kërkonit falje ndonjërit prej fëmijëve?

4. Më poshtë mund të radhisni një listë me mënyrat si të filloni t'u ofroni fëmijëve mbështetje dhe ngushëllim. Pastaj rrethoni një hap që do ta ndërmerri këtë javë.

* Mendoni për raste të veçanta që ju prijnë në të ardhmen e fëmijëve tuaj, në çfarë rastesh do të kishin ata më shumë nevojë për mbështetje dhe ngushëllim? Çfarë mund të bëni tani për t'u përgatitur për atë kohë?

Ati si strehë

Denisa, vajza e njërës prej miqve të mi, pati njëherë një keqkuptim me një prej mësuesve të vet në shkollën e mesme. Mësuesja e akuzonte për diçka që vajza s'e kishte bërë dhe pavarësisht se s'kishte pasur asnjë fakt lidhur me këtë, ajo e kishte kërcënuar se do ta ndëshkonte seriozisht. Edhe pse Denisa këmbëngulte për pafajësinë e vet, mësuesja vazhdoi edhe më keq me ndëshkimin. Dhe në fund, Denisa kërkoi të atin.

– Dua t'i telefonoj tim eti! – këmbënguli ajo me frikë dhe e lënduar. – Pikërisht këtë do të bëjmë tani, – tha mësuesja, e bindur që babai i saj do të ishte i inatosur dhe në siklet nga faji i supozuar i së bijës. Mësuesja e çoi Denisën në zyrën e shkollës dhe qëndroi në krah të telefonit kur Denisa i telefonoi të atit dhe i shpjegoi situatën.

– Po vjen! – tha Denisa përmes lotësh duke mbyllur telefonin.

Vetëm brenda pak minutave babai i Denisës erdhi në shkollë dhe u ul në zyrë bashkë me të bijën dhe mësuesen. Pasi kishte marrë një

shpjegim të shkurtër të asaj që kishte ndodhur nga e bija përmes telefonit, ai i kërkoi mësueses t'i tregonte më shumë. Dhe ajo i tregoi me zemërim dhe duke u mbrojtur.

Në fund, babai i Denisës u ngrit në këmbë: – Dëgjova mjaft, – tha ai. I hodhi krahun në qafë të bijës dhe me butësi i tregoi mësueses se kishte akuzuar personin e gabuar dhe se ai nuk do të toleronte asnjë lloj ndëshkimi kundër së bijës. Pastaj ai doli me Denisën për krah dhe i kërkoi asaj të priste derisa ta përfundonte bisedën me mësuesen.

Ai u kthye në zyrë dhe i shpjegoi mësueses pse ishte aq i sigurt për pafajësinë e së bijës, duke i treguar asaj se ishte e nevojshme t'i kërkonte falje. Kur doli në korridor, e pa sërish të bijën të dëneste,

– Çfarë ka? – pyeti ai i turbulluar, sepse kishte besuar që gjithçka ishte lënë pas tashmë.

Denisa, që mezi po i mbante lotët buzëqeshi dhe ia hodhi të atit duart në qafë: – Faleminderit që erdhe, babi, – i tha ajo. Ti je mbrojtësi im.

Ky baba i komunikoi së bijës diçka shumë të rëndësishme atë ditë. Mund të jetë dukur si një pjesë e rutinës së tij të përditshme, por nga ajo ditë ai fitoi mirënjohjen e së bijës si streha e saj.

Ai incident krijoi sensin e sigurisë tek ajo, aq sa ajo mund të thoshte: «Mund të mbështetem tek im atë, mund të shkoj tek ai kur jam në telashe; ai do më mbrojtë, si të ishte avokati im».

Një qëndrim i tillë i një fëmije është shumë i rëndësishëm për baba-llarët e sotëm.

Shumica e të rinjve të sotëm e shohin të ardhmen e shoqërisë me frikë dhe pasiguri. Shumë prej tyre duket të kenë humbur shpresën. Ata ecin nëpër korridoret e

frikës dhe ankthit; gjashtë në dhjetë nxënës të shkollës së mesme pohojnë se i njohin shokët e tyre që kanë tentuar, ose bërë vetëvrasje dhe një në tre veta i njohin personat që sjellin armë në shkollë. Shumë prej tyre kanë shokë që janë përfshirë në sjellje të rrezikshme dhe të dëmshme; (si marrëdhënie seksuale para martesës dhe drogë). Kërkime të tjera tregojnë se përqind e të rinjve mendojnë se kjo botë s'ka të ardhme dhe përqind besojnë se do të jenë të ndikuar drejtpërdrejt nga ndikimet e asgjësimeve nukleare.

Të tilla frikëra i pushtojnë edhe fëmijët më të vegjël. Disa vjet më parë, Nadin Brozan raportoi në «*Nju Jork Tajms*» rezultatet e një studimi të bërë para njëzet vjetësh, që kishin të bënin me pesë frikërat kryesore midis adoleshentëve të shkollave tetëvjeçare: zhurmat e larta, dhomat e errëta, vendet e larta, kafshët e rrezikshme dhe të huajt. Ndërsa frikërat e fëmijëve të sotëm të së njëjtës moshë janë humbja e prindit nga divorci, të mbeten viktimë nga një grabitje, sulm, rrëmbim dhe nga sëmundja e kancerit.

Në një ambient të tillë, fëmijët kanë nevojë për një vend të sigurt, ku të strehohen nga zhgënjimet dhe rreziqet e kësaj bote. Ata kanë nevojë për strehë nga stuhia, një strehë ku të lehtësohen nga plagët dhe të gjejnë prehje.

Pikërisht ky dua të jem për fëmijët e mi. Dua të jem ashtu si është Ati im në qiell.

Një baba, një kështjellë.

Në kohën më të vështirë të jetës së vet, i ndjekur dhe persekutuar nga mbreti (babai i mikut të tij më të mirë) një ish-bari me emrin David, jetonte i fshehur. Ai kishte qenë hero kombëtar, ndërsa tani ishte i mërguar, kishte qenë pjesë e oborrit mbretëror, tani e zinte gjumi nëpër shpella, i kishte shërbyer mbretit me ndershmëri; tani këshilltarët e mbretit shpifën kundër tij.

Ai ishte vajosur si mbreti i ardhshëm i Izraelit; tani e ardhmja e tij dukej e errët. Ai i kishte shpëtuar mrekullisht jetën mbretit; tani i njëjti mbret kërkonte jetën e tij.

Problemet e Davidit ishin aq të shumta sa ai ndihej i vetëm në mes të një turme luanësh. Trembej si fëmija midis kafshëve të pangopura. Ndihej si i kërrusur deri në tokë nga barra e problemeve të veta. Midis ankthit të tij, Davidi u kthye tek Ati, Zoti i tij dhe ulëriu:

«Ki mëshirë për mua, o Perëndi, ki mëshirë për mua. Sepse shpirti im gjen strehë tek ti; gjej strehë nën hijen e krahëve të tu derisa të kalojnë fatkeqësitë. Unë do t'i thërras Perëndisë, shumë të lartit, Perëndisë që kryen çdo gjë për mua.

Psalmi 57:1-2

Dhe vetëm pas pak vjetësh Davidi u bë mbret, duke mundur të gjithë armiqtë dhe mbledhur mbretërinë në një pas gjithë trazirave, duke fituar kështu respektin e gjithë popullit. Po si u realizuan të gjitha këto gjëra?

Davidi na e tregon përgjigjen në një psalm të mëvonshëm:

Të dua, o Zot, forca ime. Zoti është kështjella ime, fortesa ime dhe çliruesi im. Perëndia im, shkëmbi im ku gjej strehë, mburoja ime, fuqia e shpëtimit tim, streha ime e lartë.

Psalmi 18:1-2

Ky lloj Ati është Zoti ynë! Ai është mbrojtësi ynë, kalaja jonë e fuqishme, streha jonë, vendi ynë i fshehtë:

Zoti do të jetë strehim i papushtueshëm për të shtypurin, një strehim i papushtueshëm në kohë ngushtice Psalmi 9:9

Zoti i ushtrive është me ne, Perëndia i Jakobit është streha jonë. Psalmi 46:7

Ai është hiri im dhe kështjella ime, streha ime e lartë dhe çliruesi im, mburoja ime në të cilin gjej strehë, ai që popujt i vë nën sundimin tim.

Psalmi 144 :2

O Perëndi, sa e çmuar është mirësia jote! Prandaj bijtë e njerëzve gjejnë strehë nën hijen e krahëve të tu.

Psalmi 36:7

Modeli i Atit tonë është burim fuqie dhe sigurie për ne si fëmijët e tij. Në të mund të gjejmë siguri nga sulmet dhe presionet e kësaj bote. Zoti është streha jonë.

Ky lloj ati dua të bëhem dhe unë. Oh, e di që s'mund të bëhem i plot- fuqishëm, ose i gjithëdijshëm si Ai! Dua që fëmijët e mi t'i kthejnë sytë së pari dhe gjithmonë nga Ati i tyre qiellor; dhe, ashtu siç është Ati qiellor, kalaja dhe streha ime të bëhet e njëjtë edhe për fëmijët e mi.

Dua t'i ngaj Atit tim. Dua të jem strehë për fëmijët e mi, dua që ata të dinë se është një vend i sigurt, ku mund të shkojnë përherë; dhe ky vend është aty pavarësisht ku është babai i tyre. Dua që ata të vijnë tek unë si streha e tyre nga stuhitë e jetës, nga sulmet e shoqërisë, nga presionet e moshës, nga zhgënjimet, nga talljet e të tjerëve dhe frikërat. Nëse ata ndihen të sigurtë që më parë te babai i tyre, shumë shpejt do të fillojnë të ndihen të tillë dhe brenda vetes, pavarësisht ku janë. Do të jenë më të prirur

të zhvillojnë konceptin dhe ndjesinë e sigurisë dhe vlerësimit në vete, nëse do ta dinë që pas tyre është dikush gati për t'i strehuar dhe mbështetur.

Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe kjo është një detyrë e pamundur për t'u arritur vetëm me forcat e mia. Do të kisha dështuar. Po unë s'jam vetëm, madje as ju. «Mund të bëj gjithçka përmes Krishtit që më forcon». (Fil 4:13) Vlen edhe për ju, ndërsa mbështeteni në Perëndinë Atë me anë të Frymës së Shenjtë duke e lejuar Atë të punojë në ju me strategji të tilla si:

Të përgatitesh për kohën e krizave

Një ditë e mora unë Kellin nga shkolla. Ndërsa po kalonim parkingun e mbushur me makina, ajo më pyeti: – Babi, ç'mendon për Xhim Beker?

Në atë kohë tele-ungjillorët Xhim dhe Tami Beker ishin bërë tema e lajmeve me skandalin që kishte shkatërruar televizionin e tyre PTL dhe që ishte bërë dhe temë diskutimi në klasën e vajzës sime.

Kisha dëgjuar opinionin e shumë pastorëve dhe të krishterëve të tjerë lidhur me këtë skandal, të tilla si: «E neveritshme», «Ata duhet të mos lejohen më në shërbesa», «Ai s'mund të jetë i krishterë». I kisha kuptuar këta njerëz me ndjesinë e zhgënjimit që shprehnin këto thënie, por ndërkohë kuptova dhe diçka tjetër. Më kishte ardhur shumë keq nga opinione të tilla të pastorëve, por më shumë nga ajo që mund t'u ishte komunikuar të rinjve në kishë: «Nëse gjendeni në telashe, as që ta mendoni të vini tek unë!» dhe në veçanti, të gjitha vajzave të reja në

kishë: «Nëse mbeten shtatzënë jashtë martese, do t'ju ndëshkoj pa m'u dridhur syri». Dhe prindër të krishterë që u prononcuan lidhur me çështjen e Xhimi Bekerit rrezikuan t'u komunikojnë fëmijëve të tyre; «Ne do jemi me ju derisa të mos përfshihen me drogë, pije alkoolike, seks, apo telashe të tjera si këto».

Ndaj si mund t'i përgjigjesha pyetjes së Kellit? Si mund t'i tregoja vajzës sime trembëdhjetë vjeçare për ndëshkimin e mëkatit, por jo mëkatit?

U gëlltita, frenova buzët dhe thashë; – «Zemër, ajo që bëri Xhim Beker ishte e gabuar, mëkat.» I shpjegova pse ishte mëkat që Xhim Bekerit të takonte Xhesika Hanin në një dhomë moteli dhe pastaj

shtova: – Por, Kelli, dua të kuptosh diçka. Zoti e do Xhim Bekerin njësoj sa të do ty dhe mua dhe Krishti vdiq për të njësoj si për ty dhe për mua. Dhe nëse Zoti nuk e fal dot Xhim Bekerin, atëherë s'e bën dot as për ty dhe për mua. Ndërsa ecnim përmes parkingut drejt makinës sonë, Kelli nuk tha gjë për pak minuta, ndërkohë që mendja ime sillej rrotull nga gjithçka që kisha dashur t'i thosha. Në fund mora frymë thellë dhe i thashë: – Zemër, le ta marrim më shtruar. Nëse ti mbetesh shtatzënë e imagjinon dot si do të ndihesh unë? Sikur të më kishin kryqëzuar. Gjysma e njerëzve në kishën tonë do të më ishin [2](#) drejtuar mua. Në mbarë vendin, drejtuesit e krishterë, redaktorët

e librave, reporterët, ungjillorët, – të gjithë do të më kishin kërkuar mua. Kelli pa nga unë me sytë e kaltër të shqyer nga shqetësimi: – E di, babi.

– Por dua të dish diçka, zemra ime, – i thashë unë. – Dhe nëse një ditë ndodh kështu, unë s’do të shqetësohesha për atë që do të thoshin këta njerëz. Do t’u ktheja shpinën, por kurrësi s’do ta bëja këtë me ty. Do të të merrja në krahë dhe do ta kalonim gjithçka bashkë.

Në ate moment ime bijë trembëdhjetëvjeçare lëshoi librat e saj m’u në trotuarin e parkingut duke qarë dhe pasi më hodhi duart në qafë më tha: – Po, babi, e di që do ta bëje!

Ndoshta disa njerëz mund të mendojnë që po merrja një rrezik të madh përsipër, sepse Kelli mund të mendonte: «S’ka ndonjë problem nëse mbetem shtatzënë se babi do të më dojë pavarësisht kësaj». Por të them të drejtën, nuk u shqetësova më shumë për këtë se doja t’i tregoja se unë isha streha e saj, jo thjesht nëse do të mbetej shtatzënë, por në çdo moment. Dua që ajo bashkë me motrat dhe vëllanë e saj të dinë që do jem mbrojtësi i tyre, vendi i tyre i sigurt, streha e tyre në kohë stuhish.

Të jesh vigjilent dhe i vëmendshëm

Në një prej librave ku bashkëpunëtorë kisha Norman Uejkfildin ai tregoi për rëndësinë e të qenit vigjilent:

Djali im, Joeli, (në atë kohë në klasën e tetë) u kthye nga shkolla i irrituar. Isha në kabinetin tim të punës kur e dëgjova të përplaste dyert dhe të fliste vrazhdë me të tjerët. Gjatë darkës ai ishte nevrik dhe sarkastik. Më vonë, dëgjova sërish nga kabineti i punës të përplaste derën e dhomës së tij të gjumit me zemërim.

Dukej qartë që diçka e rëndësishme mund ta kishte shqetësuar. Katër orët e fundit ai dukej shumë i mërzitur. Shkova në dhomën e tij dhe i thashë: «Joel, vura re se erdhe nga shkolla i zemëruar. Mos ka ndodhur ndonjë gjë në shkollë për të cilën do të doje të flisnim bashkë?»

Djali nisi të qante (dhe sinqerisht m’u duk vetja idiot që s’e kisha kapur problemin që në fillim), zbrazti duke më treguar sa ishte lënduar nga një incident që kishte ndodhur në klasën e tij. Ishte keqkuptuar dhe ndërje në siklet para mësueses. Duke mos ditur si të vepronte me këtë që kishte ndodhur, ai kishte filluar të sillej në atë mënyrë kur ishte kthyer në shtëpi. ... I jam mirënjohës që më hapi sytë.

Të jesh strehë si baba kërkon të jesh i vëmendshëm dhe vigjilent. Do të thotë të jesh i ndjeshëm ndaj fjalëve dhe gjendjeve të ndryshueshme shpirtërore të fëmijëve, të mbash shqetësimet dhe problemet e tyre. Të njohësh shokët e tyre., ndoshta dhe të shohësh me ta emisionet që u pëlqejnë të shohin, madje (obobo!) të dëgjosh muzikën e tyre.

E di që një baba që punon në shtëpi, e bën zakon të përshëndesë fëmijët e vet kur kthehen nga shkolla. Pastaj që ata të vijnë në zyrën e tij të punës dhe pasi të ulen në prehrin e tij (edhe pse janë adoleshentë!) t'i tregojnë si ia kanë kaluar në shkollë. Kjo lloj rutine nuk kërkon veç më shumë se minuta nga koha e tij e punës, por i jep mundësi atij t'i njohë fëmijët në themel, duke i lejuar që të shkarkojnë gjithë shqetësimet e tyre tek ai dhe së bashku të festojnë gjërat e gëzueshme që kanë ndodhur atë ditë në shkollë.

Kjo teknikë mund edhe të mos funksionojë për ju. Gjithsesi gjeni diçka që mund të funksionojë, diçka që do t'ju mbante vigjilentë dhe do t'ju ndihmonte të ishit të ndjeshëm ndaj gjithçkaje që kalojnë fëmijët tuaj.

Të mësosh të dëgjosh

Një biznesmen i suksesshëm, i pakënaqur nga marrëdhënia e tij me të birin tetëmbëdhjetë vjeçar, shkoi te Normani për këshillim. Ai shpjegoi si i biri ishte i pamotivuar, i përfshirë në drogë dhe në marrëdhënie shka tërruese. Komunikimi atë-bir ishte tensionuar deri në pikën ku s'mbante më.

Normani i sugjeroi burrit që javën që pasonte ta çonte për drekë diku të birin. «Jo për ta ndëshkuar, apo predikuar!» – i shpjegoi Normani.

«Detyra jote është t'i tregosh se interesohesh për të. Dëgjoje!» Pas një jave biznesmeni u kthye dhe tregoi për çfarë kishte ndodhur.

– Si t'u përgjigj djali? – e pyeti Normani.

– Ai tha se gjatë gjithë drekës kishte pritur se mos i vinte ndonjë këpucë kokës! – nisi ai të tregonte. Djali kishte pritur që i ati ta korri gjonte, sepse kjo ndodhte gjithë kohën në marrëdhënien e tyre. Dhe kishte qenë befasi për djalin që i ati ishte aty për ta dëgjuar!

Baballarët që duan me të vërtetë të bëhen strehë për fëmijët e tyre duhet të zhvillojnë dhe përmirësojnë artin e të dëgjuarit. Shpesh, fëmijët tanë vijnë te ne duke lotuar, të tensionuar, në telashe dhe pa e treguar ende ata problemin që kanë, ne fillojmë me ndreqe, udhëzime, këshilla:

A s'jam përpjekur të të tregoja...?

Ç'kishte ndërmend...?

S'mund ta besoj që ke bërë këtë budallallëk

Do të bësh këtë tani...

Kjo është hera e fundit...

Nëse kemi bërë Lidhjen e Atit dhe po kërkojmë me lutje të reflektojmë imazhin e tij në atësinë tonë, së pari duhet të kalojmë kohë duke i dëgjuar për të marrë vesh gjithë historinë, ta frenojmë veten për të kritikuar a ndëshkuar dhe t'i lëmë fëmijët të

tregojnë shqetësimet pa frikën se ne do të nxjerrim që në fillim konkluzionet tona, ose do t'i ndëshkojmë.

Të flasësh të vërtetën me dashuri

Kur vijmë në vete si baballarë se komentet tona janë në shkallën një me dhjetë (një pozitive dhe dhjetë negative), atëherë mund të kuptojmë pa vështirësi pse fëmijët e kërkojnë strehën diku tjetër. Shumë baballarë, pavarësisht sa të përshpirtshëm, apo të vetëdijshëm janë, janë më shumë të prirur t'u komunikojnë mesazhe të mbushur me kritika, urdhra, apo kërkesa fëmijëve.

Ja pse është kaq e rëndësishme të vërejmë fjalët tona. Apostulli Pal na këshillon: «Mos lejoni që fjalë të pandershme të dalin nga goja juaj, por çfarë është e dobishme për ndërtimin e njëri-tjetrit, sipas nevojave në mënyrë që t'u sjellë dobi atyre që dëgjojnë».(Efes. 4:29)

Çfarë themi zakonisht përfshin dy kategori: 1) komunikim kritikues, shkatërrues, të dëmshëm, ose 2) komunikim pozitiv, pohues dhe të dobishëm.

Mendoni sikur jemi bashkë në një dhomë, ju më shihni dhe përpiqeni të prezantoni veten. Ecnë drejt meje, zgjasni dorën dhe nisni të thoni: «Përshëndetje, Xhosh, unë jam...» Para se ju të nxirrni fjalët, unë ju godas me një shuplakë fytyrës. Ju ziheni në befasi, i fyer dhe i turbulluar nga sjellja ime e çuditshme. Pas disa minutash tërhiqeni në qoshe duke menduar ç'të bëni. Në fund, përpiqeni dhe njëherë, tani me më shumë kujdes, duke parë sinjalet që mund të vijnë nga ana ime. Dhe përsëri dora ime ngrihet t'ju qëllojë. *Dhe sa herë të tjera do të përpiqeni të më afroheni?*

Fjalët tona janë po aq të rënda sa veprimet tona. Fjalët lëndojnë, lënë plagë. Nëse i sulmojmë fëmijët me fjalë kritike, sarkastike, ndëshkuese dhe neveritëse, ne u kemi mbyllur kështu derën atyre për të ardhur te ne kur janë në nevojë. Nëse nga ana tjetër, «ne themi të vërtetën me dashuri», duke u përballur me çfarëdo problemi në mënyrë pozitive, ne u jemi afruar fëmijëve tanë si vende strehuese për ta.

Të jesh pranë fëmijëve

Në Lojërat Olimpike të vitit 2 në Barcelonë u paraqitën momentet më mbresëlënëse në historinë e sportit.

Derek Redmondi nga Britania e madhe ishte afër plotësimit të ëndrrës së jetës së tij; të fitonte Medaljen e Artë në Lojërat Olimpike. Ai kishte fituar të drejtën e pjesëmarrjes në gjysëmfinalen e vrapimit të 00 metrave dhe në momentin kur pistoletat qëllloi për fillimin e vrapimit, Derek u sul me një fillim të mbarë. Ai po bënte vrapin e jetës së vet dhe ja ku dukej edhe kufiri i finishit, por papritur ndjeu dhimbje në

këmbën e djathtë. Ra me fytyrë në pistë, me gjurin e dëmtuar rëndë. Gara për Derekun përfundoi këtu.

Ai u ngrit me dhimbje në dhëmbë para se skuadra mjekësore të mbërrinte në vend. Edhe pse të gjithë vrapuesit kishin dalë para tij, ai nisi të ecte para, midis lotëve të dhimbjes dhe zhgënjimit për të përfunduar garën. Befas një burrë çau gardhin e rojave dhe vrapoi në pistë.

Ai shkoi te Dereku dhe e përqafoi: «S'ke pse ta bësh!» – i tha Xhim Redmondi të birit të mbytur në lot. «Po, do ta bëj», – iu përgjigj Dereku.

– Epo atëherë, – ia ktheu i ati, – do ta përfundojmë bashkë këtë garë!

Babai i Derekut e mbërtheu të birin për shpatullash dhe u drejtuan për nga finishi, duke ia bërë me shenjë rojës që priste në këmbë. U nisën të dy me mundim dhe koka e Derekut mbështetej herë pas here në supin e të atit, kështu e kryen gjithë pjesën e rrugës deri në finish në korsinë e Derekut.

Turma e ndoqi me habi këtë skenë të pazakontë. Dhe një nga një, u ngritën në këmbë dhe nisën të brohorisnin në mbështetje të djalit të vendosur dhe babait përkrahës.

Sa herë kam qëndruar në vendin e spektatorit në vend që të shkoja te fëmijët e mi për t'i përkrahur? Më duhet të rrëfej që kanë qenë jo të pakta rastet, por të bëhesh strehë për fëmijët do të thotë të vraposh në krah të tyre, jo t'i mbash mbi shpinë, por të jesh në krah të tyre kur ata përballen me zhgënjimin dhe dhimbjen. Do të thotë njësoj sikur të thuash: «Ne do t'ia dalim bashkë!» Do të thotë të injorosh vështrimet e ngulitura të turmës dhe opinionet kritike. Mund të jetë e rrezikshme personalisht, apo jo e mençur profesionalisht, por do të ishte e vlefshme nëse dëgjon nga goja e fëmijëve të tu: «Faleminderit, babi, ti je mbrojtësi im».

Të vësh kufij të shëndetshëm

Të bëhesh strehë për fëmijët e tu nuk do të thotë të bëhesh prind tepër tolerant, që s'ë thotë kurrë një fjalë ndreqjeje, apo të disiplinojë. Madje është e kundërta.

Një ditë kisha dalë shëtitje në rrëzë të malit afër shtëpisë sonë në Julian të Kalifornias, ku u përballa me një burrë që po udhëtonte mespërmes ShBA-së me një karrocë të mbyllur. Ai kishte ndalur të kulloste mushkat në një lëndinë aty afër dhe unë hapa një bisedë me të. Kuptova që ai kishte goxha përvojë me rritjen e kafshëve ndaj e pyeta: «Ku është më mirë të rritet bagëtia, këtu në kullota të hapura të parrethuara me gardhe, apo në vathë?»

Pa hezitimin më të vogël, ai m'u përgjigj: «Pa dyshim në kullota të rrethuara!»

«Pse? – e pyeta unë.

«Sepse kur kafshët futen në kullota të hapura si kjo, humbasin. Dhe shpesh sulmohen nga grabitqarët dhe kullota të tilla nuk janë të sigurta. Dhe, nëse i fut në vathë, atyre do t'u duhet të kërkojnë për ushqimin e tyre, sepse nuk mund të bredhin për ta

siguruar. Ndërsa, kur i fut në kullota të rrethuara me gardh, ato janë të mbrojtura dhe kanë ushqim të siguruar.»

Kjo bisedë më ofroi një analogji fantastike në Shkrimin e Shenjtë. Ati ynë i dashur na ka dhënë gjithçka që na nevojitet, kullotat me bar të njomë (Ps :2). Por ai na ka vënë dhe «gardhe» – Ligjin e tij të përsosur dhe të vërtetën që na bën të lirë në Krishtin (shih Jakobi 1:, Gjoni :). Kullotat e rrethuara me gardh nuk janë të mira vetëm për bagëtinë, por dhe për fëmijët. Fëmijët hedhin shtat brenda kufijve të shëndetshëm, kur prindërit e tyre nuk janë as autokratikë, as tepër tolerantë.

Një fëmijë kthehet tek i ati si tek një strehë mbrojtjeje, kur babai i vet ka ndërtuar kufij të shëndetshëm që komunikojnë interesim dhe përkujdesje në drejtimin e fëmijës pa ia plasur shpirtin këtij të fundit (shih Efes. :2). Prindërit janë përgjegjës për kufijtë e vendosur ndaj fëmijëve të tyre, kufij të vendosur mbi dashurinë e atit, pranimin dhe interesin e tij.

Të ndërtosh një sistem ndihmës

Kultura amerikane tenton ta paraqesë njeriun të lirë, një individ i vetë-mjaftueshëm që triumfon mbi sprovat. Shumë njerëz e kanë të vështirë të pranojnë problemet dhe nevojat e tyre dhe shumë të tjerë të kërkojnë ndihmë.

Por të bëhesh streha e fëmijëve të tu kërkon pjesëmarrjen e një sistemi ndihmës. Duhet të përfshijë gjithë komunitetin e krishterë. Është shumë e vlefshme të punosh bashkë me të tjerët që janë në një mendje me ty, kishën tënde, grupin tënd të të rinjve, me pastorin tënd, mësuesit e tu, me miqtë e tu, trajnerët e tu etj, – për të shkëmbyer burime, mendime dhe fuqi në ndërtimin e vendit të sigurt për fëmijët. Unë dhe gruaja ime kemi qenë fatlumë të bëheshim miq me Dik dhe Sharlotë Dein, ndërkohë që fëmijët i kishim ende të vegjël. Ne ishim fqinj me njëri-tjetrin dhe kështu kalonim goxha kohë së bashku, madje dhe pushimet i bënim bashkë. Bashkë shkonim në takimet e ndryshme në kishë. Familja Dei i merrte fëmijët e familjes Mekdauell në ekskursion dhe ne bënim të njëjtën gjë me fëmijët e tyre.

Kjo lidhje ndihme dha frytet e veta. Një prej fëmijëve të Dikut i tha njëherë atij: «Nëse s'do të isha fëmija yt, do të doja të isha i Xhoshit». Dhe një herë tjetër, kur e pyeta Hedhërin se kush ishte babai më i mirë

(përveç meje patjetër!) ajo u përgjigj: «Diku.» Ndihesha i paqtë brenda vetes që ishte dhe një tjetër «figurë atërore» në jetën e fëmijëve të mi tek i cili ata mund të drejtoheshin në kohë të vështira.

Pikërisht kjo lloj lidhjeje u dha fëmijëve të mi ndjenjën e sigurisë. Patjetër që dua që ata të vijnë së pari tek unë si streha e tyre, por na ndihmon të dyja palëve kur mendojmë se ka dhe të tjerë ku ata mund të shkojnë në raste krizash. Nëse ju nuk e keni ende një sistem të tillë ndihmues, filloni ta ndërtoni. Ftoni të krishterë të tjerë

për të punuar dhe lutur së bashku me ju për t'ia arritur këtij qëllimi. Pyetini fëmijët tuaj se kë do të zgjidhnin ata përveç jush që të shkonin për të folur në raste problemesh? Dhe mos u druaj t'u kërkosht miqve të tu si mund të përmirësohen për të qenë më të pranueshëm për fëmijët e tu, anasjelltas dhe me ju vetë.

Fëmijët tanë po rriten në një botë të mbushur me probleme, strese, kërkesa dhe shpesh dëshpëruese. Shumë prej tyre ndeshen me presione të pabesueshme – në shkollë, shtëpi, madje dhe në kishë. Shpesh ata mund të ndihen të turbullt, të zhgënjyer dhe të pasigurtë. Por nëse do të kenë një strehë – një vend të sigurt – ata do të ndihen të sigurtë, duke besuar se çfarëdo që të ndodhë, babai i tyre do të jetë me ta, duke besuar, mbrojtur dhe mbështetur.

2 Nëse fëmijët tanë e kanë këtë gjë – nëse dinë se mund të gjejnë strehë te babai i tyre – do të jenë më pak të prirur ta kërkojnë këtë strehë te droga, apo pijet e tjera alkoolike, në miratimin e bashkëmoshatarëve të tyre, apo në shoqëri të dyshimta. Ata do të jenë më të

nxitur të shkojnë te babai në raste telashesh, duke i besuar atij. Ata do të jenë më të fortë t'i shpëtojnë furtunës që turfullon rreth tyre. Dashtë Zoti që çdo fëmijë të gjejë strehë në Atin qiellor dhe në babanë evet!

1. A është në të vërtetë Zoti strehë për ty? Nëse po, pse? Çfarë tiparesh të Zotit të bëjnë që të shkosh tek Ai kur je në telashe? Si mund t'i pasqyrosh këto attribute në jetën tënde personale?

2* Planifiko të dalësh për drekë ose darkë me secilin nga fëmijët e tu këtë javë dhe bëj atë që përshkroi Norman Uejkfildi në këtë kapitull me babanë që pati probleme në komunikim me të birin. Bëje qëllim në vetvete që ta dëgjosh gjithë kohën. Bëj pyetje të tilla si: Çfarë problemesh ke patur këto kohë? Me kë flet më shumë kur ke probleme? A ndihesh rehat të vish tek unë për të biseduar për problemet e tua? Dhe a ka probleme që do të krijonin konflikt nëse flisnim bashkë?

3* Përcakto një problem ku mendon se ndonjëri prej fëmijëve të tu ka nevojë pikërisht tani. Çfarë do të bëje të «rrije krahas» tij dhe ta mbështesje?

4. Çfarë sistemi tjetër ndihme (përveç mamit dhe babit) kanë fëmijët e tu? A ka të tjerë në jetën e tyre me të cilët ata do të flisnin të sigurtë për problemet e tyre? Nëse s'e di, pyeti fëmijët. Nëse ata të përgjigjen jo, mendo si mund ta forcosh sistemin e ndihmës së tyre.

* Në hapësirën më poshtë (ose edhe diku në një letër mënjane) bëni një listë me strategjitë që duhet të përdorni për t'u bërë streha e fëmijëve të tu. (Jini sa më konkretë!)

Babai si shok

Majku tridhjetë vjeçar rrinte para altarit të kishës në varrimin e babait të vet i mbytur në lot. Shumë njerëz i kishin dhënë tashmë lamtumirën e fundit njeriut që kaloi tridhjetë e pesë vjet në shërbesën e Zotit para se të lëshohej në duart e sëmundjes së kancerit në moshën pesëdhjetë vjeçare. Në lamtumirën e tyre u lavdërua dashuria e tij për Zotin, vepra e tij në punën me njerëzit dhe dashuria e tij për familjen. Secili prej folësve kishte qenë i sinqertë, duke ofruar kujtime të përzemërta të një jete të jetuar më së miri. Por fjalët e shoqëruara me lot të Majkut treguan diçka që askush tjetër nuk mund ta bënte.

Ai tregoi si ishte ulur në prehrin e të atit si fëmijë, duke dëgjuar histori njëra pas tjetrës. Si i mësoi biçikletën. Udhëtimet e tyre për pesh kim, apo dyluftimet në basketboll. Ndeshjet e tenisit, apo lojën e sërfit në plazh. Dhe në vazhdim gëzimi i atit të tij kur djali i tij i vetëm u diplomua dhe pastaj kur u martua dhe më pas, kur fitoi të drejtën e studimit. Dhe bisedën e tyre të gjatë kokë më kokë në shtratin e spitalit para se i ati të vdiste.

– Ai ishte shoku im i ngushtë – tha Majku me zërin e dridhur nga emocionet. – Do të më mungojë im atë, por mendoj se më shumë do të më mungojë shoku im i ngushtë. Në kontrast me këtë fjalë të fundit të lamtumirës më vjen ndërmend historia e gruas së zv.presidentit të një kompanie gjigante ndërtimi. Ajo më kishte dëgjuar gjatë bisedës sime në një kishë lokale dhe më vonë, kërkoi të më takojë ndërsa isha në restorant. Ndërsa më shtrëngoi dorën, ajo nisi të qante:

– «Më duhet t’ju tregoj diçka», – tha me ngurrim. «Im shoq sapo ka vdekur. Ai ishte njeriu i vitit për pasurinë që kishte, ka udhëtuar në gjithë botën në ndërtim të shumë gjërave, por nuk kaloi kurrë kohë me fëmijët, edhe atëherë kur gjendej në shtëpi. Gjithë fëmijët u kthyen kundër tij dhe kur u rritën, as që donin të dinin për të. Ai më tregoi në shtratin e vdekjes së po vdiste si burri më i dëshpëruar në botë. Ai më tha: “Fitova prestigjin, por humba familjen”».

S’kam pse t’ju tregoj këtu se kujt prej dy baballarëve do doja t’i ngjaja. Dua të jem si babai i Majkut, që kënaqet në shoqërinë e fëmijëve të vet. Dua të jem ai lloj babai, vajza e të cilit i telefonon në zyrë «thjesht për të biseduar», bijtë e të cilit e zgjedhin si shoqëruesin e parë në dasmën e tyre. Një baba që është shok me fëmijët e tij.

Një detyrë e tillë s’është e lehtë për shumë burra. Oh, ndoshta më e vështirë se e një a dy brezave më parë! Xherri Adler, tregon në revistën

Newsweek:

«Në

moshën -vjeçare, Robert Blumënfeld, një biznesmen nga San Françisko, kujton me

saktësi herët që i ati kishte luajtur basketboll me të (veç një herë!) dhe çfarë kishte thënë në diplomimin e tij, me fletë lavdërime: që disa moshatarë të tij -vjeçarë ishin regjistruar në skuadrën e bejzbollit me 0 mijë dollarë. Den Kenigshofer, një tjetër -vjeçar me profesionin inxhinier në Chapell Hill N.C kujton: “As që më kujtohet të më ketë thënë ndonjëherë im atë se më do. ” (edhe pse ishte i sigurt se i ati e kishte dashur në mënyrën e tij të heshtur të ndikuar dhe nga epoka e viteve 0- të). David Uajnshtajn, një ekonomist i diplomuar në Harvard, di vetëm ku ka qenë ati i tij kur ai ka lindur, vjet më parë. Ai ishte në zyrë atë ditë për të shkuar vetëm një ditë më pas (ishte herët ende!) për të parë djalin e lindur!...»

Ndoshta s'mund të jemi si këta baballarë, por shumë prej nesh vazhdojmë të mundohemi në keqkonceptimin e pafund të të qenit baba. Disa prej 2 nesh krijojnë iluzionin se mashkulli ideal është me «M» të madhe, një njeri i fortë tërë muskuj që s'ka nevojë për askënd. Disa të tjerë kanë trashëguar qëndrime të tilla si: «burrat punojnë, gratë kujdesen për fëmijët në shtëpi.» Dhe disa të tjerë mendojnë që të jesh shok me fëmijën

tënd është shenjë dobësie. Të tjerë tentojnë të mendojnë se puna jonë si baballarë është të ushtrojmë forcë dhe autoritet mbi gratë dhe fëmijët. Disa të tjerë ndihen nervozë të kenë marrëdhënie intime, apo dhe të kenë frikë prej kësaj. Disa të tjerë sinqerisht, as që e dinë si të bëhen shokë me fëmijët e tyre, sepse asnjëherë s'e kanë pasur nga baballarët e tyre këtë gjë. Pavarësisht sa e varfër, e largët, apo e mangët ka qenë marrëdhënia me baballarët tanë, ne tashmë e kemi një model të atit si shok dhe ky model patjetër që gjendet në Atin tonë qiellor.

Çfarë shoku kemi!

Ashtu siç e dimë prej karakterit dhe natyrës së Zotit se çfarë është e mirë dhe e keqe, po ashtu ne marrim nga ai standardin e atësisë dhe ky standard përfshin dhe të qenit shok me fëmijët.

Gatishmëria dhe dëshira e tij për të pasur shoqëri me fëmijët e Tij është shfaqur në bashkëveprimin e tij me gratë dhe burrat gjatë epokave të ndryshme. Abrahami (besimi i të cilit u shpërblye nga Zoti si «ati i shumë kombeve») është përmendur në gjithë Biblën si miku i Zotit:

A nuk ke qenë ti, Perëndia ynë, që ke dëbuar banorët e këtij vendi përpara popullit tënd të Izraelit dhe na e ke dhënë neve, pasardhësve të mikut tënd, Abraham?

2 Kronikave 20:7

Por ti Izrael, shërbëtori im, Jakob, ti je populli që kam zgjedhur, pasardhësit e Abrahamit, mikut tim.

Isaia 41:8

Kështu u përmbush Shkrimi që thotë: «Edhe Abrahami i besoi Perëndisë dhe kjo iu numërua për drejtësi», dhe u quajt miku i Perëndisë.

Jakobi 2:23:

Kur izraelitët ndërtuan Tendën e shenjtë në shkretëtirë dhe Moisiu hyri në këtë tendë për të adhuruar dhe rrëfyer para Zotit, reja që personifikonte praninë e Zotit do të qëndronte përpara hyrjes së Tendës së shenjtë. Në momente të tilla në Bibël thuhet:

i i fliste Moisiut ballë për ballë, ashtu si një njeri i flet mikut të tij.

Eksodi 33:11a

Kur Zoti foli nëpërmjet profetit Samuel dhe i tregoi Saulit, mbretit të parë të Izraelit, se ai e kishte humbur pushtetin mbretëror dhe mbretërinë, Samueli njoftoi dhe për ardhjen e mbretit të ri, Davidin, miqësia e të cilit me Zotin tregohet qartë:

Fjalja që Samueli i drejtohet Davidit – një njeri sipas zemrës së Zotit, – tregon një lidhje të rrallë, një miqësi të veçantë dhe të ngushtë.

1 Samueli 13:14

Dhe

ashtu si Abrahami, Moisiu dhe Davidi, edhe ne kemi nder ta thërrasim Atin tonë shok. Ati ynë qiellor është shok për fëmijët e tij. Ai është gjithmonë i gatshëm për ne dhe mezi pret të kalojë kohë me ne. Ai di si të na shfaqet, na njeh dhe kërkon që ne ta njohim më shumë. Ai kënaqet me shoqërinë tonë, zbavitet me të qeshurat tona, shkëlqen në lavdet tona dhe gëzohet në fitoret tona.

Është e rëndësishme të theksosh faktin që Zoti ka vendosur të jetë midis të qenit Atë dhe shok, ai nuk e neglizhon njëren në favor të tjetrës, është ati ynë dhe kjo është në natyrën e tij. Ai është shoku ynë dhe ky është pasqyrim i natyrës së tij. Të jesh shoku i fëmijës tënd është pjesë e asaj që në të vërtetë është një baba.

Pikërisht ky lloj ati dua të bëhem. Baba dhe shok për fëmijët mi dhe që shoqëria ime me ta të jetë pasqyrim i atësisë sime. S' do ta sakrifikoj përgjegjësinë time si baba në përpjekje për të pasur shoqërinë me ta; Dhe pikërisht këtë e mësoj nga Ati qiellor. Nëse do të mundem t'i ngjaj sadopak Atit Qiellor, duhet të mbështetem në të ditë pas

dite nëpërmjet Frymës së Shenjtë, duke kërkuar ndihmën e tij për të forcuar miqësinë e vërtetë me fëmijët e mi.

Të jesh i gatshëm

Mendoni sikur jeni shok i ngushtë me bosin e një kompanie të madhe. Është e premtë dhe ju do të takoheni për pak, ndaj shkoni në zyrën e tij dhe i kërkonit sekretares nëse mund të flisni qoftë dhe për pak minuta me të.

– Më vjen keq, – ua kthen sekretarja, – por ai është tepër i zënë deri të martën që vjen. Duhet të vini sërish.

– Dëgjo, – i thoni ju me një buzëqeshje shfaqësuese në fytyrë, – nuk do t'i marr shumë kohë. Vetëm thuaji që dua patjetër ta takoj. Do të dojë vetëm një minutë.

Sekretarja i telefonon bosit dhe i bën të ditur që ju jeni aty. Ajo përmend emrin tuaj dhe ju dëgjoni zërin e bosit në lidhjen direkte që thotë: «S'dua të shqetësohem. Lëri takim për të martën që vjen».

Si do të ndiheshit nga ky ndryshim? Si do të reflektonte kjo përgjigje në miqësinë tuaj? A do të vazhdonit ta konsideronit ende shok të ngushtë? Përkundrazi, do të mendoni që vlerësimi që ju keni për miqësinë tuaj është i ndryshëm me atë të bosit.

Kështu ndihen fëmijët tanë kur ne si prindër nuk jemi të gatshëm për ta... Oh, patjetër që i di kohët kur nuk mund të lini përgjysmë atë që bëni. Patjetër që nuk mund të hidhni poshtë gjithçka vetëm për t'iu përgjigjur pyetjes së një fëmije, apo të luash me «partnerin» tënd. Por shumica prej nesh mund të bëhemi më të vlefshëm nga ç'jemi.

Isha në një moment shumë të rëndësishëm duke mbaruar dorëshkrimin për ta dhënë në afat kur Shauni, që ishte vetëm shtatë vjeç në atë kohë, m'u afrua. E ndërpreva pa nxjerrë fjalën e parë nga goja. «Jo tani, Shaun, – i thashë, – më duhet ta mbaroj këtë dorëshkrim.»

S'kaloi shumë që djali i zhgënjyer doli nga studioja kur hyri gruaja ime, Doti: – Zemër, ti gjithmonë do të kesh afate, por jo gjithmonë do të kesh një djalë shtatë vjeçar që ka nevojë për të kaluar kohë me ty.

Ajo kishte të drejtë dhe e dija. Pa asnjë ngurrim, ula lapsin, shtyva prapa karrigen e madhe dhe të rehatshme nga tavolina dhe nxitova drejt Shaunit.

Ky ishte një mësim mbi gatishmërinë. Mësova që miqësia ime me fëmijët kërkon jo vetëm vëmendje – duke i nxjerrë jashtë për një vakt mëngjesi, apo të shkojmë te lodrat bashkë, – por të jesh i gatshëm – të jesh aty me ta kur duan të flasin, t'i dëgjosh ose qoftë dhe të ndani disa momente heshtjeje në praninë e njëri-tjetrit.

Të jesh transparent

Fëmijët kalojnë shumë vështirësi ndërsa rriten. Nëse të rriturit që ata ndjekin si shembull duken të pagabueshëm dhe të përsosur – si perëndi – ata mund ta konsiderojnë veten inferiorë dhe t'i shohin vështirësitë si një mënyrë të treguari që po gabojnë. Të jetosh midis «perëndish» duhet të jetë vërtet frikësuese. Fëmijët tanë kanë nevojë për shoqëri me të rriturit, që janë të aftë për një transparencë të duhur.

Transparenca mund të jetë e duhur ose jo. Transparenca jo e duhur mund të sjellë një vetëshfaqje që është e dëmshme për fëmijët. Një baba që e qorton veten vazhdimisht, duke i dënuar veprimet e veta si budallallëqe, ose në mënyrë të përsëritshme numëron gjithë dështimet e veta, ai atëherë po praktikon transparencë jo të duhur. Ai po modelon një vetëvlerësim të ulët, e kjo forcon pasigurinë te fëmijët e tij. Fëmijët e shohin babanë si jo kompetent dhe më shumë gjasa ka që ata të mos shkojnë tek ai në kohë nevojë.

Transparenca e duhur lejon që fëmijët të shohin përbrenda babait të tyre. Ata dëgjojnë mbi përvojat e babait në moshën e tyre, zbulojnë si babai i tyre e perceptonte veten, burrërinë e tij dhe rolin e tij në jetë. Kjo lloj transparence i ndihmon fëmijët të fitojnë mençuri nga mënyra si i ka përballuar babai i tyre dështimet, sukseset, zhgënjimet, lavdërimin dhe kritikën. Transparenca e duhur përfshin edhe aftësinë për të shprehur ndjenjat. Shumë burra janë mësuar t'i ndrydhin ndjenjat në vend që t'i shprehin ato; lotët janë tabu për meshkuj të tillë. Por nëse mund të flasësh lirisht, qeshësh dhe të qash për gëzimet, zhgënjimet, frikërat dhe dëshirat, atëherë do t'i ndihmosh fëmijët të të njohin më mirë duke i lënë një derë të hapur miqësisë suaj.

Të bësh pyetje të hapura për përgjigje

Diçka që e kam pasur goxha të vështirë me fëmijët e mi është të bëja pyetje, që ta mbaja bisedën të gjallë, në mënyrë që ta njihnim më mirë njëri-tjetrin (në këtë mënyrë të thellojmë dhe miqësinë tonë.) E bëj këtë duke ngarë makinën. Duke ecuar, apo duke qëndruar në radhë me ta në bankë. Disa prej pyetjeve janë:

«Nëse do të mund të ndryshoje diçka në familjen tonë, si do ta bëje?

(shtrëngoji dhëmbët të mos përgjigjesh vetë!)

«Nëse do të ishte babai i kësaj shtëpie, çfarë do të bëje ndryshe? (Edhe këtu shtrëngoji dhëmbët!)

«Kur je kënaqur me shumë?»

Kur je ndier në siklet për herë të fundit?

«Kur ke qarë më shumë?»

«Kur je ndjerë më shumë pranë Zotit?»

Nëse do të kishe një million dollarë, çfarë do të bëje me to? «Nëse do të kishe mundësi t'i bëje një pyetje Zotit, çfarë do të ishte?»

«Nëse do të mundeshe të vizitoe një vend të botës, ku do shkoje?»

Njëherë pasi kishim qenë në kopshtin zoologjik. patëm një udhëtim të gjatë kthimi në shtëpi. Pasi dolëm nga parkingu thashë: «Fëmijë, luajmë një lojë. Çfarë kafshe nga ato që patë sot do t'ju përshkruante më shumë si person? Dhe pse?»

Për nëntë kilometrat në vazhdim, unë dhe Doti morëm përshtypje të frikshme se çfarë mendonin fëmijët për veten e tyre. Kejti, që ishte vetëm tre vjeç e gjysmë në atë kohë, mendonte se ishte si arush.

– Pse, – e pyeta unë.

– Sepse dua të jem gjithmonë e përqafuar, m'u pergjigj ajo.

Kejti ishte ulur në ndenjësën e pasme kështu që hapa krahun për të ndalur makinën, dola jashtë dhe pasi i rashë rrotull për nga krahun i saj hapa derën dhe i dhashë një përqafim arushi para se të vazhdonim udhëtimin.

Të kultivosh interesa reciproke

«I ofrova fëmijës të dilnim bashkë sot,» – më tha njëherë një baba.

«Por ai as që u kënaq fare. E gjitha ishte dështim».

»Po çfarë bëtë?» – e pyeta unë.

– Mua më pëlqen golfi, – po shpjegonte ai, kështu që e çova në golf. Por aty kuptova që ai e urrente këtë lojë, ndaj kaloi si kaloi.

Ky baba donte të kalonte pak kohë me të birin, por sipas kushteve dhe komoditetit të tij. Ai do të kishte pasur më shumë sukses nëse do të kishte kultivuar interesa reciproke me të birin.

Interesat reciproke forcojnë miqësinë. Vini re miqësitë tuaja. Ndoshta keni «shokë golfi», apo «shokë peshkimi», ndoshta edhe shokë kolegë pune, apo vëllezër të «bërë» dhe shokë ushtrie. Ju mund të shkoni në shfaqje shitjeje makinash antike, ose në ngjarje të tjera që ju bashkojnë interesat, sepse këto interesa ju forcojnë miqësinë. Një baba i urtë fillon të ndërtojë interesa reciproke që kur fëmijët janë ende të vegjël. Një burrë që i lexon një parashkollori ndërton një pikë kontakti për të ndarë idetë e tij më vonë me të. Emocionohem sa herë fëmijët vijnë tek unë dhe më thonë: «Babi, duhet ta lexosh këtë libër; mendoj se do të të pëlqejë».

S'është asnjëherë vonë të kultivosh interesa reciproke me fëmijët e tu. Kur im bir ishte rreth dhjetë vjeç, kishte interes për makinat sportive (dua të them pikërisht ato më të shtrenjtat; (Mazerasis, Lamborginis, Ferrari). Kur e shihja Shaunin të merrte fotot e këtyre makinave nga revista, apo gazeta, dallova që interesi i tij nuk ishte thjesht rastësor, ndaj dhe ideova diçka.

Nxora Faqet e Verdhë dhe zgjodha disa prej makinave më të mira në shitje në Beverli Hills. Dhe çdo agjenti shitjeje i dërgova një letër ku thuhej:

«Jam një baba i dëshpëruar, do të bëja gjithçka që të kaloja pak kohë me tim bir, por tani ai është shumë i dhënë pas makinave sportive. A do ishte e mundur nëse e merrja nga

shkolla dhe e sillja në pikën tuaj të shitjes për të bërë ca prova mbi ngarjen e këtyre makinave?»

Që në fillim u tregova se s'isha i interesuar të blija makinë dhe për habinë time asnjë nuk ma mohoi kërkesën. U telefonova dhe lashë takime dhe së bashku me Shaunin përshkuam 0 kilometra deri në Beverly Hills për të pasur një ditë të tërë me makinat sportive. Dhe çfarë dite ishte! Shauni shkoi për të bërë prova me shitësin, duke u «përpjekur» të ngiste të gjithë emrat e mëdhenj të makinave që mund t'ju vijnë ndër mend! Ndërsa ata ngisnin përmes dhomës së makinave, një djalë krenar do të më përshëndetëse me dorë nga dritarja e makinës.

Gjatë kthimit pata mundësi të flisja me tim bir mbi pasuritë, pronat dhe materializmin, por më shumë se kaq, na afroi më shumë duke i dhënë më shumë thellësi dhe gjerësi miqësisë sonë.

Të bësh edhe një përpjekje tjetër

Njëherë një gazetar e erdhi në shtëpinë tonë për të marrë një intervistë për një artikull reviste. Edhe pse ajo shkruante për një revistë të krish- terë, u duk qartë që po mendohej të nxirrte ndonjë gjë negative tek unë, që do ta ndihmonte të shiste më shumë kopje të revistës. Ajo u kthye nga im bir, atëherë tetë vjeç, që po na shihte dhe i tha: «Çfarë është diçka që s'të pëlqen te babai yt? – Asgjë, – ia ktheu Shauni

Ajo vazhdoi ta shtynte, por pa rezultat. Pastaj buzëqeshi dhe donte ta merrte me të mirë: «Duhet të kesh patjetër diçka që s'të pëlqen te babai yt!»

Në fund Shauni tha: «Po, s'më pëlqen kur ikën nga shtëpia me shër- bim».

Fytyra e gazetares shkëlqeu me shprehjen e atij që ka gjetur diçka me vlerë për ta bërë artikullin e bujshëm.

Pas intervistës ndërsa ajo po largohej, i përmenda që një gazetar i ndershëm duhej ta pyeste dhe për gjërat që im bir pëlqente tek unë. Pas disa përpjekjeve të saj për të rrëshkitur nga kjo situatë, Shauni ndërhyri: [2](#)

«Ai kalon shumë kohë me mua».

Gazetarja u hutua nga kjo mospërputhje e dukshme. I tregova se përgjigjja e tim biri ishte ajo që kisha dëshiruar të merrja nga fëmijët e mi. (1) se kurrë s'do ta pëlqenin që babai i tyre largohej nga shtëpia (2) dhe gjithmonë do ta ndjenin pranë tyre duke kaluar kohë së bashku.

Ashtu si shumë baballarë të tjerë, përgjegjësitë e të cilëve në punë janë të ikin më së shumti me shërbim larg shtëpisë, shpesh herë përballem me vështirësinë për të manovruar me një orar të ngjeshur udhëtimesh me përgjegjësitë e mia familjare. Patjetër që s'kam qenë gjithmonë i suksesshëm, por kam bërë edhe një përpjekje tjetër për të ndërtuar miqësinë tonë me fëmijët. I marr me vete fëmijët sa herë që më jepet

mundësia, patjetër një nga një dhe i programoj më parë përgjegjësitë për t'u siguruar që të kem kohë mjaftueshëm me fëmijët e mi. Mundohem të telefonoj gati çdo ditë kur jam larg dhe të flas me secilin. Njëherë kur humba një nga ndeshjet e basketbollit të skuadrës së tim biri, Shaunit, për shkak të një udhëtimi pune në Rusi, e programova që t'i telefonoja gjatë kohës së pushimit me celularin që mori gruaja në ndeshje. Patjetër që s'ishte njësoj me të qenit atje i pranishëm dhe ndjeva që më mungoi madje më shumë, por kjo i komunikoi atij (dhe me sa u duk më vonë edhe shokëve të tij) sa i rëndësishëm ishte për mua! Kur kthehem nga udhëtimet, programoj kohë për secilin nga fëmijët (duke dalë me secilin për të ngrënë mëngjes jashtë, duke i marrë nga shkolla etj), duke e shfrytëzuar çdo minutë së bashku.

Të njihesh me miqtë e tyre

Një strategji tjetër në të qenit baba është të njohësh miqtë e fëmijëve të tu. Mua dhe Dotit na pëlqen shumë të ftojme në shtëpi miqtë e fëmijëve tanë. (Doti është e prerë për këto raste!) madje ne përpiqemi t'i ftojme rregullisht shokët e tyre në ekskursionet, apo piknikët që bëjmë familjarisht. Dhe shpesh më bie të bëj shoferin, sepse kam zbuluar sa shumë mund të mësoj vetëm duke parë përmes pasqyrës së pasme.

Për shembull, njëherë mora Kellin dhe shokët e saj për t'i çuar në ndeshjen e Lakersave dhe arrita të merrja një mësim magjepsës rreth asaj që ndodhte në miqësinë e vajzave adoleshente. Duke parë Kellin dhe shoqet e saj përmes pasqyrës, i vëmendshëm ndaj bisedës së tyre, po kuptoja çfarë u interesonte dhe sa mirë përshtatej Kelli me këtë. Doja të dija; A ka qenë ndonjëherë arrogante ajo? A është e ndrojtur midis shokëve? A bën përpjekje që të përfshihet gjithë shoqëria në bisedë? A është bujare? Loja e basketbollit më dha më shumë mundësi për ta parë

nga afër sesi Kelli bashkëvepronte me shoqet dhe më pas një ndalesë për të ngrënë akullore më dha më shumë të kuptuar rreth kësaj. Mbi të gjitha, ishte një mbrëmje e plotë, e tillë që na dha orë kënaqësie dhe edukimi për një baba që interesohet të jetë shok me vajzën e vet.

Të zhvillosh traditat

Kur fëmijët ishin ende të vegjël, si familje kishim një traditë, të cilën shumë prej miqve tanë e quanin të çuditshme. Pavarësisht kush ishte për vizitë ose çfarë po ndodhte, do t'u kërkoja të falur të pranishmëve dhe do të shkoja në shtrat me fëmijët.

Nëse do të kishim miq për darkë, do t'u thoshim që më parë se «Xhoshi s' do të jetë i pranishëm pas darkës», po ashtu edhe «Mos i telefononi Xhoshit në këtë orë, sepse është me fëmijët».

Këto dy orë e gjysmë na takonin mua dhe fëmijëve të mi. Ndonjëherë dilnim për shëtitje, ndonjëherë mundeshim në dysheme dhe herë të tjera lexonim së bashku.

Një prej aktiviteteve që na kënaqte më shumë ishte të bënim Jaçuzzi, që e kishim instaluar në dhomën tonë të gjumit. Por kishte raste që vetëm bisedonim, apo shihnim televizor, ndërsa qetësoheshim në Jaçuzzi. Një natë, sa për të qeshur, mbushëm një poçe shumë të madhe me kokoshka dhe i hodhëm në ujë. Ato vinin vërdallë vorbullës së ujit dhe secilit iu desh të zhytej në ujë. Dhe fëmijët e bënë temë bisede për gati një javë të tërë dhe gati sa s'dëgjova prej mësuesve dhe prindërve të tjerë për këtë çmenduri.

Tradita të tilla mund të jenë si rreze dielli, apo freski uji për miqësinë tuaj, për t'i ndihmuar ata të hedhin rrënjë dhe të rriten. Një familje sipas njohurive të mia di të praktikojë «një darkë progresive», duke blerë gjëra së bashku në shëtitoren pranë shtëpisë. Apo e bëjnë me radhë të shkojnë në çdo restorant në vendin e kompleksit të dyqaneve dhe pasi të kenë porositur gjënë më pak të shtrenjë në menu ta ndajnë në aq veta sa janë së bashku.

Çfarëdolloj tradite të ndjekësh, mos harroni që të jetë zbavitëse për gjithësecilin, të tilla që do të japin mundësi për biseda dhe bashkëveprim me njëri-tjetrin (p.sh duke parë një film, nuk është tradita më e mirë, sepse ka pak shanse për ndërveprim; një lojë golfi në miniaturë nga ana tjetër, mund të sigurojë një bisedë prej disa orësh).

Një baba që është i gatshëm dhe transparent me fëmijët e vet, që bën pyetje për të njohur dhe kultivon interesa reciproke me fëmijët, që kërkon të njihet me shokët e fëmijëve të vet, apo bën dhe një përpjekje tjetër për hir të miqësisë me fëmijët dhe që ndërton një traditë kuptimplotë në familjen e vet, është në rrugën e mbarë dhe të gjatë për t'u bërë si Ati ..., një baba dhe një shok.

Një baba i tillë ndërton më shumë se një miqësi me fëmijët e vet. Ai u siguron fëmijëve edukatën e duhur, modelin e një shoqërie të shëndetshme, duke u bërë si një «zjarrfikës» para miqësive të dëmshme dhe të rrezikshme. Ai i përgatit kështu fëmijët e vet në ndërveprim me bashkëmoshatarët e tyre, ndërsa kalojnë nivelin nga adoleshentë në të rritur. Kjo miqësi babafëmijë siguron besimin që pavarësisht ndryshimeve dhe sfidave të moshës, ajo do të jetë aty gjithmonë. Kjo shërben si stimul që fëmijët të zhvillojnë miqësinë me Zotin, me Atin e tyre në Qiell.

* Lexo këtë situatë dhe pyete veten: A është tipike për mua? «Përdori përgjigjet që jep për të vlerësuar miqësinë tënde me fëmijët e tu. Po Jo

☐ Menjëherë pas darkës, largohesh nga tavolina për të parë televizor, apo për të lexuar gazetën.

☐ Rastësisht të bie të flasësh me fëmijët për fëmijërinë tënde dhe u tregon mbi pasiguritë e tua si adoleshent dhe si i përballë ato.

☐ Kurrë s'ke qarë përballë fëmijëve të tu.

☐ Rregullisht ndalon në atë që bën në momentin që fëmijët kanë nevojë për ty.

☐ Gjatë darkës, një prej fëmijëve nis të tregojë mbi një incident që ndodhi në klasën e tij dhe ti ndryshon temë.

☐ Mezi pret të kalosh kohë me fëmijët e tu.

☐ As që ia ke idenë ndonjë interesi të përbashkët me fëmijët.

☐ Ke të paktën një aktivitet të veçantë që e bën me secilin prej fëmijëve të tu.

☐ Fëmijët e tu s'dinë asgjë lidhur me shqetësimet, dështimet, apo zhgënjimet e tua.

☐ Mund të përmendësh me emra tre prej shokëve më të mirë të fëmijëve të tu.

Përgjigjet e tua ndaj pyetjeve me numra tek tregojnë sferat ku duhet përmirësuar. Përgjigjet me po ndaj pyetjeve me numrat çift tregojnë sferat ku, siç duhet, ka përparësi.

Një baba që disiplinon

Një mëngjes hyra në kuzhinë dhe pashë që im bir, Shauni, kishte harruar të derdhte plehrat, detyrë që ai duhej ta kryente çdo ditë para se të shkonte në shkollë. Shauni ishte larguar tashmë për në shkollë. – Duhet të shkoj pas tij dhe ta kthej këtu për të derdhur plehrat, – i thashë Dotit.

– Xhosh, – m'u përgjigj ajo, – s'mundesh sepse për disa minuta fillon ora e parë në shkollë. Përndryshe do të gjobitet në shkollë për vonesë.

– Zemër, më duhet ta bëj, – këmbëngula unë. Ndaj mora makinën dhe u drejtova për nga shkolla kur pashë djalin të luante në oborr të shkollës. Zilja s'kishte rënë ende. Shkova tek ai. – Bir, – i thashë, – shko merr biçikletën dhe kthehu tani në shtëpi për të derdhur plehrat!

– Po, babi, – protestoi Shauni, – për pesë minuta bie zilja. S'mund ta bëj kur të kthehem nga shkolla?

– Jo, sepse e kishe për detyrë ta bëje para se të shkoje në shkollë, ndaj duhet ta bësh tani.

– S'mund ta bësh ti për mua, veç një herë?

– Jo, bir, – iu përgjigja, – është përgjegjësia jote.

Shauni u hodhi topin shokëve dhe tërhoqi këmbët zvarrë deri te biçikleta me supet e varura. Ndërsa e shihja të largohej me biçikletë, ndieva një zë të brendshëm të thoshte: Ç'loj babai je ti, Xhosh Mek dauell? S'do të të bënte gjë sikur t'i derdhje ti plehrat për djalin tënd sot, të paktën veç një herë.

Në kohën që Shauni kreu detyrën e vet dhe u kthye në shkollë kishin kaluar plot tridhjetë minuta nga rënia e ziles. Mësuesja e çoi te zyra e drejtorit, i cili, pasi e dëgjoi arsyen e vonesës nga Shauni e ktheu në klasë me një letër shfajësimi. Pastaj më telefonoi mua

– S'mund ta besoj atë që më tregoi Shauni, tha ai. – E dërgova me shfajësim në klasë se më bëri shumë përshtypje që një prind ta mbajë aq të përgjegjshëm fëmijën e tij. Nëse të gjithë prindërit do të silleshin kështu, puna jonë do të kishte qenë më e lehtë. Duke mbyllur telefonin, u ndjeva tepër i lehtësuar. Sepse deri në ato momente më ishte dukur vetja si «katallan» me veprimin tim me tim bir vetëm për plehrat, por fjalët e drejtorit më siguruan që kisha vepruar drejt.

Asnjë prej nesh nuk do të jetë baba «katallan». Por as të bëhet «leshko» para fëmijëve të vet. S'doja të tregohesha i paarsyeshëm para tim biri, por doja të vendosja disiplinë dhe që ai të pranonte përgjegjësinë e vet dhe të kuptonte ç'do të thoshte të jesh i përgjegjshëm. Dua që t'u ofroj drejtimin e duhur fëmijëve të mi në këtë pikë. Dua të bëhem lloji i babait që është Ati im Qiellor.

Disiplina e Atit

Zoti është i mirë. Ai është një Atë i dashur dhe i përsosur. Veprimet e tij s'janë asnjëherë të këqija, apo pa dashuri. Megjithatë, ai i disiplinon fëmijët e vet. Ai nuk disiplinon krahas mirësisë së vet, por disiplinon me mirësi, as krahas dashurisë, por me dashuri. Ai nuk disiplinon se është vetë i papërsosur, por sepse jemi ne të tillë. Shkrimet vazhdimisht tre- gojnë Atin qiellor si një At që disiplinon:

Prano, pra, me zemrën tënde, se ashtu si njeriu që korrigjon birin e vet, ashtu Zoti, Perëndia yt, të korrigjon ty.

Ligji 8:5

Sepse Zoti

qorton atë që do, si një baba djalin që atij i pëlqen.

Proverbat 3:12

Ai që i ofron korrigjimin dhe disiplinën e duhur fëmijëve të vet reflekton natyrën dhe karakterin e Zotit. Pikërisht për shkak të kësaj, Fjala e Zotit i thur lavde urtësisë së baballarëve që dispijlojnë fëmijët e tyre. (Prov 23:13, 29:17) dhe e konsideron tragjedi kur kjo nuk ndodh. (1 Sam 2:22-4:18, 1 Mbretërve 1:1-53)

Autori i Letrës drejtuar hebrenjve jep një pikëpamje të gjerë dhe të drejtë mbi disiplinën e përshpirtshme:

Biri im, mos e përçmo qortimin e Perëndisë dhe mos e humb zemrën kur ai të qorton, sepse Perëndia ndreq atë që do dhe fshikullon çdo bir që i pëlqen». Nëse ju do të duroni qortimin Perëndia do t'ju trajtojë si bij; sepse cilin bir nuk e korrigjon i ati? Por; po të mbeten të pandrequr; ku të gjithë u bënë pjesëtarë, atëherë jeni kopila dhe jo bij. Pastaj etërit tanë sipas mishit i patëm për të na ndrequr dhe i nderonim; a nuk do t'i nënshtrohemi dhe më tepër

Atit të shpirtave për të jetuar? Sepse ata na ndreqën për pak ditë, ashtu siç u dukej më mirë, kurse ai na ndreq për të mirën tonë që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së tij. Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, por hidhërim, por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij.

Hebrenjve 12:5b-11

Disiplina e përshpirtshme prodhon respekt dhe paqe dhe frytin e drejtë sisë.

Pikërisht këtë dua unë për fëmijët e mi! Për këtë shpresoj e lutem që do të prodhoj në ta, me ndihmën e Zotit, duke reflektuar vetë natyrën dhe karakterin e tij, duke u bërë një baba që disiplinon.

S'dua t'i disiplinoj fëmijët me zemërim dhe arrogancë; Por si Zoti më disipline mua, me dashuri (Hebr 12:6) S'dua ta praktikoj disiplinimin që ta bëj jetën time më të lehtë, por si Zoti e bën në mua për të mirën time dhe unë për të mirën e tyre. (Hebr 12:10) As që të ushqej egon time, apo të plotësoj nevojat e mia, por t'i disiplinoj ashtu si Zoti më disipline mua për të prodhuar frytin e drejtësisë dhe të paqes në ta. (Hebr 12:11) Dua të jem si Ati im qiellor.

Katër stile për atësinë

Janë katër stile themelore të atësisë që mund të gjenden midis baballa rëve.

- * Autokratik – «Ti do ta bësh sipas mënyrës sime!»
- * Tolerant – «Mund të bësh ç'të duash.»
- * I shkujdesur – «S'më intereson çfarë bën.»
- * Relativ – «Po të dëgjoj..., Kujdesem për ty..., dua të të kuptoj. Këtë herë do ta bëjmë kështu, sepse...»

Çdo stil zbulon një qëndrim të caktuar ndaj përdorimit të autoritetit prindëror. Babai autokratik është një «rregullator absolut», të cilin Fjalori Uebster e përkufizon në tre nivele. Së pari, është diktatori që «mban dhe ushtron një fuqi absolute»; në një nivel më të ulët dhe shumë pak të ndryshueshëm nga sjellja është autokrati, «pushteti i të cilit mbi të tjerët merret si i mirëqenë». Dhe në fund autokrati «kokëfortë, i plot-fuqishëm».

Kur të tre këta lloj prindërisht ushtrojnë pushtetin e tyre absolut mbi fëmijët, imponojnë çdo kufi dhe komunikojnë pak dashuri. Shumë «auto- kratë» u japin fëmijëve «shtëpi të mira». Ata u sigurojnë fëmijëve atë që është e nevojshme materialisht dhe kjo duket sikur plotëson gjithçka për një jetë normale, përveçse në shumicën e rasteve, pak mbështetje dhe dashuri.

Fëmijët që jetojnë në një ambient autokratik reagojnë në dy mënyra: luftojnë, ose humbasin. Kur fëmijët vendosin të humbasin, tipikisht tërhiqen mbrapsht dhe mësojnë të jenë të «bindur», të paktën në sipërfaqe, ndërkohë që brenda tyre vlojnë. Kurse fëmijët që luftojnë, janë ata që e shfaqin zemërimin orë e çast. Ata ankohen, ta përplaslin fjalën, të sulmojnë verbalisht, ose edhe fizikisht, sepse babai i tyre vendos rregulla në vend që të krijojë marrëdhënie, gjë që bën të lindë fryti i rebelimit. Një nga studimet e marrëdhënies prindër-fëmijë adoleshentë tregojnë se fëmijët e edukuar nga prindër autokratikë janë më të prirur t'i luftojnë prindërit e tyre, të paragjykojnë moshat më të vjetra, të kenë tendenca antisociale (me veprime të tjera që i shoqërojnë si vjedhje, mashtrime, grindje dhe vepra vandaliste). Ata përfundojnë ndjenja izolimi,


refuzimi ndaj standardeve morale dhe një pazotësi e dukshme për të krijuar lidhje me njerëz të tjerë.

Patjetër që ekstremi tjetër është tolerancë e tepruar. Disa prindër e kanë të fortë pikën e mbështetjes, sepse lëshojnë pe në disiplinë. Shumica e fëmijëve të edukuar nga prindër të tillë i mbajnë prindërit e tyre peng. Fëmijët më të vegjël mund të refuzojnë të flenë gjumë, të hanë në kohën e vaktit dhe ka shumë gjasa që të shpërthejnë në zemërim, apo në ulërima nëse nuk ua plotëson diçka në mënyrën e tyre. Fëmijët më të rritur

në moshë mund të flasin pa respekt me mamën dhe babin e tyre, duke bërë ç'u do qejfi, pavarësisht nga lutjet e tyre dhe duke pritur që këta të sigurojnë gjithçka që u nevojitet, në çdo kohë. Fëmijë të tillë përfitojnë shumë gjëra, por nuk janë më të lumtur se fëmijët me prindër autokratikë, sepse një balancë e shëndetshme midis dashurisë dhe kufijve nuk është as aty.

► CILIT STIL ATËSIE I PËRKISNI?

Autokratik: kontroll i rreptë, por pak mbështetje



Tolerant: mbështetje e fortë, por pak kontroll



Indiferent: pak, ose aspak kontroll, pak, ose aspak mbështetje



Relacional: (autoritativ) balancë e drejtë midis kontrollit dhe mbështetjes



Zakonisht këta fëmijë duan të jetojnë sipas standardeve morale të prindërve të tyre dhe janë më të prirur t'u afrohen pijeve alkoolike, drogës dhe sjelljeve të tjera toleruese. Janë më të prekshëm nga imoraliteti seksual dhe patologjia.

Në vend që të krijojnë një ekuilibër midis dashurisë dhe mbështetjes, prindërit duhet t'u afrohen relativisht fëmijëve, ku edhe dashuria dhe kufijtë u komunikohen qartë. Fëmijët ndihen të dashur, gjë që përforcon ndjenjën e vetëvlerësimit, nga ana tjetër janë të ndërgjegjshëm për kufijtë e tyre dhe kjo përforcon ndjenjën e sigurisë. Fëmijët u përgjigjen rregullave, por vetëm kur bëhet fjalë për marrëdhënie.

Dhe njëherë, ky është modeli që na vjen nga Ati ynë qiellor. Ai i lë rregullat për fëmijët e tij; mbi të gjitha, ai na i dha Dhjetë Urdhërimet, apo jo? Dhe ai ua dha këto urdhërime njerëzve pas një kohe të gjatë në marrëdhënie me ta. E filloi veç me një rregull – s' duhet të hani nga pema e së mirës dhe së keqes! – dhe më pas kaloi shumë vjet duke e zbuluar veten te njeriu dhe duke ndërtuar marrëdhënie me fëmijët e tij para se të jepte Ligjin në malin Sinai.

Ja, ky lloj ati dua të bëhem. Por jam i vetëdijshëm që s'mund ta bëj dot vetë. E di, jam përpjekur dhe kam dështuar kushedi sa herë më parë. Por di që Ati im që imitoj mund ta bëjë. Ai e ka bërë për mijëra vjet dhe mund të vazhdojë ta bëjë në mua dhe përmes meje; nëse mbështetem dhe i besoj Atij me anë të Frymës së Shenjtë duke mbajtur në mendje disa taktika ndihmëse:

Të disiplinosh në kontekstin e marrëdhënies

Disiplinimi është më efektiv në kontekstin e një marrëdhënieje dashurie. Për shembull, nëse dua të korrigjoj fëmijët e mi, e filloj me pyetje që hedhin dritë mbi marrëdhënien tonë. Nëse përgjigjja është pozitive, atëherë ndihem i sigurt që ata do të jenë të gatshëm edhe për korrigjimin. I pyes: «E di që të dua?» Duke e bërë këtë pyetje fillimisht, kam mundësi të ofroj korrigjim jo thjesht duke u bazuar në autoritetin tim, por në atë të marrëdhënies.

Njëherë kam folur para më shumë se gjashtëqind pastorëve dhe drejtuesve të krishterë në Filipine. Më pas, më shumë se dyqind prej tyre prisnin të takoheshin me mua. Një prej problemeve më të mëdha me të cilin u ndesha atë natë ishte të përfytyroja pastorin në figurën e babait, familja e të cilit i ishte kthyer kundër. Ky pastor kishte tre fëmijë, me mosha përkatësisht, 17, 13 dhe 10 vjeç, të cilët rebeloheshin gjithë kohën dhe për këtë ishin parë si «fëmijët më të këqij të kishës». Ai donte të dinte ç'të bënte tjetër.

«Harroji rregullat!» – i thashë. «Çfarë?» – pyeti ai me mëdyshje. Po këtu qëndron gabimi se ata nuk i binden asnjë rregulli. Ata as që mendojnë se kanë nevojë për to.

– «E marr me mend atë që thua, – i thashë, – por ta përsëris; ndalo së theksuari rregullat. Fillo të ndërtosh marrëdhënie me ta. S'ke ç'të humbasësh».

S'ka rëndësi çfarë moshe kanë fëmijët, nuk është kurrë vonë të fillosh të ndërtosh marrëdhënie me fëmijët. Dhe i përmenda një grua nga Polonia që kishte katër fëmijë të rritur tepër të rebeluar kundër saj dhe të tjerëve, duke i shkaktuar asaj agoni të patregueshme, madje edhe sulm zemre. Unë dhe Dik Dei i treguam për parimet e ndërtimit të marrëdhënies të pasqyruara dhe në librin *Si mund të jesh hero për fëmijë e tu* dhe ajo u kthye në shtëpi e bindur që para kishte një detyrë të vështirë dhe të gjatë në kohë; rindërtimin e marrëdhënies me fëmijët e saj. Pesë vjet më vonë u takuam përsëri dhe ajo tregoi se marrëdhënia e saj me dy nga fëmijët kishte ndryshuar 0%. Pastaj tregoi mes lotësh sa e rëndësishme ishte vëmendja që duhej t'i kushtojë marrëdhënies me fëmijët edhe kur janë më të rritur, për të qenë të shpërblyer si prindër.

T'i komunikosh qartë rregullat

Psikologu i familjes, Xhon Rozmond, tregon se prindërit e suksesshëm i komunikojnë qartë rregullat e tyre. Ata nuk rrahin ujë në hava kur vjen fjala për të marrë atë që presin. Ata nuk luten, korruptojnë, apo kër cënojnë. Thjesht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ata u tregojnë fëmijëve të tyre çfarë mund dhe duhet të bëjnë, apo çfarë s'mund të bëjnë.

Ashtu si kullotat e rrethuara sigurojnë një rrijte të mirë të bagëtisë, kufij të qartë dhe të arsyeshëm rrisin fëmijë të shëndetshëm dhe të lumtur.

Shumë libra janë shkruar për të këshilluar si të bëhesh një prind i mirë dhe i suksesshëm. Një ekspert thekson një gjë dhe një tjetër një gjë

tjetër, duke u bërë kontradiktorë me njëri-tjetrin për të njëjtën temë! Por unë vetë s'kam gjetur këshillë më të mirë se vargu i njëjës prej letrave të Palit që thotë: «Dhe etër, mos i provokoni në zemërim fëmijët tuaj; disiplinojini dhe udhëzojini sipas Perëndisë» (Efes :). E sigurt është që prindërit i provokojnë fëmijët kur nxjerrin një çështje të turbullt, u japin rregulla dhe standarde të paqarta fëmijëve të tyre.

Për shembull, një baba i thotë vajzës së tij: «Pres që të vish në shtëpi në orarin e duhur, zonjushë!» Por çfarë është orari i duhur? Dhe kjo mund të interpretohet në shumë mënyra: ora një e mëngjesit mund të jetë ora e duhur për një -vjeçare të kthehet në shtëpi, ndërsa i ati mund të ketë që në të mbrëmjes duke numëruar hapat me ecejake në kuzhinë. Është më mirë të komunikosh një kufi të qartë, p.sh në këtë rast mund të thuash: Të lutem, eja në shtëpi në , jo në e gjysmë, as në e dhjetë!

Në vend që t'i tregosh një adoleshenti «E ke për detyrë të derdhësh plehrat», do të ishte më e mirë për të dy, babanë dhe djalin që të thuhet: «E ke për detyrë të derdhësh plehrat çdo mëngjes para se të shkosh në shkollë». Në vend që të thuhet: «Shko pastro dhomën tënde», mund të thuhet «Do të doja që ta pastroje dhomën tënde pas darkës me makinë fshirëse».

Rregullat e qarta të komunikimit dhe pritjet e ndihmojnë një baba të ndërtojë kufij, e ndihmojnë një fëmijë t'i respektojë këta kufij dhe i ndihmojnë të dy të mos kenë keqkuptime dhe turbullira.

Të mësosh nga gabimet

Të ndihmon të kujtosh që kur fëmijët bëjnë gabim është si shenjë e nevojës së tyre për vëmendje. Mesa duket askush nuk mund ta injorojë kur fëmija bën një sjellje të keqe; duhet të përballesh me këtë. Por pyetja është «Si të përballesh?» «Çfarë sheh dhe dëgjon fëmija në reagimin tuaj për shkak të sjelljes së tij të keqe?»

Nëse fëmija të bën të ngresh zërin, të skuqesh në fytyrë, apo t'ju provokojë në mënyra të tjera si këto, ai ka gjasa të dalë në konkluzionin se kjo sjellje është mënyra më e mirë që t'ju shkëpusë vëmendjen. Nga ana tjetër, nëse reagimi juaj ndaj sjelljes së keqe është i qetë, pa shfrime zemërimi, apo leksione të gjata, fitimi nuk do të jetë dhe aq i madh. Një mënyrë e mirë për ta përballuar këtë situatë është t'i tregosh qetësisht fëmijës se nuk do të tolerohet kjo sjellje dhe nëse do të jetë e nevojshme, 2 edhe ta ndanit nga pjesa tjetër e familjes për pak kohë. Kujtoni që është e vështirë të tërheqësh vëmendje kur je tërësisht i vetëm, madje «karrigia në qoshe» mund të imagjinohet si një ide para bote, por vazhdon të jetë

ende efektive si mënyrë me shumë fëmijë.

Kam kuptuar që nuk është dhe aq e lehtë, por në fund të fundit po merreni me sjelljen e keqe të fëmijës, ndaj kujtoni që ata janë gati për të bërë gabime, janë gati të sillen keq në një situatë çfarëdo, sepse janë fëmijë. Bëje qëllim për të mos e bërë të madhe kur nuk sillet keq; përkundrazi, theksoni anët e tyre më të mira. Ashtu si e thashë dhe më lart, përpiquni t'i «kapni» duke bërë diçka të mirë dhe forcojeni këtë lloj sjelljeje.

Të planifikosh që më pare

Për baballarët bëhet më e vështirë çështja e disiplinës, sepse nuk i plani fikojnë gjërat që më parë. Prindërit e suksesshëm, thotë psikologu Xhon Redmond, «nuk presin deri në zgjidhjen e problemeve, por bëjnë diçka para kësaj».

Për shembull, kur vajza juaj kthehet një orë me vonesë, jeni më të prirur të vloni nga inati derisa ajo të mbërrijë në derë sesa të planifikoni

që më parë reagimin tuaj për vonesën e saj. Ose nëse vajza katërvjeçare shpërthen nga zemërimi në një dyqan, do të prisni herën tjetër që ta zgjidhni, apo do të mendoni për një përgjigje të arsyeshme që më parë, që të mos e humbisni ekuilibrin kur të ndodhë.

Një miku im pastor tregon si reagoi bashkë me gruan e tij kur morën vesh se djali i tyre shtatëmbëdhjetë vjeçar kishte kryer marrëdhënie

seksuale me të dashurën e tij. Ata u përpoqën disa herë dhe siç thoshin ata, në mënyrë të ndjeshme – t'i shprehnin pranim dhe dashuri djalit duke e nxitur që ai të kishte besim tek ata, por nga ana tjetër ai këmbëngulte që nuk kishte kryer marrëdhënie me të dashurën. Por të dy prindërit nuk u tërhoqën, diskutuan mes vete si do t'i përgjigjeshin djalit

nëse ai do ta rrëfente këtë gjë, ose nëse e dashura e tij mbeste shtat zënë.

Brenda pak javësh djali dhe e dashura e tij u ulën në vendin e rrëfimit dhe me lot në sy treguan. E dashura ishte shtatzënë.

– Sigurisht që ishte moment i vështirë, – thotë sot i ati, – por jam i gëzuar që kishim biseduar më parë me gruan si do të reagonim... Nuk e di ç'do të kisha bërë në të kundërt. Ndoshta do të isha inatosur aq shumë dhe të thosha ndonjë fjalë për të cilën do të pendohesha më vonë, por ngaqë e kishim diskutuar që më parë, mundëm t'i përgjigjeshim në mënyrën më të mirë dhe të shëndetshme.

Jo të gjitha situatat janë njësoj, por të planifikosh që më parë për gjigjen të ndihmon si në situata të lehta, ashtu dhe në ato më seriozet.

Të përdorësh pasoja të natyrshme

Besoj se Shkrimet na mësojnë dy forma të disiplinës pozitive (që psikologët e sotëm së fundmi e kanë «zbuluar»!). Njëra është të disiplinosh përmes pasojave të natyrshme

Parabola e Jezusit mbi djalin plangprishës është ilustrim i shkëlqyer i fuqisë ndreqëse të pasojave të natyrshme. Sipas historisë biblike, i riu u largua nga shtëpia për të jetuar vetëm dhe i kërkoi të atit pjesën e pasurisë që i takonte. I ati e dinte ç'do të ndodhte, megjithatë ia dha pasurinë. Dukej që ai kishte vendosur që i biri të merrte disa mësimë mbi jetën në një mënyrë më të vështirë; duke vuajtur pasojat e natyrshme për shkak të veprimeve të veta. Sjellja e tij prej kapadaiu solli pasojat. Djali shpenzoi gjithë paratë, humbi punën, miqtë dhe përfundoi duke ngrënë lende si derrat. Vetëm atëherë, thotë Jezusi «erdhi në vete» (Luka 15:17) U deshën pikërisht këto pasoja të natyrshme që e sollën djalin në vete. Ai vendosi të kthehej në shtëpi, ku i ati mezi po e priste me mall dhe dashuri, më shumë se kurrë ndonjëherë. (Luka 15:11-32)

Është interesante që i ati, jo vetëm e la të shkonte, por ia dha edhe pasurinë. Shumë baballarë mund t'i lënë fëmijët të lirë të shkojnë, por sa prej tyre do t'ia jepnin pasurinë duke e ditur që do të shpenzohej? Megjithatë babai i djalit plangprishës mund të ketë vlerësuar më shumë mësimin, që do të mësonte djali për gjithë jetën sesa paratë.

Në librin *Si të bëhesh hero për fëmijët e tu*, Dik Dei tregon si i ka përdorur pasojat e natyrshme për t'i mësuar djalit të vet, Xhonatanin, diçka shumë të rëndësishme kur ai ishte ende fëmijë:

Në shtëpinë tonë kishim një oxhak njësh me nivelin e dyshemesë dhe kjo na shqetësonte kur e kishim Xhonatanin të vogël. Jo vetëm për atë që mund të shkaktonte zjarri, por edhe që Xhonatani mund ta arrinte oxhakun dhe të digjej kur ne, unë dhe gruaja, mund ta kishim humbur vëmendjen.

Një mbrëmje po hanim darkë nën dritën e qirinjve, Xhonatani u mat të kapte qiririn e ndezur, por Sharlota, gruaja ime, u përpoq ta ndalonte. «Jo, – e ndala unë, – lëre ta kapë!»

Xhonatani futi gishtin te flakëza dhe e tërhoqi menjëherë duke qarë nga dhimbja. Sigurisht që s'ishte djegur shumë, por aq sa të mësonte çfarë ishte zjarri dhe të largohej prej tij. Disa njerëz mund ta gjykojnë si të padrejtë veprimin tonë me Xhonatanin, por unë vetë s'mendoj kështu. Do të doja që të mësonte ç'do të thoshte të digjeshe nga një flakëz sesa nga një shpërthim zjarri.

Babai që lejon që të birin në klasën e pestë ta shoqërojë makina e policisë, sepse ka vjedhur në një dyqan, nuk po bën gjë tjetër veç po përdor drejt fuqinë ndreqëse të pasojave të natyrshme. Babai që me keqardhje sheh si po humbet pozicionin në skuadrën e volejbollit vajza e vet, sepse nuk është stërvitur sa duhet, po përdor këtë fuqi ndreqëse të pasojave të natyrshme. Babai i pikëlluar që e lë djalin ta kalojë natën në burg, për shkak të ngarjes me shpejtësi të makinës nga pija, po përdor fuqinë ndreqëse të pasojave të natyrshme.

Të specifikosh pasojat logjike

Forma tjetër e disiplinimit që përshkruhet në Shkrimet është pasoja logjike. Kjo do të thotë se prindi përcakton bashkë me fëmijën, që disa lloj pasojash do të ndodhin kur fëmija nuk i plotëson përgjegjësitë e veta, ose që sillet keq në një mënyrë të caktuar. Për shembull, «Nëse nuk e ha gjithë ushqimin e darkës, nuk do ta hash as ëmbëlsirën.» Ose «Nëse nuk e ushqen qenin, as ti vetë nuk do të hash». Këtë gjë ne e kemi parë të ndodhë mijëra vjet më parë në kopshtin e Edenit. Zoti u la gjithçka në dorë dy njerëzve të parë, veçse të mos preknin nga pema e njohjes së të mirës dhe të keqes. Dhe nëse do të hanin, – tha Zoti, – do të vuanin pasojat, me siguri do të vdisnin. (Zan 2:15-17).

Sigurisht që Eva e hëngri frutin e ndjekur nga Adami dhe s'kaloi shumë dhe ata i vuajtën pasojat. Adami dhe Eva vuajtën pasojën e vdekjes fizike dhe gjithçka tjetër në vazhdim që përfshinte dhimbjet e lindjes, mundimin në punë dhe dëbimin nga parajsa. (shih Zan 3:1-19)

Zoti ua kishte përcaktuar kufijtë që më parë dhe kur këta të dy i prekën këta kufij, zgjodhën bashkë me këtë dhe pasojat e veprimit. Zoti vazhonte t'i donte, por ishte i «detyruar» për shkak të pasojave që ata vetë kishin zgjedhur.

Edhe këtu na ndihmon një ilustrim i Dik Deit, një përvojë nga atësia e tij mbi fuqinë e ndreqjes të pasojave logjike.

Kur djali i madh, Diku, mori patentën, ramë të dy dakord që, nëse bënte ndonjë lëvizje të rrëmbyer, do ta humbiste rastin e ngarjes

së makinës për një muaj. Ende e mbaj mend lëvizjen e parë të rrëmbyer të tij kur ngau makinën. Me drojë erdhi tek unë dhe më tha: «Babi e mora gjobën e parë».

Nuk e dija ç'kishte ndërmend Diku, por e pyeta: «Ku janë çelësat e makinës?»

Diku më la në dorë çelësat. Pas asaj, pasi pagoi gjobën, nuk e ngau makinën për një muaj rresht. Nuk kishte vend për diskutim, as për shpjegimin pse e kishte bërë një gjë të tillë. Pasojat logjike ishin bërë të qarta që më parë dhe Diku e dinte që po paguante çmimin që tashmë kishim rënë dakord.

Përdorimi i fuqisë ndreqëse të pasojave logjike eliminon diskutimet e gjata, shpjegimet, argumentet dhe të bërtiturat. Kur të dy, prind dhe fëmijë, bien dakord që disa veprime sjellin disa lloj pasojash logjike, problemi është zgjidhur para se të shfaqet. Fuqia ndreqëse e pasojave logjike i liron të dy, si babanë dhe fëmijën. Babai s'ka pse të marrë rolin e xhandarit, gjykatësit, apo xhelatit; ai thjesht zbaton pasojat që kanë ardhur si rrjedhim i veprimeve të sjelljes së fëmijës.

Të përballesh me rregullat e tua

Vajza ime e madhe, Kelli, erdhi njëherë në shtëpi pas një feste që organizohej në shtëpinë e një prej shoqeve të saj dhe më pyeti nëse mund të kalonte natën atje. Pasi e dëgjova, i bëra disa pyetje. Kelli e pohoi që do të kishte edhe djem në festë dhe s'ishte e sigurt, nëse nuk do të kishte pije alkoolike. Kur më tha disa nga emrat e atyre djemve, që do t'i shoqëronin vajzat pas orës dhjetë, njoha njërin prej tyre, që njihej për abuzimin me alkool edhe pse ishte në moshën e Kellit.

Pasi e dëgjova vajzën, ia ktheva: «Jo, s'mendoj që të rrish. Kur të mbarojë festa në dhjetë, dua të kthehesh në shtëpi!»

Kelli më telefonoi tre herë gjatë kohës së mbrëmjes se mos më ndyshonte mendja. Një herë nisi të qante në telefon dhe atëherë kuptova ç'po ndodhte në të vërtetë. Katër a pesë vajza të tjera donin të qëndronin pas festës, por dhe ato duhej të merrnin lejen e prindërve dhe gjithçka varej nga ajo që do të thoshte babai i Kelli Mekdauellit.

Dukej qartë që më shumë Kelli ishte e shtyrë nga grupi. Ajo më tregoi se s'kishte pse të shqetësohesha aq shumë. Prindërit e shoqes do të ishin në shtëpi dhe ndërkohë do të kishte dhe shumë të rinj të tjerë,

— s'do të kishte vend për të ndodhur diçka në vetmi.

Kuptova që Kelli ishte e mbushur më shumë nga shoqet e veta, ndaj s'e ndryshova rregullin:»Më vjen keq, Kelli, por duhet të kthehesh në shtëpi.

E mbylla telefonin me veshët që dëgjonin ende dënesjet e Kellit. Nuk kisha dashur ta zhgënjeja, por isha i sigurt se kisha bërë gjënë e duhur. Më vonë, kur u kthye në shtëpi, ajo na zgjoi nga gjumi të dy, mua dhe

Dotin dhe na falënderoi që nuk e kishim lënë atë natë.

— Babi, — tha ajo, — në fakt nuk doja të rrija, sidomos kur ti këmbëngule për jo dhe vajzat e tjera po më shtynin më shumë. Faleminderit që më «shpëtove»!

Kam zbuluar kur prindërit përballin rregullat e tyre, bëjnë dy gjëra për fëmijët e tyre. E para, i ndihmojnë ata të përballen me grupin shoqëror, sepse mund të thonë: «Prindërit e mi nuk do më lënë» Dhe e dyta dhe më e rëndësishmja, u bën të ditur fëmijëve që ka standarde dhe vlera që nuk duhen injoruar, apo bërë kompromis.

Të veprosh me dashuri dhe jo me zemërim

«Zoti disiplinon ata që do», thuhet në Bibël. Dhe nuk thuhet: «Zoti disi plinon ata që urren. Nuk thotë as: Zoti disiplinon ata që e kanë zemëruar. Ai disiplinon me dashuri dhe jo me zemërim».

Të gjithë baballarët zemërohen me fëmijët e tyre. Por një baba i urtë di si të jetë i kujdesshëm kur ushtron disiplinën në disa lloj situatash. I skuqur nga inati, apo duke bërtitur nuk jam në gjendje t'u ofroj fëmijëve ndreqjen me dashuri. Nëse po ndiej se po sulmoj me fjalë, apo me veprime, s'jam aspak në gjendje t'i ndreq me dashuri.

Ndaj është shumë e rëndësishme për mua, siç e tregova dhe pak më parë, që ta shpreh korrigjimin përmes marrëdhënies me fëmijët, t'i pyes para se t'i disjplinoj: A e di që të dua? Ky ushtrim i thjeshtë jo vetëm që ndreq në kuptimin e marrëdhënies, por arrin edhe diçka tjetër, po aq të rëndësishme (me raste dhe më të rëndësishme!); më ndreq edhe mua, duke më treguar se, nëse dua të bëhem baba si Ati im qiellor, duhet t'i disjplinoj fëmijët me dashuri dhe jo zemërim.

Të përshtatësh planin

Disa lloj prindërisht janë vazhdimisht të ashpër; ata e trajtojnë fëmijën edhe kur është rritur si të ishte fëmijë. Kanë prirje ta kontrollojnë fëmijën nga djepi deri në varr..., apo të paktën derisa të largohet nga shtëpia. Kjo lloj sjelljeje nga ana e tyre i mbyt fëmijët, s'u jep asnjë hapësirë duke i ndrydhur dhe duke u shkaktuar shpesh sjellje të çoroditura dhe jo të shëndetshme. Ata jo vetëm që s'kanë mësuar ndonjëherë të vetë përbahen; por as të jenë në vete pavarësisht situatave.

Por kjo s'është aspak mënyra si vepron Ati qiellor me ne. Autori i Letrës drejtuar Hebrejve na thotë: «Zoti na disiplinon për të mirën

tonë, që të marrim pjesë në shenjtërinë e tij.» (Hebr 12:10) Me fjalë të tjera, Ai na disiplinon që të rritemi, që të bëhemi të shenjtë, të pjekurohemi, duke i ngjarë më shumë atij.

Babai i urtë do ta pasqyrojë shëmbëllimin e Atit, duke e përshtatur planin e tij të disiplinës sipas moshës dhe pjekurisë së fëmijës.

Ai do ta kuptojë kur fëmija i vet është gati për një sfidë, apo përgjegjësi të re, duke e liruar nga disiplina e jashtme për të zhvilluar tani disiplinën e brendshme.

Për shembull, një baba mund t'u thotë dy fëmijëve të afërt në moshë që zihen shpesh: «S'kam pse të përfshihem në grindjen tuaj; besoj se jeni të mëdhenj tashmë për ta zgjidhur vetë çështjen midis jush.» Një baba i dy binjakëve mund të thotë: «Besoj se jeni në moshë që ta vini vetë alarmin e zgjimit dhe të çoheni në kohë nga gjumi», ose «Për sa kohë që merrni nota të mira në shkollë, mund të zgjidhni vetë kur të flini».

Disiplina efektive i kërkon të dyja, si lidhjen logjike dhe fleksibilitetin – lidhjen logjike në zbatimin dhe forcimin e disiplinës dhe fleksibilitetin në përshtatjen e rregullave dhe pritjeve, ndërkohë që fëmijët rriten dhe pjekurohen.

Fëmija, babai i të cilit siguron një disiplinë të përshpirtshme – disiplinë të bazuar në dashuri, vazhdimësi dhe qartësi – është më i prirur të vjelë frytin e respektit, paqes dhe drejtësisë. Ky baba i pajis fëmijët vet me vetëdisiplinimin, një cilësi që do t'i ndihmojë në një jetë të shëndetshme – emocionalisht, shpirtërisht, shoqërisht dhe fizikisht. Ai i ndihmon fëmijët të shmangen nga pasojat tragjike të sjelljes së çoroditur, i bën të aftë të gëzojnë nderin e një reputacioni të mirë, nxit harmoninë në mendjet dhe zemrat e fëmijëve dhe në marrëdhënien e tyre me njëri-tjetrin.

Ja, këtë bën edhe disiplina e Zotit në mua dhe këtë dua edhe unë për fëmijët e mi.

1* Në këtë kapitull përshkruhen katër stile themelore të atësisë: autokratik, tolerant, neglizhent dhe relacional. Cili stil përdorej në shtëpinë tënde kur ishe fëmijë? Cili stil të përshtatet më së miri në disiplinimin e fëmijëve?

2* Në Letrën drejtuar Hebrenjve : përmendet objekti i disiplinës së Zotit ndaj fëmijëve të vet (që të marrim pjesë në shenjtërinë e tij). Në hapësirën më poshtë, përcaktoni cili është objekti i disiplinimit të fëmijët tuaj?

I disolinoj fëmijët që

A keni përdorur ndonjëherë pasojat e natyrshme dhe logjike në disiplinimin tuaj? Mendoni për ndonjë rast. Nëse do të filloni me pasojat logjike, nisni ngadalë me forma të lehta dhe përdorni gjithmonë përballjen me rregullat kur është e nevojshme.

3. Analizoni qëndrimin tuaj ndërsa disiplinoni fëmijët. Vendosi një «x» në vijën më poshtë për të treguar shkallën që përfaqësoni.

Kritikuesi Korrigjues

Gjykues Mësues

Manipulues Udhëzues

Kontrollues Lehtësues

Çfarë hapash duhet të merrni për t'u bërë më i ngjashëm me Atin në disiplinim?

* A disiplinoni më shumë i shtyrë nga dashuria, apo nga zemërimi?

Çfarë hapash konkretë mund të merrni për t'u përmirësuar në këtë fushë?

Ati dhe falja

E dëgjova historinë e Donit nga një miku im. Doni ishte babai i tri vajzave dhe një djali. Ai ishte përpjekur besnikërisht dhe ndjeshmërisht bashkë me gruan e tij t'i rriste fëmijët sipas parimeve biblike. Kur vajza e tij e madhe arriti moshën e pjekur të adoleshencës, u përfshi në marrëdhënie seksuale me meshkujt.

Në fakt, për të qenë i sigurtë këto marrëdhënie ishin të shpeshta. Doni dhe gruaja e tij bënë gjithçka që mendonin për ta ndihmuar vajzën, por asgjë nuk funksionoi. Ajo vazhdoi të «flinte andej-këtej» edhe me

djem rrugësh, madje me raste duke i sjellë të dashurit e saj edhe në shtëpi kur prindërit nuk ishin.

Në fund Doni u ul pranë saj dhe i foli me një zemër që dukej sikur do t'i shpërthente nga dhimbja.

«Kejti, – i tha ai, – unë dhe mami yt kemi bërë gjithçka dhe tashmë s'dimë më ç'të bëjmë, por ti mund të largohesh nga kjo shtëpi dhe të vazhdosh të bësh atë që je duke bërë». Ai i kërkoi së bijës të largohet. Së bashku me gruan u përpoqën t'i tregonin vajzës që e donin, por nga ana tjetër ishin të bindur që ajo, ose të pranonte ndihmën e tyre për të ndryshuar sjelljen, ose të gjente strehë tjetër për të jetuar.

Kethi u largua ditën tjetër. Pasi i bëri gjithë plaçkat gati, u largua pa u treguar prindërve ku po shkonte. Tre muaj më vonë, Doni u zgjua në një të mëngjesit nga një telefonatë.

«Babi, po telefonoj nga stacioni i autobusit.» Ishte Kethi. Pasi tha edhe disa fjalë të tjera në hallakatje, në fund shtoi: «Dua të kthehem në shtëpi.» Doni u ngrit dhe zgjoi të shoqen. «Mos u largo, po vij!»

Doni e mori vajzën në stacionin e autobusit dhe e përqafoi gjatë dhe shumë ngrohtë para se të hipnin në makinë për t'u kthyer në shtëpi. Ai

nuk e pyeti ku kishte qenë, as nuk i mbajti leksion për netët e gjata pa gjumë që u kishte shkaktuar, madje as që i përmendi rregullat që duhej të ndiqte ndërsa pranoi të kthehej në shtëpi. Ai thjesht e fali.

Ky lloj babai dua të bëhem, një baba që fal. Dua që fëmijët e mi të dinë që mund t'i pranoj gabimet dhe sjelljen e tyre, duke gjetur faljen nga babai i tyre, se ai nuk do t'u mbajë mëri. Dua që ata të sigurohen se, edhe kur e prishin gjithçka, mund t'ia fillojnë sërish nga e para.

Dua të bëhem pikërisht një baba që fal, sepse kam parë të kundërtën në shpirtin e një babai që nuk fal. Kam parë fëmijë, baballarët e të cilëve nuk kanë mundur të shkëputen nga lëndimi dhe hidhërimi, duke zhvilluar kështu një vlerësim të ulët për veten e tyre. Kam parë që fëmijë me baballarë që nuk falin janë të paafte për të falur veten e tyre para të tjerëve. Të tillë fëmijë janë rebelë ndaj familjeve të tyre, kishës! Nga ana tjetër kam vënë re sa mirë mund të ndikojë një baba që fal në formimin e një vlerësimi dhe sigurie të shëndetshme për veten të fëmijët. Fëmijë të tillë mësojnë si të falin veten dhe të tjerët. Jam i bindur që një baba i tillë rrit fëmijë që janë më të ndershëm me gabimet e tyre dhe që e pranojnë shpejt gabimin, apo mëkatin që bëjnë duke kursyer për të dyja palët, prindërit dhe fëmijën, shumë muaj, apo qoftë dhe vite në ankth dhe agoni. Ja pse dua të jem një baba që fal, ashtu si është Ati im qiellor.

Falja e Atit

Imagjinojeni veten si babai i një fëmije, të cilin e ka si dritën e syrit. Ti e mbush me dashuri dhe vëmendje që kur ka lindur. E ke larë për herë të parë në jetën e tij, e ke mësuar si të ngasë biçikletën, ke qenë në ndeshjet e tij të bejzbollit, e ke ushqyer kur ka qenë sëmurë dhe i ke dhënë krah kur ka qenë i mërzitur. Ke qenë gjithmonë gati për të qenë pranë tij dhe i interesuar për gjërat e tij, ke punuar shumë që të mos i mungojë gjë materialisht dhe e ke mbushur me dhurata, ke bërë gjithçka që një baba i dashur mund të bënte për birin e vet.

Po si iu përgjigj djali mirësisë sate? E mori të mirëqenë. Thjesht ju injoroi, duke ju kërkuar vetëm kur kishte nevojë për diçka, p.sh; para për këpuçet e sportit, apo për benzinë për makinë. Madje në disa raste ka qenë i pabindur ndaj teje. Shpesh ai të mashtronte. Dukej sikur i vinte turp që kishte një baba si ty dhe i trajtonte keq vëllezërit dhe motrat e tjera.

Si do të ndiheshit për një djalë të tillë? Mendojeni mirë këtë përgjigje, sepse ju nuk jeni babai në këtë histori, por djali.

Ati juaj qiellor ju ka mbushur me dashuri dhe hir dhe ju i jeni përgjigjur ashtu si ai djali në këtë histori (në fakt, nëse nuk më ngjani mua, keni bërë ndoshta dhe më keq sesa tregova në këtë histori) ndërkohë, Zoti ju ka falur pa asnjë kusht dhe vazhdon ta bëjë këtë. A s'është e mahnitshme? Në të vërtetë jo dhe aq, sepse është pjesë e natyrës së tij. Kështu dua të bëhem dhe unë.

Ai fal të gjitha paudhësitë e tua dhe shëron të gjitha sëmundjet e tua... Sa larg është lindja nga perëndimi aq shumë ai ka larguar nga ne fajet tona. Ashtu si një baba është i mëshirshëm me bijtë e tij, kështu është i mëshirshëm Zoti, me ata që kanë frikë prej tij.

Psalmi 103:3, 12-13

Unë, pikërisht unë, jam ai që për hir të vetes fshij shkeljet e tua dhe nuk do t'i mbaj mend mëkatet e tua.

Isaia 43:25

Ai është një Atë që fal. Edhe pse është fyer dhe vullneti i tij është shkelur më shumë se çdo baba tjetër në historinë njerëzore, ai është gati gjithmonë i shqetësuar për t'u dhënë faljen fëmijëve të tij. Ashtu si babai që priste në historinë e Jezusit mbi djalën plangprishës, Zoti jo vetëm që pret, por në fakt vrapon për të na falur dhe në hirin dhe bujarinë e tij fillon puna e tij falëse para se fjalët tona të pendesës të dalin nga goja jonë (shih Luka 15:11-32).

Pikërisht ky lloj babai dua të bëhem edhe pse për fat të keq nuk jam i pajisur tërësisht, jo, në fakt nuk jam i përgatitur të jem i tillë. Sepse, në fakt krenaria më zë udhën, mëkati më zë sytë dhe ndonjëherë nuk mund të kuptoj shpirtin tim të faljes. Frika ma pret rrugën, sepse shqetësohem se fëmijët do më keqkuptojnë, duke menduar që të falësh sjelljen e tyre ka kuptimin e të mos vënit re të kësaj sjelljeje. Nuk mund të bëj më shumë se ç'kam takatin. Dhe s'kam pse, sepse Fryma e Zotit, Atit tim, jeton në mua me anë të shpëtimit që kam në Jezu Krishtin, sepse përmes lutjes dhe mbështetjes tek ai mund të tregoj shëmbëllimin e Atit të fëmijët e mi. Disa nga mënyrat konkrete që Zoti na aftëson për t'u bërë të tillë, përfshin:

Të kuptosh së pari faljen.

Një prej pengesave për të falur është mungesa e të kuptuarit ç'është falja në të vërtetë dhe çfarë vjen si pasojë e saj. Të fal fëmijët e mi s'do të thotë që ta bëj një sy qorr ndaj mosbindjes së tyre, as sikur s'e vë re këtë lloj sjelljeje, apo që t'i shpëtosh ata nga ndëshkimi. Alen C. Guelzo, duke shkruar për revistën *Christianity Today*, thotë:

«Të falësh... do të thotë të hedhësh tutje me bindje të plotë lëndimet dhe fyerjen. Kjo s'ndikon vetëm në kontrollin e lëndimit, por në harresën e plotë të tij...»

Ka disa gjëra që nuk janë falje dhe këto mund t'ju ndihmojnë për të krijuar një tablo të balancuar. Të falësh s'do të thotë thjesht të kërkosh ndjesë. Falja është personale; ka të bëjë me një ndjenjë fyerjeje që keni brenda jush nga e cila keni nevojë të liroheni. Ndjesa është më shumë e ligjshme se personale; e kufizuar vetëm në deklaratën ligjore të fyerjes pa përfshirë aspak marrëdhënien midis fyesit dhe të fyerit. Dhe ndjesa, ngjashmërisht si falja do të thotë ta lirosh dikë nga ndëshkimi që meriton të marrë... Një gjë tjetër që nuk përfshihet në faljen është justifikimi. C.S Luis shkruan:

«Ka një ndryshim të madh në botë midis dy koncepteve; faljes dhe justifikimit. Falja të thotë: “Po, e bëre këtë gjë, por e pranoj shfajësimin tënd. S’kam për ta mbajtur si armë kundër teje dhe që këtë e tutje gjithçka midis nesh do të jetë si ka qenë.” Por justifikimi të thotë: “E shoh që s’mund ta bëje, ose s’e kishe me qëllim, s’ke pse të ngarkohesh me faj.” Nëse askush s’është fajtor, atëherë s’ka fare vend për falje. Në këtë kuptim falja dhe justifikimi janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Nëse kjo që sapo thashë është e vërtetë, s’kemi pse të kemi frikë që duke falur po e tolerojmë në njëfarë mënyre të keqen, ose nuk po e vëmë re. Të falësh s'do të thotë “të bësh fajtor” përkundrazi, “të harrosh fajin”». Të kuptosh faljen, çfarë është dhe çfarë s’është, është një hap i nevojshëm për t’u bërë baba që di të falë.

Të mposhtësh nxitjen për të kundërvepruar

Fëmijët mund të na shtyjnë deri në kufijtë më ekstremë të përmbajtjes dhe kjo e bën të vështirë t'i falësh, sidomos kur duket sikur çdo veprim i tyre ka për qëllim «ta nxisë babin keqas». Por kam zbuluar se t'i rezistosh nxitjes për të kundërvepruar ndaj fëmijëve sjell një favor të pamatshëm për veten dhe fëmijët.

Sa herë që ndihem i tunduar të reagoj me ashpërsi dhe pa falje ndaj fëmijëve të mi, përpiqem të kujtoj një bisedë që një miku im bëri me dy bashkëshortë. Ai po përpiqej t'i ndihmonte këta dy prindër në përpjekjet e tyre me djalin rebel, i cili ishte i pabindur ndaj disiplinës së tyre.

Në një prej takimeve ai i pyeti: «Si ka vepruar javën e kaluar djali?» Që të dy treguan me një frymë se çfarë nuk shkoi mirë të premten. Pasi miku im i dëgjoi për minuta se çfarë të premte të tmerrshme kishin kaluar ata me djalin, i pyeti si kishte kaluar e enjtja? Mirë. Po e mërkura? Në rregull. Po e marta ishte keq? Jo. Po të hënën, si u soll? Në fakt të hënën ishte shumë mirë.

Në fund miku im ishte gati të nxirrte një përfundim. Vetëm një ditë e keqe nuk i anulon katër ditët e tjera. E drejtë, e premtdja kishte qenë ferr, por s'mund të shihnin ata përmirësimin në ditët e tjera dhe jo t'i zbresin për shkak të së premtes? Kështu filluan të kuptonin si kishin kundërvepruar dhe e marrë në tërësi sjellja e djalit kishte qenë duke u përmirësuar vitet e fundit. Për shkak se dashuria nuk i kujton gabimet, ne mund të falim dhe t'u heqim vizë ditëve të këqija duke u fokusuar gjithmonë e më shumë te sukseset e fëmijëve tanë dhe jo te dështimet.

Të kërkossh ndihmë

Gruaja ime, Doti, është bërë një ndihmë e paçmuar për mua në shumë raste e mënyra. I kam kërkuar vetë Dotit të më tregojë kur reagoj ashpër ndaj fëmijëve, apo duke u sjellë si një baba që nuk fal. Besomëni, ajo është bërë eksperte duke më thënë: «Xhosh, mendoj se ia ke borxh të kërkuarit falje Kejtit», ose «A nuk e mendon se duhet t'i thuash diçka Hedherit?» S'ka qenë gjithmonë e lehtë të dëgjosh gjëra të tilla, por ka qenë e domosdoshme.

Kujtoni që, nëse u keni kërkuar fëmijëve ndihmë për të qenë baba i përgjegjshëm, ata patjetër do t'ju kujtojnë për të qenë një baba që fal. Mund të thonë: «Babi, nuk besoj se më ke falur që të leva makinën», ose

«Babi, vërtet më ke falur që u futa pa leje në studion tënde?»

Të kujtosh të kaluarën tënde

S'është e lehtë të rritesh. Nëse jemi të ndershëm, të gjithë duhet të pranojmë që gjatë rritjes sonë edhe ne kemi bërë po aq (në mos më shumë!) budallallëqe, apo gabime me dashje sa fëmijët tanë po bëjnë sot. Dhe ne kemi pasur ditët tona të këqija. Kemi qenë zemërakë, qerrataj (ndonjëherë me plot gojën të djallëzuar!) dhe ka pasur raste që me dashje dhe me plan jemi rebeluar.

Dhe gjithmonë kemi menduar se Zoti na ka dhënë këta fëmijë, që janë po aq rebelë dhe të djallëzuar siç ishim ne për t'u hakmarrë nga ana e prindërve tanë!

Falja është e lehtë nëse e shohim si mundësi ndaj dobësive dhe dështimeve tona, jo vetëm ato në fëmijëri, por dhe ato që sapo kanë kaluar. Kur djali im vonohej më shumë se orari i caktuar në darkë për shembull, ka qenë ndihmëse të pyesja veten nëse kam qenë unë vetë vonë nga ndonjë takim që kam pasur këtë javë (ndoshta në raste të ndryshme duhet dënimi për të mësuar qëllimet, por duke kujtuar të kaluarën kjo ndihmon në ushqyerjen e një shpirti falës në mua), nëse ime bijë merr një gjobë për ngarje me shpejtësi të makinës, duke kujtuar reagimin e fundit të dhunshëm që mund të kem bërë, më ndihmon që të jem më shumë gati ta fal.

Të praktikosh faljen

Dua të jem ai lloj babai që fal pavarësisht sa e madhe është shkelja e fëmijëve, por dhe një baba që fal për gjërat e vogla. Në fakt nga përvoja ime, duke filluar me gjërat e vogla, më ka ndihmuar të përgatitem si baba që fal në situatat e krizave madhore.

Çdo ditë ka mundësi të panumërta për të ushtruar faljen. Për shembull, nëse ndonjëri nga fëmijët më flet mua, ose Dotit pa respekt, do ta korrigjoj këtë sjellje dhe më pas ta fal nëse fëmija i përgjigjet pozitivisht këtij korrigjimi. Shpesh unë do të buzëqeshja duke thënë: «Je i falur». (Përpiqem të mos them asnjëherë «Oh, s'ka problem», ose «Në rregull!»), sepse në fakt dua të fokusohem në të komunikuarit falje dhe jo miratim të sjelljes.

Apo në një shembull tjetër, nëse ndonjëri nga fëmijët vjen me vonesë, do ta shfrytëzoja këtë incident të vogël për të praktikuar faljen. Duke qenë i kujdesshëm të mos e teproj, jap një lloj ndëshkimi që i shkon për shtat kësaj sjelljeje, të tillë si: «Muajin tjetër orari yt do të ngushtohet me një orë më herët» dhe më pas t'i tregoj se e kam falur.»

Mesa duket të tilla mundësi për të falur nuk më ndihmojnë vetëm mua (me ndihmën e Zotit) për t'u treguar një shpirt falës fëmijëve të mi, por gjithashtu më mbajnë në «formë» për t'u përballur me situata më të rënda kur është më e vështirë, por dhe më e nevojshme të falësh.

Të bësh një sprapsje magnetike

Dik Dei, bashkëpunëtori im në librin *Si të jesh hero për fëmijët e tu*, na jep këtë lloj këshille, gjë që mendoj se i përshtatet diskutimit në këtë kapitull:

Kur nis të ndiej tension për shkak të fëmijëve të mi, kam kuptuar që është më mirë të hedh një hap prapa dhe të mundohem t'i shoh me sytë e Zotit; si njerëz me vlera të pafundme. Kjo më ndihmon që të kem një qëndrim pranues dhe falës edhe atëherë kur situata e kërkon disiplinën. Vazhdoj t'i pranoj dhe t'i fal edhe atëherë kur merrem me sjelljen e tyre.

Unë e quaj këtë hap prapa si një «sprapsje magnetike». Kur dy copa magneti janë të ndara dhe me fushë të kundërt nuk kanë

ndikim te njëri-tjetri. Kur i vë të dy magnetet në të njëjtën fushë, ata do të bëjnë një nga dy gjërat: ose do të afrohen, ose do të largohen.

Emocionet tona na bëjnë të sillemi njësoj si këto dy magnetet. S'kemi fusha magnetike, por si ne dhe fëmijët kemi të dy emocione dhe të jetosh në të njëjtën familje nën të njëjtën çati me fëmijët është njësoj sikur të rrish në të njëjtën fushë emocionale dhe kur ndodh, bëhet e ngjashme me atë që u ndodh dy magnetëve: ose do të afroresh më shumë me fëmijën tend, ose do ta largosh më shumë nga vetja.

Kurdo që ndodhem në situata të tendosura me fëmijët e mi i bëj vetes pyetje të tilla të vështira: «Pse e kemi marrëdhënien tonë kaq të stresuar? Pse po reagoj kështu ndaj fëmijës tënd?

Pse reagon kështu fëmija im ndaj meje?» Kur gjërat tensionohen, ose keqësohen më shumë në familjen tonë, mund të ndodhë që: siguria e dikujt po kërcënohet dhe pranimi i fëmijës është në rrezik.

Në fakt, të bësh zmbarsjen magnetike është përgjegjësi e prindit dhe jo e fëmijës. Si i rritur, jeni ju i pari që do të hidhni një hap pas, jashtë situatës, për të kuptuar çfarë po ndodh në të vërtetë. Ndërkohë mund të kontrolloni çdo ndjenjë zemërimi, apo fyerjeje dhe atëherë kur duhet të tregoni ose kërkonin falje, të dyja të sjellin në të njëjtën pikë.

Të kërkosht falje

E ula vajzën time -vjeçare, Kejtin, dhe i shpjegoja se po punoja me një libër dhe kisha nevojë për ndihmën e saj. E pyeta: A ka pasur raste kur të kam lënduar, apo fyer dhe s'të kam kërkuar falje?

Ajo heshti për a minuta duke menduar me vete. E merrja me mend se çfarë po ndodhte brenda kokës së saj, ndërsa po hapte «kata- logun mendor» të të gjitha gjërave, që unë mund të kisha bërë si baba gjatë gjithë atyre vjetëve. Po imagjinoja se si po kujtohej për duzinë incidentesh të ndodhura dhe si po përpiqej të zgjidhte

diçka që i dukej e drejtë për të më nxjerrë mua sa më të keq. S'mund të duroja dot më. Kejti s'po thoshte anjë fjalë. Kërkova ta thyeja heshtjen, duke i thënë:

«Zemër, thjesht diçka».

Ajo buzëqeshi: «Mirë, babi, mund të jetë e mirë për ty, por jo për librin tënd». Menjëherë mendova për ndonjë gjë të tmerrshme që s'mund të thuhej haptas në një libër, ajo ngriti supet dhe tha: «S'mund të kujtoj dot asgjë».

Çfarë lehtësimi! Dhe – (kështu do të shtonte gruaja ime!) – sa befa- suese!

Nuk po them këtu, që si baba kam marrë pikët maksimale, jam i sigurt që ka pasur raste kur është dashur t'i kërkoja sime bije falje dhe nuk e kam bërë. Por Kejtiti s'i kujtohej asnjë rast dhe për të qenë i sinqertë, as unë vetë s'kujtoja. Nëse do të kishte ndonjë, do të bëja të pamundurën ta ndreqja menjëherë.

Aftësia për të pranuar dhe kërkuar falje duket qartë që është e rrallë midis prindërve të krishterë. Anketa e zhvilluar midis fëmijëve të krishterë, pjesë e fushatës «Si të dallosh të mirën nga e keqja» tregoi se 3 përqind e fëmijëve të anketuar – më shumë se një në tre – asnjëherë

ose rrallë kishin dëgjuar nga prindërit e tyre të pranonin gabimet e tyre, apo të kërkonin falje: Ja pse nuk është çudi që fëmijët vetë nuk kërkojnë falje për gabimet e tyre dhe kanë probleme të identifikohen me prindërit e tyre. S'është aspak çudi pse fëmijët tanë kanë probleme me vetëvlerësimin, sepse prindërit e tyre në sipërfaqe janë të përsosur!

Sa i bekuar është ai fëmijë, babai i të cilit është i durueshëm me mëkatet e tij dhe i shpejtë në falje, babai i të cilit nuk i mban dështimet e veta si shpatë për kundërveprim. Një baba i tillë është i aftë të rrënjosë urtësi, përshtirshmëri dhe pjekuri te fëmijët e vet dhe të ushqejë ndjenjën e vetëvlerësimit dhe vetësigurisë te fëmijët e tij. Ky lloj babai është më shumë gati t'i mësojë famijët e vet të pranojnë gabimet e tyre dhe të pendohen pa vonesë për to, të rrisë fëmijë që bëhen njerëz të durueshëm dhe falës ndaj të tjerëve. Një baba i tillë është i aftë të reflektojë më shumë imazhin e Atit qiellor, duke i tërhequr edhe fëmijët e vet ndaj këtij modeli.

1. Në çfarë shkalle e shihni veten si një baba që falni. Rrethoni deklaratën që ju përshtatet më shumë në të kaluarën tuaj

Kam qenë baba që fal

Kam hezituat të fal

Ndonjëherë u kam komunikuar faljen fëmijëve të mi

Asnjëherë nuk u kam komunikuar faljen fëmijëve të mi

2. Në hapësirën më poshtë, përshkruani nëse dhe si ka ndodhur falja në familjen ku ju vetë jeni rritur si fëmijë. Çfarë është e ngjashme me familjen që keni sot? Çfarë ka ndryshuar?

Çfarë mund të bëni diçka këtë javë për t'u treguar faljen fëmijëve tuaj? Jini sa më konkretë, ndërsa shkruani idetë tuaja.

3. A ka ndonjë situatë ku është e nevojshme që t'u kërkon falje fëmijëve? Nëse po, cilat janë dhe kur do ta kërkon faljen e tyre?

Ati dhe respekti

Historia është treguar nga arqipeshkvi Tilotson, kur ishte Dekan i katedrales së Kentërbërit; ai ishte në shtëpinë e vet, kur një pasdite i mbërriti një vizitor. Një prej shërbyesve të tij i hapi derën, kur pa para vetes një plak të fëlliqur që e pyeti nëse Xhon Tilotsoni ishte aty. Shërbyesi, i shokuar nga guximi i paturp i plakut karshi të nderuarit Dekan të Kentërbërit, e dëboi këtë të huaj pasi e shau, duke i shkundur duart pas tij sikur sapo të kishte hedhur një qese me plehra. Gjithsesi zotëria Dekan e kishte njohur zërin e vizitorit që nga brenda dhe vrapoi drejt derës që shërbyesi i vet sa po e mbyllte. Ai e hapi derën duke i bërë titull shërbyesit të habitur:

«Ai ishte babai im!»

Njeriu i respektuar i zotit vrapoi drejt rrugës që kishte kaluar i ati dhe pasi e gjeti, iu ul në gjunjë dhe kërkoi bekimin e tij. Edhe pse Dekan Tilotsoni ishte ngritur në një pozicion nderi në kishën e tij, vazhdoi njësoj ta respektonte dhe donte babanë e vet, pavarësisht pamjes së tij ordinere. Pikërisht ky tregim respekti pasqyron jo vetëm karakterin e tij si fëmijë, por hidhte dritë dhe mbi karakterin e babait të tij. Kështu dua t'i rris dhe unë fëmijët e mi duke qenë një baba i tillë, që fiton respektin e fëmijëve, fëmijët e të cilit dinë si të respektojnë nënën e tyre dhe të moshuarit e tjerë. Dua që ata të dinë të respektojnë autoritetet dhe veten. Një ideal i tillë s'është aspak jo realist. Jam i bindur që është e mundur. Besoj se arsyeja pse një lloj respekti i tillë nuk ndeshet shpesh në ditët e sotme është se shumica e fëmijëve janë produkt i nëntë cilësive atërore, që sapo i kam përmendur në këtë libër. Baballarët e marrin respektin nga gruaja dhe fëmijët duke treguar dashurinë e tyre, pranimin, të vërtetën, besueshmërinë, miqësinë, faljen dhe në vazhdim. Çdonjëra prej këtyre cilësive tregon respektin e një babai, duke treguar më shumë që ia vlen të respektohet kjo figurë. Respekti buron – dhe vjen nga – një baba që i ngjan atit.

Figura e Atit

Në Bibël ndeshet shpesh fjala respekt. Fëmijët duhet të respektojnë prindërit; Bibla na urdhëron që «ta nderoni nënën dhe babanë» (Eksodi 20:12) ne udhëzohemi «t'u tregojmë respekt më të moshuarve» (Lev 19:32) na thuhet: «të respektojmë... autoritetet qeveritare» (Rom 13:10) Dhe Pali e këshillon Timoteun që «pleqtë që udhëheqin në kishë duhet të respektohen dyfish». (1 Tim 5:17)

Bibla na urdhëron të respektojmë, sepse të respektosh tjetrin është e drejtë; Ka diçka të respektueshme në secilin prej nesh, që rrjedh nga natyra e vetë Zotit; «Zoti është shpirt dhe në të është jeta» thotë Bibla (Gjoni 4:24, Gjoni 1:4) dhe është pjesa e

natyrës së tij, që çdo njeri kërkon ta ndajë «Atëherë, Zoti Perëndi... I fryu në vrimat e hundës një frymë jete dhe njeriu u bë qenie e gjallë.» (Zan 2:7) Njerëzit janë bërë sipas shëmbëllimit të Perëndisë (Zan 1:26-27), ata janë shpirta të pa vdekshëm, të krijuar me dinjitet dhe qëllim. Ndaj çdo njeri është i denjë për t'u respektuar, sepse qoftë ai, apo ajo është reflektim i Zotit, që u jep jetë dhe frymë gjithë njerëzve.

Përveç respektit që duhet të tregojmë ndaj njëri-tjetrit si njerëz, urdhërohem i të respektojmë dhe t'u bindemi autoriteteve sipër nesh, «sepse nuk ka pushtet veçse prej Perëndisë dhe pushtetet që janë, janë caktuar nga Perëndia». (Rom 13:1) Mbi të gjitha të respektosh autoritetin civil dhe atë të krishterë është si të pranosh vetë autoritetin e Zotit. Në mënyrë të mahnitshme, Zoti nuk na urdhëron vetëm të tregojmë respekt me njëri-tjetrin, por ai vetë tregon respekt karshi nesh. Ai na krijoi «sipas shëmbëllimit të vet» dhe për shkak të kësaj, ai na trajton me dinjitet, me më shumë respekt se ç' meritojmë:

Çfarë është njeriu që ta mbash mend dhe biri i njeriut që ta vizitosh? Megjithatë ti e bërë pak më të ulët se Perëndia dhe e kurorëzove me lavdi dhe me nder Psalm :-

Zoti është një Atë i respektueshëm, por edhe një Atë i denjë për respektin më të thellë. Pikërisht kështu dua të bëhem dhe unë si baba. Oh, e di që

nuk jam dhe as që kam për t'u bërë ndonjëherë aq i denjë për respektin që ai meriton. Ai është i shenjtë, madhështor; ndërsa unë jam mëkatar dhe i dobët. Por përmes sakrificës së birit të Tij dhe punës së Frymës së Tij të Shenjtë, mund të shfaq shëmbëllimin e tij nëpërmjet shërbesës sime si baba me fëmijët e mi. E gjithë kjo kërkon një varësi të plotë tek Ai përmes lutjes dhe leximit të fjalës së tij. Në vazhdim kërkohet dhe vëmendje ndaj fushave, ose teknikave të tjera si:

Të tregosh respekt

Si i trajton prindërit e tu? Si flet për të tjerët në praninë e të rinjve? A i tregon respekt bashkëshortes sate, drejtuesve të tu në kishë, shefave të tu në punë, kolegeve të tu, ligjeve në fuqi? Njerëzve të tjerë si krijesa të Zotit?

Një prej gjërave kyç për t'u bërë baba që meriton respekt është që së pari të bëhesh baba që tregon respekt, ashtu si Zoti bën me ne. Duke modeluar sjellje dhe veprime të respektueshme në jetën tënde u tregon fëmijëve në mënyra konkrete si duhet të respektosh në të vërtetë.

Të tregosh respekt përfshin dhe respektin ndaj fëmijëve të tu. Disa prindër mendojnë se respekti është vetëm i njëkahshëm, por dhe fëmijët janë bërë sipas shëmbëllimit të Zotit. Kam parë baballarë që kërcënojnë fëmijët e tyre pas një

ndeshjeje të dobët sportive. Ashtu si disa të tjerë që s'janë hiç të vëmendshëm në një shfaqje të fëmijës së tyre. Kam qenë dëshmitar i baballarëve që fyejnë fëmijët e tyre, apo dhe kur flasin me fëmijën shtatëmbëdhjetë vjeçar sikur të ishte gjasthtë vjeç.

Rruga e respektit fillon nga hapat tanë, baballarë! Fillon duke i parë fëmijët tanë me sytë e Zotit dhe duke i trajtuar me respekt. Kjo do të thotë që të marrim në konsideratë opinionet dhe t'i dëgjojmë përgjigjet e tyre. Do të thotë t'u thuash «të lutem» edhe fëmijëve, ashtu si bëjmë me të tjerët. Do të thotë të tregojmë respekt ndaj gjithkujt, edhe me fëmijët tanë, duke i trajtuar ata si fëmijë të Zotit, ashtu siç janë në të vërtetë.

Të përcaktosh respektin

Disa fëmijëve u është thënë të tregojnë respekt pa u shpjeguar së pari çfarë është respekti. Prindërit e tyre s'e kanë bërë asnjëherë një gjë të tillë.

Të përcaktosh fjalën respekt përfshin informimin e fëmijëve me urdhëresat biblike për të respektuar gjithë njerëzit, sidomos prindërit, të moshuarit dhe drejtuesit e kishës dhe qeverisë. Përfshin dhe shpjegimin e mënyrave, të tilla si; t'i drejtohesh një të moshuari me fjalën «zotëri», «zonjë», apo t'i hapësh derën dikujt, si shprehje respekti ndaj të tjerëve.

Më kujtohet një rast kur isha me Shaunin rrugës për në qendrën tregtare. Të dy ishim të pushtuar nga një bisedë, ndërkohë që mbërritëm në parking dhe unë e parkova makinën me shpejtësi.

Pasi e bëra këtë, vura re se e kisha parkuar makinën jo drejt, midis dy vijave të parkimit të dy makinave. Isha i tunduar nga nxitimi që ta

lija makinën ashtu, por më pas i thashë vetes: «Jo, sepse kjo do ta dëmtonte dikë tjetër, që s'do të gjente dot vend parkimi, pastaj çfarë shembulli po i jap djalit tim?» I kërkoja Shaunit të rrinte aty ku ishte në ndenjësë dhe ndërsa po e parkoja sërish makinën e gjeta mundësinë për t'i treguar diçka tim biri.

– Bir, – i thashë, – e di pse po e bëj këtë?

– Pse, babi? – më pyeti ai.

– Siç dhe mund ta shohësh s'qenkam shumë i mirë në parkim, sepse bllokova dy vende. Dhe s'do ishte mirë ta lija kështu makinën, dikush tjetër do të kishte nevojë për një vend të lirë.

Pikërisht e përdora këtë rast për t'i shpjeguar tim biri diçka mbi respektin, duke e ndihmuar si duhet të respektosh dikë.

Të edukosh vetërespektin

Një sjellje e shëndetshme e respektit karshi të tjerëve fillon nga vetë respekti. Një i ri që nuk respekton veten e vet, nuk do të dijë të respektojë as nënën dhe babanë, mësuesit, pastorin, apo dikë tjetër. Baballarët mund ta edukojnë këtë gjë te fëmijët e tyre përmes komunikimit.

Të respektoj, sepse je krijuar sipas shëmbëllimit të Zotit. Është e vërtetë që mëkati e ka ngatërruar këtë shëmbëllim. Megjithatë, çdo fëmijë është i denjë për t'u respektuar, sepse është pasqyrë e shëmbëllimit të Zotit. Të respektoj, sepse je një anëtar (apo që do të bëhesh) i familjes së përjetshme të Zotit. Sipas apostullit Pal, të krishterët janë «mjeshtëria e Zotit». Fjala që përdor Pali në këtë rast për mjeshtëri është *poiema*, një fjalë që përdorej atëherë për të saktësuar punët artisitke (prej së cilës rrjedh dhe fjala poemë). Më fjalë të tjera fëmija yt është «poema e Zotit». Është kryevepra e tij! Të respektoj, sepse ti je pasuria e jetës sime.

Psalmi 1:3 thotë se fëmijët janë dhuratë e çmuar nga Ati ynë qiellor. Të dish se fëmijët janë pasuria jote nuk është një e vërtetë abstrakte; ata, më shumë se kushdo tjetër, na sfidojnë për t'u bërë më të mirët përmes hirit të Zotit. Fëmijët mësojnë prej nesh, por dhe na mësojnë. E dini çfarë po i tregoja Shaunit atë ditë në qendrën tregtare, teksa po parkoja aq keq? Ishte njësoj sikur t'i thosha; «Je vërtet i veçantë për mua, bir, dhe se kam nder të jem babai yt. Jam një prej njerëzve më me fat në këtë botë».

Të respektoj se je unik, me personalitetin, dhuntitë dhe talentet që ke. Çdo njeri i ri, apo i vjetër, ka nevojë të ndiejë se i përket dikujt, të ndihet i denjë dhe kompetent. Ja çfarë thotë një vajzë e re për prindërit e saj:

Kur fillova të mendoja se çfarë kishin bërë mirë prindërit e mi, menjëherë më erdhi në mendje vlerësimi i tyre ndaj nesh si fëmijë, si individë me dhunti të veçanta.

Unë dhe motra ime mbaruam me rezultate të mira universitetin, duke u dalluar në fushën akademike. Ndërsa vëllezërit tanë u dalluan në art, si poezi dhe aktrim. Ata kënaqeshin me krijimet. Të gjithë u nxitëm për të mësuar dhe zhvilluar zakone të të studiuarit për të mbaruar mirë shkollën. Në të njëjtën kohë ndiheshim të lirë dhe pa asnjë presion për shkak të pozicionit të prindërve tanë, që nuk na gjykonin mbi aftësitë tona.

Vetë prindërit tanë kishin studiuar shumë dhe nga ana tjetër ata i pranuan vëllezërit me dhuntitë e tyre në krijimtari njësoj sikur të kishin dalë shkëlqyeshëm në fushën akademike.

Një sjellje e tillë e komunikuar fëmijëve, mund të kontribuojë drejtpërdrejt në qëndrimin e drejtë për vetërespektin.

Të kërkosh respekt për gruan tënde

Disa vjet më parë, kur vajza jonë e madhe ishte vetëm vjeç, bashkë me gruan time, Dotin, patën një periudhë të vështirë me njëra-tjetrën. Kelli filloi të sillej dhe t'i fliste pa respekt.

Pasi e vura re disa herë këtë sjellje vendosa me vete që kjo ishte e tepërt. E kapa njëherë vajzën për shpatullash, e rrotullova butas drejt vetes për ta parë në sy dhe i thashë: «Vajzë, mund të flasësh për nënën tënde kështu, por nuk të lejoj të flasësh për gruan time ashtu! E dua gruan time dhe nuk do ta mbroj vetëm nga njerëzit jashtë familjes, por dhe nga ju fëmijë. Mos guxoni të flisni më ashtu për gruan time!»

Kelli u drodh, mëmëriti diçka me vete dhe u largua, por rezultati i asaj që thashë u duk menjëherë. Herën tjetër, kur ajo nisi të bënte disa vërejtje për Dotin, e kapi shpejt veten duke më thënë: «Oh, s'më lejohet të flas për gruan tënde ashtu!» «Jo, Kelli, s'të lejohet!» – ia ktheva duke i shkelur syrin.

Fëmijët patjetër që e mësojnë respektin në shtëpi fillimisht dhe t'i lejosh të flasin pa respekt ndaj nënës së tyre është sikur t'i lejosh të më sojnë të kundërtën e asaj që do t'u mësosh.

Të këmbëngulësh të respektosh motrën/vëllanë

Motrat dhe vëllezërit mund të jenë miqtë më të mirë, armiqtë më të mëdhenj, ose të dyja bashkë varësisht nga rrethanat, mosha, gjendja e tyre shpirtërore. Midis tyre, ata mund ta respektojnë njëri-tjetrin në mënyrë të habitshme, ashtu siç mund të bëjnë të kundërtën në mënyrë shokuese.

Ndryshimet dhe grindjet janë të pashmangshme midis motrave dhe vëllezërve, por mungesa e respektit nuk duhet të tolerohet. Një baba i urtë mund t'u heqë vizë fyerjeve, ngacmimeve, grindjeve, duke shpjeguar që këto janë shumë larg standardeve biblike për atë që do Zoti për njerëzit e vet. Dr. Xhejms Dobson tregon kufijtë e respektit që përdoren në familjen e tij:

1. Askujt nuk i lejohet të bëjë shaka keqas me tjetrin. Pikë!
2. Dhoma e secilit (apo dhe pjesa e tij e dhomës kur është me të tjerë) është vendi i tij privat.
3. Fëmijës më të madh nuk i lejohet të ngacmojë më të voglin.
4. As fëmija më i vogël nuk duhet t'i bjerë më qafë të madhit.
5. Fëmijëve nuk u lejohet të luajnë me njëri-tjetrin kur kanë nevojë të rrinë vetëm, apo me shokët e tyre.
6. Ne (si prindër) ndërhyjmë në një konflikt të vërtetë sa më shpejt, duke qenë të kujdesshëm për të mos qenë të njëanshëm.

Të përfitosh nga momente mësimi

Baballarët e suksesshëm shfrytëzojnë çdo mundësi për t'u mësuar fëmijëve urtësi dhe mprehtësi, duke përfutur nga momente të tilla të rëndësishme mësimi.

Bisedat e drejtpërdrejta gjatë darkës mund të stimulojnë të menduarin, duke mbjellë kështu fara të së vërtetës te fëmijët tanë. Në fakt, kam parasysh këtu ato familje që hanë rregullisht darkën së bashku. Por dhe nëse nuk e bëni, pse të mos e shfrytëzoni? Momente të tilla me televizorin

dhe magnetofonin të fikur sjellin mundësi të arta për të diskutuar mbi sjelljen e respektueshme. Edhe nëse nuk e keni një traditë për të darkuar së bashku, mund ta konsideroni.

Shfrytëzoni mundësinë kur udhëtoni bashkë, kur bëni pazar, apo dhe kur e ndihmoni në një projekt për të biseduar rreth sjelljes së respektueshme. Mos ngurroni as t'i kërkonti fëmijës suaj si mund ta respektoni. Dhe në të njëjtën kohë mund të kërkonti me butësi si mund të jetë ai vetë

më i respektueshëm.

Mundohuni ta nxirrni secilin nga fëmijët për një vakt të veçantë jashtë shtëpisë me qëllim që t'i mësoni si ta trajtojë me respekt dikë të seksit të kundërt dhe si të mësojë veprime të respektueshme. Kur vini re që fëmija juaj po sillet ashpër me nënën e vet, atëherë shfrytëzoni çdo mundësi më pas, duke marrë shkas nga incidenti për të biseduar me të. Në vend që t'u mohoni programet televizive, të preferuarat e tyre, pavarësisht se mund t'i përshkruajnë fëmijë të paedukatë ndaj prindërve të tyre, nxitini t'i shohin për të biseduar nëse sjellja e parespektueshme e bën një person të duket qesharak, tërheqës, apo të suksesshëm (dhe përgatituni për përgjigje të sinqerta!)

Unë vetë dua të bëhem një baba që i ngjan Atit qiellor, sepse e di që një baba që tregon respekt e fiton atë. Dhe një baba i tillë rrit fëmijë që janë më të prirur të kenë respekt ndaj autoritetit, që respektojnë veten e tyre, motrat dhe vëllezërit dhe bashkëmoshatarët. Një baba i tillë mund të ketë një vajzë, e cila një ditë do t'i thoshte: «Dua të martohem me dikë që t'i ngjajë tim eti, dikë që ta admiroj dhe respektoj.» Apo një djalë që të thoshte: «Dua të bëhem si ty babi!» Dhe fëmijët e një babai të tillë fitojnë respektin e të tjerëve, miqve, familjarëve, kolegëve dhe një ditë – edhe nga fëmijët e tyre. Pikërisht ky lloj babai dua të bëhem dhe me ndihmën e Zotit, do ia arrij!

1. Rreshtoni seksionet e këtij kapitulli mbi bazën e strategjisë që ju vetë konsideroni si më të rëndësishme dhe më urgjenten në familjen tuaj këtë kohë (rreshtojini 1-, sipas shkallës së vëmendjes që duan) të tregosh respekt të përcaktosh respekt të edukosh vetërespekt të kërkoksh respekt për gruan tëndetë këmbëngulësh për respekt midis motrave dhe vëllezërve të përfutosh nga momente mësimi

2. Në hapësirën më poshtë radhit disa mënyra për të përmirësuar qëndrimin tënd të respektit ndaj të tjerëve (prindërve të tu, gruas sate, shëfave të tu, drejtuesve në kishë, etj.)

Radhit disa mënyra si mund t'u tregosh respekt fëmijëve të tu.

* Trego tri hapa konkretë që do të marrësh për të përmirësuar veprimet dhe sjelljen tënde mbi respektin ndaj vetes dhe fëmijëve të tu.

Më pas, transformoju këto hapa në veprime specifike të jetës sate të përditshme.

Një baba sipas zemrës së Zotit

Samueli, profeti i Zotit, bëri si e udhëzuan. Ai vizitoi shtëpinë e Jeseut, një bariu në Betlehem, për t'u kujdesur dhe këqyruar bijtë e tij si një

gjeneral që inspekton trupat e ushtrisë së vet. Ai së pari pa Eliabin dhe mendoi: Ky është i zgjedhuri! Ja, ai është bir njeriu, ka gjithçka – forcën, mençurinë, pamjen.

Por Zoti i tha: «Jo, nuk është ai që mendoj për të zgjedhur».

Atëherë, Samueli e hodhi shikimin tek Abinadabi dhe profeti mendoi se mund të kuptonte arsyetimin e Zotit. Ky nuk është aq i madh sa

Eliabi, por duket qartë që është më i miri. Mund ta imagjinoj tek drejton ushtrinë në luftë pa ndjenjën më të vogël të frikës.

Por Zoti i tha: «Vazhdo më tutje, Samuel!»

Kështu Samueli i ktheu sytë nga djali i tretë i Jeseut, Shamahu, dhe e ndjeu përgjigjen e Zotit para se ta dëgjonte me veshë: «As ky nuk është!»

Samueli i pa dhe një herë të shtatë djemtë që Jeseu ia solli para si profet i Zotit dhe Zoti iu përgjigj «jo» për të gjithë. Ndaj Samueli nisi të habitej: A nuk më bëre ndërmjetës dhe t'u binda? A nuk fole për Jeseun e Betlehemit?

Në fund Samueli pyeti Jeseun: «Këta janë të gjithë djemtë e tu?» Jeseu iu përgjigj me një ngritje supesh: «Kam dhe më të voglin, po ai po kujdeset për delet».

– Sille këtu! – tha Samuli me autoritetin që vetëm profeti i Zotit mund të ketë.

Kështu që Jeseu dërgoi të thirrej djali më i vogël, Davidi.

Kur pa djalin të vinte, Samueli ndjeu sikur e përshkoi korrenti nëpër trup dhe e ndjeu më shumë se ç'e dëgjoi Zotin të thoshte: «Merre dhe vajose; ai është i zgjedhuri.»

Atë ditë Samueli e vajosi Davidin si mbretin e ardhshëm të Izraelit. Mbreti i ri nuk ishte zgjedhje e dukshme. Vëllezërit e tij më të mëdhenj ta mbushnin syrin më shumë si luftëtarë dhe drejtues të sprovuar. Çdonjëri ishte më i madh, më i fortë dhe më i ditur se ai që Zoti kishte zgjedhur të ishte mbret. Por cilësia e Davidit ishte vënë re më parë, kur mbreti Saul kishte mposhtur filistinët dhe amalekasit, para se të inatoste profetin e Zotit, para se ai të mos i bindej Zotit në Gilgal. Samueli i tregoi mbretit se

Zoti e kishte piketuar tashmë «një njeri sipas zemrës së tij, duke e caktuar si drejtues të popullit të tij» (1 Sam :).

Davidi nuk u bë mbret për shkak të trupit të tij të madh, apo për shkak të aftësive të tij ushtarake, apo qoftë dhe për inteligjencën e tij. Ai u zgjodh mbret, sepse ishte njeri sipas zemrës së Zotit, ishte zgjedhur të drejtonte popullin e Izraelit për shkak të marrëdhënies së tij me Zotin, për shkak të lidhjes së tij të ngushtë me të.

Një njeri sipas zemrës së Zotit. Pikërisht i tillë dua të bëhem dhe unë. Ky baba dua të jem. Dua të jem baba sipas zemrës së Zotit, të modeloj zemrën e Atit të fëmijët e mi, dashurinë dhe pranimin e tij të pakushtëzuar. Dua të reflektoj shenjtërinë dhe pastërtinë e tij, ta tregoj veten si baba i besueshëm dhe të sinqertë. Dua të jem strehë dhe ngushëllim për fëmijët e mi, ashtu siç është Ati për të vetët, dua të jem shok me fëmijët e mi ashtu si Ati qiellor, t'u jap disiplinën shpirtërore, të fal njësoj si Ati. Dua që fëmijët të më respektojnë mua dhe të tjerët.

Atësia është detyrë e vështirë dhe e ndërlikuar për çdo brez, por Xherri Adler, në gazetën *Newsweek* sugjeron: «Në një brez të vetëm, atësia (si mëmësia!) është dy herë më e vështirë.» Ai citon më pas kërkesat dhe pritjet në rritje që vetë shoqëria u vë para baballarëve në këtë kohë (në këtë shoqëri përfshihen dhe baballarët!)

Sigurisht që atësia në shekullin e njëzet e një është sfidë që taton burimet njerëzore, duke e zgjatur imagjinatën deri në kufirin më të fundit. Por nëse ke vendosur të jesh baba sipas zemrës së Zotit, atëherë këta kufij nuk kanë fund, qoftë nga burimet, apo imagjinata juaj. Në fakt, nuk jeni aspak i kufizuar, sepse vetë Zoti është burimi juaj dhe Ai është i aftë dhe i gatshëm t'ju pajisë «me gjithçka sipas pasurisë së tij të lavdishme në Krishtin Jezus». Ai do të bëjë shumë e më shumë ndërsa ju përballeni me detyrën e atësisë me një optimizëm të vërtetë biblik.

Qëndrimi i drejtë

Fjala e Zotit na mëson: «Njeriu është siç mendon në zemrën e vet». Qëndrimi mendor ju bën që, ose të vazhdoni në mënyrë optimiste para, si një anije e madhe që çan dallgët e oqeanit të zemërimit, ose të hezitoni, duke e parë çdo problem si një armik që do t'ju fundosë anijen. Është shumë e rëndësishme të mbani një qëndrim të drejtë për të përballuar situata të caktuara gjatë rrugës si baba.

Nëse ende s'e keni bërë, vendosni që sot se do ta përballoni përgje gjësinë e atësisë me optimizmin e vërtetë biblik. Apostulli Pal tha: «Unë mund të bëj gjithçka përmes tij (Krishtit) që më forcon». (Fil :) Kjo «gjithçka» përfshin edhe të qenit baba i përshpirtshëm dhe i suksesshëm në situatë nevojë. Bibla na tregon se Zoti sheh çdo aspekt të jetëve

tona. Ai i njej të gjitha situatat dhe do t'i përdorë këto për të na forcuar dhe stimuluar në gjithë plotësinë tonë si njerëz të përshpirtshëm. Ndaj, pavarësisht nga kufizimet njerëzore, apo vështirësitë konsiderojini këto situata si mundësi për t'u

rritur. Unë jam i bindur që atësia në vetvete është një nga çelësat që Zoti përdor për ta pjekur njeriun. Kjo është e mjaftueshme për të qenë optimist.

Shpesh qëndrimi ynë nuk është aq pozitiv sa ç'duhej të ishte, sepse ne e mendojmë atësinë to shprehur si përgjegjësia, aftësia dhe njohja e këtij koncepti. Dhe kështu i largohemi premtimit të Zotit për të qenë në çdo moment pranë nesh. Por kur e shohim të shprehur si kërkim të urtësisë së tij, dashurisë, forcës, durimit dhe dhembshurisë së tij, atëherë perspektiva e mendimit tonë ndryshon. Vetëm Fryma e tij mund të krijojë cilësitë e aftësive që ne duam në mënyrë që të bëhemi baballarë sipas zemrës së tij.

Detyra jonë është të ecim me të përmes përvojave tona si baballarë, duke i kërkuar ditë pas dite Atij të marrë pjesë besnikërisht në jetën tonë. Le t'i përmbledhim këto mendime në tre deklarata:

1. Qëndrimi im mendor pozitiv e rrit efektivitetin tim si baba
2. Atësia është mundësi për një rritje domethënëse në jetën time
3. Sfidat e atësisë më ndihmojnë të zbuloj pafundësinë dhe realitetin e natyrës së Zotit, si dhe burimet e jetës sime
4. Është e mundur të jesh baba sipas zemrës së Zotit!

Të përballësh haptas disa sfida të veçanta

Të jesh baba është një nga punët më të vështira. Madje mund të jetë edhe e dhimbshme, por vështirësia dhe dhimbja nuk janë gjëra për t'u frikësuar. S'ka rëndësi ç'lloj sfidash përballoni, as ç'lloj fëmijërie keni kaluar, madje as dobësitë tuaja si njeri për të përjetuar fuqinë e Zotit për t'u bërë sipas shëmbëllimit të tij – shëmbëllimin e Atit – në dhe përmes jush.

Shumë baballarë përballen me situata të veçanta për nga nevoja, apo vështirësia, të cilat meritojnë të diskutohen këtu. Mund ta gjesh veten në vështirësi për shkak të një vendimi që ke marrë; apo të jesh i tronditur nga situata që kanë tejkaluar kontrollin tënd. Gjithsesi, duhet t'i përballësh problemet me ndershmëri dhe të bësh ndryshimet e nevojshme në mënyrë që të jesh baba i suksesshëm.

Babai i tejngarkuar me punë

Në brezin e gjyshërve të mi, burrat punonin vetëm fizikisht. Ndërsa sot puna e burrit përfshin edhe aspektin mendor dhe atë emocional. Ai ndeshet me kufij kohorë, presionin e të kryerit një afat javor, ose mujor detyrat e tij dhe këto strese mendore shoqërohen me një botë elektronike dhe një jetë që ikën sa hap e mbyll sytë. Nëse je si shumë baballarë të tjerë, do ta gjesh veten duke u kthyer në shtëpi në fund të ditës i rraskapitur mendërisht dhe emocionalisht, duke menduar si kaloi dita e sotme dhe çfarë do të ndodhë nesër. Dhe shumë prej nesh punojnë kështu gjatë 0 orëve të javës. Në shumë raste, e kufizojmë veten në të qenit baba.

Veç punës së përditshme, shumë prej nesh kanë interesa që duan kohën tonë. Sporte, hobi, mirëmbajtja e gjërave në shtëpi, aktivitetet në kishë, punë në komunitete dhe një mori aktivitete të tjera që kërkojnë vëmendjen tonë.

Nëse je baba me shumë përgjegjësi të tilla, atëherë sfidat e tua janë të dyfishta.

Së pari, duhet të rivlerësosh personalitetin dhe prioritetet e tua. Ndoshta mund të ndihesh më i përmbushur, ose më i sigurt nëse je i zënë me punë. Mos ndoshta ke marrë gjithë këto përgjegjësi, sepse do të jesh i zënë? Ose mos ndoshta, ke dështuar në përcaktimin e përparësive të tua (sipas aspektit të krishterë) se çfarë është më e rëndësishme në jetën tënde? Ndoshta ndihesh i zënë ngushtë, apo i kërcënuar me gjithë këto lloj pyetje, por është e rëndësishme të kuptohet që injorimi i këtyre pyetjeve mund të sjellë dëme të pandreqshme në marrëdhënien tënde me fëmijët.

Përparësitë e një burri testohen sidomos kur ka një punë fitimprurëse, por që nga ana tjetër sjell konflikt me anëtarët e familjes së tij. Rei ishte i tillë. Në një konferencë për burrat ai na tregoi për këtë incident:

Zv. presidenti i kompanisë më tha se isha caktuar për t'u ngritur në një detyrë të re në punë. Por kjo do të thoshte që familja ime të shpërngulej në një vend tjetër dhe që do të kisha përgjegjësi të tjera. Në fillim u ndjeva i sfiduar për ta pranuar. Por si në të gjitha rastet e vendimeve të rëndësishme për jetën time, kërkoja drejtim nga Zoti. Kur ia parashtrova këtë kërkesë Zotit, kuptova që nuk do të ishte e dobishme për familjen time. Kisha marrëdhënie shumë të mirë me dy djemtë e mi dhe s'do ta zëvendësoja me gjë tjetër. Ishte e vështirë ta refuzoja këtë ngritje në përgjegjësi, sepse e dija që s'do ta kisha më një mundësi tjetër të tillë, por në zemrën time e dija që kisha marrë vendimin e duhur. Ky është burrë sipas zemrës së Zotit! Vendimet e Reit reflektojnë përparësi shpirtërore prej të cilave ai vazhdon të korrë frytë.

Sfida e dytë për një baba është të punojë me zgjuarsì. Për shembull, Neili punon si shitës dhe për këtë i duhet të udhëtojë shpesh brenda shtetit të tij, nga e hëna në të premte duke qenë larg familjes. Kur java e punës së tij është e tillë, ai planifikon që e shtuna të jetë patjetër pranë familjes. Dhe fëmijët e tij duke e ditur këtë, mezi presin të shtunën që të jenë gjithë kohën me babanë e tyre.

Një baba i zgjuar, që është i zënë me punë, e kërkon gjithmonë mundësinë për të shfrytëzuar kohën. Një njëzet minutash shëtitje me vajzën tënde mund të përmbushë shumë gjëra, nëse në të vërtetë je me të gjithë kohën. Një njëzet minutash duke luajtur basketboll vetëm për vetëm me djalin në oborrin e shtëpisë para darke, do të ndikojë trefish pozitivisht në marrëdhënien me djalin tënd, në zemrën tënde si baba dhe fizikisht për trupin tënd.

Një vakt i rregullt si familje rreth tavolinës së ngrënies, pa televizorin ndezur, apo celularin pranë, bëhet strehë e ngrohtë për biseda të kënd shme për çdo anëtar të familjes.

Ndoshta kërkon përpjekje më shumë, apo të spostosh për më vonë disa përparësi të tjera, por kështu, edhe një baba tepër i zënë me punë mund të bëhet një baba sipas zemrës së Zotit.

Babai i ndarë

Divorci dobëson dhe ndonjëherë e thyen marrëdhënien baba-fëmijë. Në më të shumtën e rasteve ndodh që fëmijët të jetojnë me nënat. Nëse nëna është armike e burrit të vet, atëherë edhe marrëdhënia baba-fëmijë tendoset akoma dhe më shumë. Shumë baballarë ndihen të pafuqishëm të mbajnë një marrëdhënie kuptimplotë me fëmijët e tyre përmes kontakteve të rralla.

Ja një paralajmërim i rëndësishëm për prindërit e ndarë: Mos e vini kurrë fëmijën tuaj në mes të problemeve tuaja! Nëse njëri prind shpreh lëndim ndaj tjetrit, ka gjasa që fëmija të reagojë po në të njëjtën mënyrë.

Miku im, Dik Dei, që është këshillues familjar martesash dhe fëmijësh, më tregoi për një nënë të divorcuar, e cila kërkonte një këshillë për vajzën e vet -vjeçare. I shoqi e kishte lënë që kur ishte shtatzënë me vajzën dhe tani ajo ishte shumë e hidhur karshi të atit. Diku e pyeti sa kohë kishte kaluar e bija me të atin gjatë këtyre vjetëve dhe ajo

llogariti dy muaj brenda viteve! Dhe Diku menjëherë e përballi gruan: «Këto lloj ndjenjash të vajzës karshi të atit nuk mund të kenë ardhur nga koha e saj qoftë dhe dymujore me të. Dyshoj se janë ndjenjat e tua karshi burrit tënd që kanë ndikuar tek ajo dhe jo përvoja e saj».

Gruaja u largua për t'u kthyer pas një jave. «Ke të drejtë», – pranoi ajo, – «kam qenë duke e ushqyer rëndë vajzën me lëndimin tim dhe kjo e ka dëmtuar. Do të jem më pozitive me babanë e saj».

Njoh shumë baballarë të divorcuar, që e kanë pranuar një sfidë të tillë, duke vazhduar të kenë ndikim pozitiv te fëmijët e tyre. Këta lloj baballarësh mendojnë dhe veprojnë sipas urtësisë së Atit.

Baballarët e urtë të divorcuar planifikojnë me mendim dhe krijueshmëri.

Reksi është një i tillë. Ai ka dy vajza: kur u divorcua vajzat ishin, njëra dhe tjetra vjeç. Edhe pse iu desh të merrej me dhimbjen që i shkaktoi divorci, ai vazhdimisht u pohoi dashurinë dhe përkushtimin e tij vajzave të veta, asgjë e bujshme përveç dashurisë dhe kujdesit të singertë atëror. Kur ata takoheshin të shtunave, ai kalonte gjithë kohën me to, duke bërë gjëra që vajzave u pëlqenin. Me kohën ish-gruaja e tij kuptoi që s'mund të kujdesej më për vajzat, ndaj ato shkuan të jetonin me babanë, i cili ndërkohë ishte martuar me dikë tjetër. Sot të dyja vajzat kanë një jetë të qëndrueshme për shkak të babait, që nuk i braktisi në momentet e tij të vështira.

Edhe baballarët e divorcuar mund të kujdesen mirë për fëmijët e tyre, nëse vetë ata po bëjnë jetë të shëndetshme dhe të përmbushur. Kur lëndimi, zbrazëtia dhe mërzija pushton zemrën e një burri, ata janë më të prirur të infektojnë këdo që kanë rrotull tyre. Një burrë që ndihet i sfiduar, që ka miqësi të mira dhe fokusohet për t'u kujdesur për të tjerët, bëhet kështu model më pozitiv për fëmijët e tij.

Njerku

Vitet e fundit numri i prindërve të rimartuar dhe «familjeve të përziera» është rritur shumë. Më shumë se 0 përqind e martesave në ShBA bëhen me një ose dy të rimartuar nga martesa të tjera. Një në tre amerikanë, 0 milionë të rritur dhe milionë fëmijë, janë njerke, fëmijë të partnerit nga martesa e parë, apo dhe fëmijë të përzier. Një në pesë fëmijë, deri në moshën vjeç është i përzier. Deri në vitin 00, familjet e përziera (me një partner që ka sjellë fëmijë nga martesa e parë) apo familjet e përbëra (ku të dy partnerët kanë sjellë fëmijë nga martesa e parë) përbëjnë shumicën e tipit të familjes.

Të jesh baba është mjaft e vështirë; të jesh njerke është akoma edhe më e vështirë. Ndoshta fëmija i partnerit mund të mos e durojë kur i shkel në «kallo». Mund t'ju konsiderojë si konkurrent me mamanë e vet, ka gjasa që t'i ketë zët përpykjet tuaja për ta edukuar dhe e diskuton autoritetin tuaj mbi të duke mos qenë babai i tij i vërtetë. Madje edhe kur ju pëlqen, ai ka vështirësi me besnikërinë; sepse duke ju pranuar, apo duke u bërë mik me ju mund t'i duket si tradhti ndaj babait të vet.

Të kesh një marrëdhënie të mirë dhe frytdhënëse si njerke është proces i gjatë dhe që s'ndodh brenda një nate. Kam vënë re se ai njerke që ka gjetur forcën të bëjë «hapin e dytë», ka ndjerë gëzimin e të ndihmuarit të fëmijës në një mënyrë të fuqishme. Madje dhe fëmijë të tillë kanë krijuar tashmë marrëdhënie të ngrohta, të forta dhe të qëndrueshme. Do të doja të tregoja disa udhëzime të përgjithshme në ndihmë të atyre që janë në pozitën e njerkut.

Kujtoni që të përshtatesh kërkon kohë. Fëmijët kanë nevojë të rregullojnë ndjenjat e tyre të bëra lëmsh dhe të jenë pastaj të hapur ndaj një marrëdhënieje me ju. Nëse e kërkon me ngut këtë marrëdhënie, apo do të krijosh autoritet mbi këtë lloj fëmije, ka të ngjarë që më shumë të të kthejë kurrizin. Jepi kohë fëmijës të të njohë, që të mund

të ndërtohet një marrëdhënie e besueshme për ta ndihmuar në situata të turbullta emocionale.

Fjalitë e mëposhtme përshkojnë situatat e familjeve të përziera:

1. Pranimi i vetë fëmijës: «Më pëlqen, martohu me të». Fëmijët e nënës mund të ndiejnë se çfarëdo që e bën të lumtur nënën është gjë e mirë.
2. Fundi i një muaji mjalti për fëmijën: «S'më pëlqen! Ti s'je babai im dhe s'do bëj ç'të më thuash ti!» Mos u dekurajoni, apo të hutoheni në këtë kohë. Kujtoni që brenda fëmijës është një luftë e vërtetë ndjenjash të paqarta. Ju mund të bëheni objekti i zemërimit që ai ka ndaj të atit, apo edhe mund t'ju provojë nëse vërtet kujdeseni për të. Durimi, dhembshuria juaj e vazhdueshme dhe e sinqertë do t'ju japin fitoren në fund.
3. Pranimi nga fëmija në baza të provuara tashmë dhe të besueshme: Fëmija tashmë është i sigurt që ju kujdeseni për të si njeri, pavarësisht çfarë bën ai, apo fëmija i kujt është. i fundit mund të kërkojë javë, apo muaj të tërë, madje në raste ekstreme edhe vite! Por edhe një njerë sipas zemrës së Zotit, i korr frytet ashtu si një baba.

Një baba i paplotë

Të gjithë në njëfarë mënyre i përkasim këtij lloji grupi pavarësisht sa duam ta pranojmë. Të gjithë i hyjmë atësisë me një lloj mangësie, por Zoti mund ta mposhtë këtë, madje edhe t'i përdorë papërsosmërinë, pamjaftueshmërinë dhe kufizimet tona për të na ndryshuar në baballarë sipas zemrës së vet.

Disa baballarë ndihen të kufizuar personalisht, dhe kjo ul efektivitetin e tyre atëror. Për shembull, për aq kohë sa mban mend Ali, ai ka pasur zemërim të rrënjosur që herë pas here e nxjerr jashtë me komunikim verbal dhe joverbal. Karli ndihet i pafuqishëm, sepse nuk mund t'i thotë jo askujt, duke e vënë familjen në plan të dytë. Për këtë vuan si fajtor. Poli është rritur i treguar me gisht nga shoqëria dhe për këtë ndihet gjithmonë i turpëruar pse nuk ka qenë më i guximshëm.

Burra të tjera janë të kufizuar nga aftësitë. Sinqerisht ata s'e dinë ç'do të thotë të jesh baba i vërtetë. Marku është profesionalisht i suksesshëm dhe i respektuar nga shoqëria, por kur bie fjala për fëmijët ai ul kokën: «Mendoj se e kam prishur dhe s'di ç'të bëj më», – pranon ai.

Ankesa e zakonshme që kam dëgjuar në shumë seminare mbi atësinë gjatë gjithë këtyre viteve është: «Do të doja t'i kisha mësuar këto gjëra ndërsa fëmijët i kisha ende të vegjël, kam bërë shumë budallallëqe».

Një arsye pse këta baballarë dështojnë në aftësitë e tyre atërore është se s'kanë pasur një model për ta ndjekur. Shumë prej tyre janë rritur në shtëpi, ku ka munguar modeli i babait. Të tjerë në shtëpi ku babai mungonte për shkak të punës, apo interesave të tjera duke neglizhuar familjen. Dhe shoqëria jonë e ul mundësinë që

fëmijët tanë të gjejnë modele të rriturish jashtë shtëpisë. Shumë baballarëve nuk u është treguar kurrë çfarë është një baba i mirë. Dhe lutja ime është që përmes këtij libri të mbushet disi kjo zbrazëti.

Kufizimet janë mundësi për rritjen

Të jemi të ndershëm; të gjithë jemi të kufizuar në aspekte të ndryshme. Jeta e krishterë është një jetë në rritje, është thirrja jonë që të gjejmë liri të re nga mëkati skllavërues dhe zakonet që na kanë robëruar dhe larguar nga suksesi dhe gëzimi. Nëse jemi të ndershëm me veten tonë, atëherë duhet t'i pranojmë dështimet dhe dobësitë tona si baballarë dhe t'i konsiderojmë si çështje që na ndihmojnë në rritjen tonë. Mund t'i refuzojmë ose pranojmë si ftesa për rritjen tonë si burra, baballarë të përsëritshëm, ashtu si Zoti na ka thirrur të jemi.

Besoj se jeta është një dhuratë e veçantë që na jepet nga Ati ynë i dashur. Shpengimi i Zotit përmes Jezu Krishtit është një sinjal i qartë, që ai do të arrijë një transformim të plotë e të fuqishëm në ne. Burimet e tij janë gati. Gjithçka që Ai do të bëjë përgjigjja jonë ndaj thirrjes së tij të qenë në krah të tij, në mënyrë që të na tregojë dashurinë, të na udhëzojë, ndreqë, lirojë dhe bekojë. Dhe atësia është një nga gjërat praktike si mund ta tregojë Ai gjithë këtë.

Secili prej nesh kalon situata të ndryshme dhe ka pikat e forta dhe të dobëta. Lejojeni atësinë të bëhet ajo lloj situatë jetësore, ku ju e përkushtoni veten për t'u bërë ai që Zoti do që të bëheni. Jo vetëm që jeta juaj do të bëhet më e kënaqshme, por nëpër breza, te fëmijët tuaj do të përçohet një etje e vërtetë për drejtësi. Dhe kjo do të ishte dhurata më e madhe që ju mund t'u lini fëmijëve tuaj.

Pavarësisht sa e dini, ose jo, dhjetë cilësitë që trajtova në këtë libër mbi atësinë janë në ju, nëse keni lindur me anë të Frymës (Gjoni 3: 2 Sel. 2:). Përmes lutjes, praktikës dhe rritjes në Krishtin, çdonjëra nga këto cilësi mund të përmirësohet gjatë ecjes suaj në marrëdhënie me fëmijët tuaj. Duke u mbështetur në Të, ditë pas dite, ju mund të bëheni më shumë si Ati Qiellor.

1. Vlerësoni qëndrimin tuaj para sfidave si baba. Është pozitive, negative, apo diku midis?
 2. Si do ta vlerësonte gruaja juaj këtë qëndrim? Shpjegoni përgjigjen
 3. Shkruani dhe mësoni përmendësh një përfundim të kësaj deklarate: «Të jesh një baba i dashur dhe i përfshirë me fëmijët është një përvojë pozitive për mua, sepse...»
- * Çfarë konceptesh ju bënë më shumë përshtypje nga ky kapitull? Shpjegoni pse pikërisht këto ju tërhoqën vëmendjen dhe çfarë hapash do të merrni për t'i bërë pjesë të jetës suaj?
- * Zgjidhni një vend të qetë dhe kaloni pak kohë për të plotësuar këtë deklaratë: «Si rezultat i leximit, mendimit dhe diskutimit mbi temat e këtij libri, kam si qëllim që të...» Jini sa më i plotë dhe konkret, pastaj ndajeni mendimin tuaj me gjithë grupin. Pasi të gjithë të keni treguar gjërat tuaja, bashkohuni në lutje që Zoti t'ju ndihmojë të përmbushni veprimet që keni shkruar. Nëse s'merrni pjesë në ndonjë grup, bëjeni këtë gjë me gruan, ose me një mik të besueshëm.
- . Cila prej dhjetë cilësive të përshkruara në këtë libër është pika juaj më e fortë? Cila ka nevojë për më shumë përmirësim? Lutuni për fuqinë e Zotit që të rriteni në të gjitha cilësitë.

Shtojca

Gjëra argëtuese që baballarët mund të bëjnë me fëmijët e tyre

Lëre «Takimin me babin» njëherë në tre muaj me çdonjërin prej fëmijëve. Bëj një maratonë të Lojërave familjare një të diel pasdite. Bëj një shëtitje natën e Krishtlindjes nëpër lagje për të parë dritat dhe zbulimet me të. Bëj një punë shtëpie, ose riparim makine së bashku.

Gatuaj me fëmijët një vakt të veçantë për mamin. Lëri fëmijët të caktojnë menunë dhe secili të shërbejë si kamerier ose kameriere. (Mos harroni të pastroni pas gjithë kësaj!)

Shko për një vakt mëngjesi jashtë dhe lëre fëmijën të porosisë për ty.

Bëni një maket së bashku, por lëre fëmijën të bëjë punën më të madhe.

Organizo një ekskursion në natyrë.

Shko për kamping për një natë, ose për gjithë fundjavën.

Gatuaj nja «dy duar» me biskota dhe shpërndajua shokëve të fëmijës.

Bli dy aparate fotografikë jo shumë të shtrenjtë, shumë filma fotografikë dhe bëni sa më shumë foto së bashku, ndërsa shëtisni në kopshtin zoologjik, përreth shtëpisë, etj.

Seleksiononi së bashku fotografitë për t'i vënë në një album. Seleksiono vargje kyçe nga Shkrimi, mësojini bashkë përmendsh dhe diskutoni se cili varg ka më shumë kuptim. Shpërbleni njëri-tjetrin me kos frutash kur të keni thënë saktë përmendësh dhjetë vargje.

Organizo një lojë hokeji dyshe në kopshtin e shtëpisë.

Luani një videdo-lojë së bashku

Punoni së bashku në kompjuter

Shko në një prej aktiviteteve të veçanta të fëmijës tënd – nxite dhe lëvdoje (por mos e tepro, duke dashur të jesh nxitës bëhesh prind bezdisës).

Thuaji «Dua të lutem për ty gjatë kësaj jave. Për çfarë të lutem për ty?»

Skiconi dhe mbillni një kopsht të vogël me lule së bashku. Bëni një shportë me fruta të freskëta, feta buke dhe biskota dhe lëreni para derës së shtëpisë së një nevojtar.

Pyete «Çfarë të ka ndodhur ndonjë gjë e mirë sot».

Kërkoju fëmijëve të lutën për ty. Organizoni së bashku një program surprize për mamën, apo gjyshërit me temën «Kjo është jeta jote»,

Tregoj fëmijëve pse e do nënën e tyre. Kërkoju pse e duan ata atë. Pastaj merrni një copë kartoni të madh si poster dhe shkruani së bashku si në një kartolinë të madhe urimi të gjitha arsyet e dashurisë. Zbukurojeni së bashku me vizatime dhe dhurojani në fund mamit.

Bashkohuni me një, ose dy familje të tjera me të cilat keni miqësi dhe organizoni një natë talentesh me pjesëmarrjen e të gjithë të pranishmëve. Mos harro ta fiksosh me kamera këtë ngjarje. Ndani gjatë kohës së darkës «Momenti më i sikletshëm që kam pasur». Bëj një libër kuponash për secilin fëmijë. Çdo kupon ka si shpërblim një takim me babin dyshe për të ngrënë akullore, për të bërë një lojë me top, lojë buling, apo një lojë që zgjedhin ata, për të ngrënë pica, etj. Rregulli i sugjeruar: kufiri është një kupon më muaj për secilin fëmijë.

Lexoni së bashku një libër nga Bibla dhe diskutoni rreth tij ndërsa le xoni.

Shkoni së bashku të vizitoni një muze.

Zgjidhni së bashku një parfum që të gjithë ju e pëlqeni.

Zgjidhni një dru frutor molle, ose qershie dhe caktoni një ditë për fruta duke mbledhur frutin e caktuar.

Shkoni të bëni pazar bashkë.

Kërko për organizime koncertesh falas në qytet dhe cakto të bëni një piknik si familje gjatë asaj mbrëmjeje.

Bëni një udhëtim të shkurtër nëpër libraritë e qytetit. Merri secilit fëmijë një kartë biblioteke dhe ndihmoji të zbulojnë botën e librave më të mirë.

Bli, ose merr me qira një video me ushtrime aerobike dhe stërvituni bashkë.

Shkoni në koncertet, apo pjesë teatrale të vëna në skenë nga kolegët e tu (nëse je artist). Organizoni një seri ngarjesh me biçikletë si familje. Shkoni dhe ngrini një balonë së bashku.

Shkoni në një vend ku bëhen ndërtime dhe shihni progresin e ndërtesës, shtëpisë, etj.

Nëse fëmijët i kanë ende gjallë gjyshërit, organizoni një ditë «Falënderimi për gjyshërit» me kartolina dhe ëmbëlsira të bëra vetë. Pastaj bëni të njëjtën gjë me mamin, më pas për një shok, apo komshi dhe në fund për pastorin e kishës, apo drejtuesin e studimit për të rinjtë ku janë fëmijët tuaj.

Ndërtoni një lojë më formuese së bashku. Pas darkës, hiqni karriget nga tavolina dhe luani lojën»Përqendrohu!«, ku lojtari pa numër, pasi godet gjunjët dy herë dhe më pas përplas duart, thërret me zë të lartë numrin e dikujt, ndërsa ai s'ë ka mendjen. Pastaj të gjithë i futen punës për të pastruar kuzhinën; fituesi duhet ta zgjedhë vetë punën që do të bëjë. Uluni së bashku para televizorit dhe shihni programin e preferuar të fëmijës tënd. Së bashku me fëmijët shkoni në kopsht për të bërë një tufë me lule për mamin, apo për ndonjë person tjetër të veçantë.

Veç, zgjidh dhe bëj një tufë me lule për vajzën tënde.

Ndërto një raft librash me djalin tënd.

Organizo një natë me qirinj. Fiki të gjitha dritat, ndiz qirinjtë, bëj një zjarr për të bërë kokoshka dhe uluni rreth zjarrit e tregoni histori.

Lutuni së bashku për njerëz të veçantë të jetës suaj.

Pasi t'u keni telefonuar më parë, organizo një udhëtim në një stacion zjarrfikësesh.

Luani me tullumbace uji në kopsht.

Në ditët e shënuara të Krishtlindjes, Pashkës, Pavarësisë, etj., luani pjesë dramatike me fëmijët me kuptim për këtë ditë.

Për çdo përvjetor të dymbëdhjetë të fëmijës, jepi një kavanoz me pesë-dhjetë e dy letra të vogla rripa-rripa «trajtime të veçanta». Fëmija duhet të tërheqë nga kavanozi një letër për çdo javë. Të jenë trajtime të veçanta, por të menduara më parë. P.sh: «Qëndro një orë më tepër zgjuar gjatë kësaj jave», «fto një shok për të fjetur bashkë», «shkoni për akulllore me babin» etj.

Shërbeni së bashku në ndonjë projekt të kishës, apo komunitetit. Shërbeni ushqim në ndonjë strehë të braktisurish, ose jini vullnetarë të shërbeni në kishë.

Bëni fotografi, punë me dru, riparime në shtëpi, ose riparime të thjeshta mekanike për makinat etj.

Vizitoni së bashku azile lokale, mendoni të bëni diçka për t'i kënaqur pacientët. Filloni të lexoni së bashku librin e C.S.Luisit *Kronikat e Narnias*. Befasoje fëmijën duke i shkuar pas mësimi për ta marrë te shkolla dhe çoje më pas në një piknik, ose të hani bashkë pica, etj.

Cakto një kohë që të hash drekë më fëmijën në shkollë.

Planifiko një «darkë të fshehtë» duke fshehur disa përbërës ushqimorë nëpër shtëpi dhe pasi të japësh një shenjë ku është përbërësi i parë, filloni të gjeni të tjerët me radhë. Në fund bëni bashkë gjithë përbërësit e ushqimit që keni gjetur.

Organizo një mbrëmje nderimi për çdonjërin prej pjesëtarëve të familjes, përgatit ushqimin e preferuar të secilit, jepi një vend nderi në tavolinë, dizeno një stemë nderi dhe bëj që gjithsecili të ndajë... «Për çfarë e vlerësoj...»

Njëherë në muaj planifiko një darkë ceremoniale. Të gjithë të vishen me 2 rroba të bukura, ndërkohë që tavolina shtrohet me hijeshi me kompletin më të bukur porcelan që mund të keni. Përdore këtë rast argëtues për t'u mësuar fëmijëve etikën.

Shënime të fundit

Kapitulli 1

1. E hartuar nga figurat e publikuara nga Fondi i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe libri Brezi i -të, nga Neil Aua dhe Bill Shtraus dhe një raport i revistës *Fortune* me titull *Fëmijët në krizë, vështirësia për të shpëtuar fëmijët amerikanë*, gusht , 2
2. Luis. O. Kalduell, *Kur dy partnerët bëhen prindër*
3. Klaudia Uollis. *Stresi, a mund t'i bëjmë ballë?* Qershor , 3, -
4. Kathlin Furi; *Seksi dhe adoleshenti amerikan*, Mars .
5. Armand Nikoli Jr. *Ndryshimet në familjen amerikane*. Tetor ,

Kapitulli 3

1. Den Benson, *Njeriu i plotë*,

Kapitulli

1. Xherri Adler *Të formosh një baba më të mirë*, qershor
 2. Kathlin Furi, *Seksualiteti dhe adoleshenti amerikanë*, mars
 3. Merilin Elias, *Divorci i prindërve ndikon në jetën seksuale të studentëve*, nëntor
 4. Kristofer. P Anderson, *Ati, figurë dhe forcë*, 3
 5. Frank Martin, *Babai miqësor*,
 6. Lesli Xhejn Nonkin, *Do të doja që prindërit të më kuptonin*, 2
 7. Rexhinald. W. Bibi dhe Donald C. Posterski, *Brezi i ekspozuar; një vështrim i brendshëm i adoleshentëve kanadezë*, Stjuart Pauell, *Çfarë u bën drejtimi fëmijëve tanë*, tetor Karol Touarnicki, *Imazhet pozitive duhet të luftojnë shtatzënitë e adoleshentëve*, janar
- E cituar nga *Pse të pres?* Nga Xhosh Mekdauell dhe Dik Dei,
Tomas L. Trevethan, *Bukuria e shenjtërisë së Zotit*,
Xhosh Mekdauell dhe Dik Dei, *Si të bëhesh hero për fëmijët e tu*

Kapitulli

1. Studentët më të mirë pranojnë që kanë kopjuar, histori e publikuar në *Hamilton Journal News*, tetor 3
 2. Xhorxh Barna, *Brezi i padukshëm*, 2
 3. Shih 1 Selanikasve ;-
- Denis Rejni, *Të këpusësh barërat e këqija, të mbjellësh farën*,

Psalmi :3

Kapitulli

1. Xhejms L Shallër, *Në kërkim të atësisë së humbur*, (Shënim; Gordon Mekdonald, në librin e vet *Babai i suksesshëm*, ia atribuon historinë jetës së Xhejms Bowsuellit, biografi i shquar, Samuel Xhonsoni, babai i të cilit ka qenë gjykatës i njohur.)

2. Dy burime të reja mund të jenë ndihmëse për baballarët, që kërkojnë të përcaktojnë qartë premtimet ndaj fëmijëve. *Më trego premtimet* nga Joni Erikson Tada dhe Ron DiÇiani dhe *Një angazhim i babait* nga Stefan Gabriel,

Kapitulli

1. Dr. David Ferguson dhe Dr. Don Mëkmin Dhjetë nevojat themelore,
2. Shih veprën e Filip Kellër, *Një bari që sheh në Psalmin* , 0
3. Den Benson, *Njeriu i plotë*,

Kapitulli

1. E cituar nga *Faktet mbi vetëvrasjet e adoleshentëve* nga David Elkin, 0
2. Anketa vjetore e -ët midis studentëve më të dalluar në shkollën e mesme,
3. Nadin Brozan, *Një vështrim i ri mbi frikërat e fëmijëve*, 3 . Efesianëve ;

Kapitulli

1. Xherri Adler, Të formosh një baba më të mirë,
2. Zanafilla ;- , Romakëve
3. Baballarët që ndiejnë vështirësi të flasin hapur me fëmijët e tyre mund të gjejnë një ndihmë në biseda të shpejta, që janë fillesa bisedash dhe një seri letrash me pyetje që mund të bëhen gjatë darkës, ngarjes me makinë, apo para gjumit. Bisedat e shpejta janë pjesë e mjeteve të baballarëve të zgjuar, një prodhim i *Illustrated Word and Sunday International*.

Kapitulli

1. Zanafilla 2;
2. Mekdauell dhe Dei *Si të bëhesh hero për fëmijët e tu*

3. Xhon Redmond, *Disiplina e suksesshme*, prill
4. Po aty
5. Mekdauell dhe Dei në të njëjtin libër
6. Po aty
7. Proverbat 3:

Kapitulli

1. Alen C Guelyo, *Frika nga falja*, 3
2. Mekdauell dhe Dei, *Si mund të bëhesh hero për fëmijët e tu*

Kapitulli

1. Efesianëve 2:
2. *E cituar në atë që kanë bërë drejt të Virxhinia Wern,*
3. DR. Xhejms Dobson, *Fëmija kokëfortë*

Kapitulli

1. Xherri Adler, *Të formosh një baba më të mirë,*
2. Filipianëve :
3. Miriam Uejseng Misrah, *Njerka e keqe dhe të tjera mite*, 3
4. Koni Shulc, *Fakti i divorcit, trillimi dhe familja e përzier,*
5. Virxhinia Ratër, *Mësime nga familje të përziera*